



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Analiza Vjetore 2022





SHKURTIME:	6
PËRKUFIZIME:	7
HYRJE	8
1.1 ARRITJET KRYESORE GJATË VITIT 2022	8
TË DHËNA STATISTIKORE MBI SISTEMIN E PROKURIMIT PUBLIK NË SHQIPËRI	12
2.1 Statistika në lidhje me regjistrat e parashikimeve të krijuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik për vitin 2022	14
2.2 Statistika në lidhje me numrin e procedurave të prokurimit publik të shpallura gjatë vitit 2022 në Sistemin e Prokurimit Elektronik	16
2.3. Statistika për procedurat konkurruese të prokurimit, të zhvilluara në Sistemin e Prokurimit Elektronik	17
2.3.1. Statistika sipas Tipit të kontratës	17
2.3.2. Statistika sipas llojit të procedurave	19
2.3.3. Statistika për procedurat e prokurimit të publikuara dhe të vazhduara gjatë vitit 2022, sipas 3 mujorëve	22
2.3.4. Statistika mbi numrin e njoftimeve të kontratave për procedurat e prokurimit të publikuara gjatë vitit 2022, krahasuar me vitin 2021.	23
2.4. Statistika sipas njoftimeve të fituesit	27
2.4.1. Statistika mbi numrin e njoftimeve të fituesve të publikuar gjatë vitit 2022, sipas tipit të kontratës	27
2.4.2. Statistika mbi numrin e procedurave të përfunduara me fitues të publikuara gjatë vitit 2022, sipas llojit të procedurës së prokurimit	30
2.4.3. Statistika mbi numrin e njoftimeve të fituesve të publikuar gjatë vitit 2022, krahasuar me vitin 2021	32
2.5. Statistika për kontratat e nënshkruara	34
2.5.1. Statistika mbi numrin e njoftimeve të kontratave të nënshkruara dhe Marrëveshjeve Kuadër gjatë vitit 2022, sipas Tipit të kontratës	35
2.5.2. Statistika mbi numrin e njoftimeve të kontratave dhe marrëveshjeve kuadër të nënshkruara gjatë vitit 2022, sipas llojit të procedurës së prokurimit	36
2.5.3. Statistika mbi numrin e njoftimeve të kontratave dhe MK të nënshkruara gjatë vitit 2022, krahasuar me vitin 2021	39
2.6. Marrëveshjet kuader	41
2.7. Të dhëna mbi procedurat e prokurimit të kryera gjatë vitit 2022 në kuadër të procesit të rindërtimit	44
2.8. Statistika mbi kriteret e parashikuara nga ligji për vlerësimin e ofertës fituese për procedurat të finalizuara me njoftim fituesit gjatë 2022	45
2.9. Statistika mbi përqindjen e kursyer nga procedurat e kryera në sistemin elektronik	46
2.10. Statistika mbi numrin e anulimeve të procedurave të prokurimit mbi kufirin monetar për procedurën me vlerë të vogël gjatë 2022	47
2.11. Të dhëna mbi procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	48
2.12. Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël	52



2.13. Statistika në lidhje me procedurat e krijuara në sistemin elektronik	54
2.14. Sistemi dinamik blerje bileta transporti ajror ndërkombëtar	55
2.15. Statistika në lidhje me Autoritet Kontraktore që kanë krijuar procedua me vlerë të vogël dhe mbi kufirin monetar për procedura me vlerë të vogël	58
2.16. Statistika mbi ofertat e dorëzuara gjatë 2022	59
2.16.1. Statistika mbi procedurat e prokurimit me një ofertë të dorëzuar të përfunduara me fitues gjatë 2022	62
2.17. Statistika në lidhje me pjesëmarrjen e SMS-ve në procedurat e prokurimit	62
2.18. Statistika për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë gjetë vitit 2022	63
2.19. Statistika në lidhje me numrin e procedurave të dhënies me koncesion/PPP gjatë vitit 2022	64
2.20. Statistika në lidhje me procedurat e ankandit publik të zhvilluara gjatë vitit 2022	64

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, ZBATIMI DHE MONITORIMI I TYRE 67

3.1. Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2020-2023	67
3.2. Strategjitë nder sektoriale	68
3.2.1. Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022	68
3.2.2. Strategjia Ndër sektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023	68
3.2.3. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030	69

PROCESI I INTEGRIMI EUROPIAN DHE BASHKËPUNIMI MË TË TRETËT 70

4.1. Procesi SCREENING	71
4.2. Procesi i aderimit të Shqipërisë në GPA të OBT	72
4.3. Bashkëpunimi me institucione të tjera	72
4.4. Bashkëpunimi me institucione të huaja	74

INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2022 75

VEPRIMTARIA KËSHILLUESE DHE ASISTUESE E APP	77
6.1. Praktikën e shqyrtuarë për dhënie mendimesh, këshilla apo udhëzimesh	77
6.2. VEPRIMTARIA ASISTUESE E APP	79
6.2.1. Analizimi i të dhënave të procedurave të asistuarë	79
6.2.2. Analizimi i të dhënave në lidhje me procedurat që rezultojnë pa problematika, kundrejt procedurave të asistuarë	79
6.2.3. Analizimi i të dhënave në lidhje me reagimin/reflektimin e autoriteteve kontraktore, ndaj rekomandimeve të APP.	81
6.2.4. Analizimi i të dhënave në lidhje me mesataren e numrit të ofertave të paraqitura dhe ofertave të kualifikuara në procedurat e asistuarë nga APP.	84
6.2.5. Hartimi i rekomandimeve në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik dhe bashkëpunimi me AK-të.	89



VEPRIMTARIA MONITORUESE E APP	90
7.1. Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë së procedurave	90
7.1.1. Verifikimi ex-post i procedurave të prokurimit publik	90
7.1.2. Verifikimi ex post në fushën e ankandëve publike, koncesioneve dhe prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë	94
7.2. Montiorimi i kontratave	96
7.2.1. Hartimi i akteve të nevojshme për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë procesit të monitorimit të kontratave	96
7.2.2. Të dhëna mbi numrin e kontratave/marrëveshjeve kuadër të nënshkuara, në përfundim të procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022	96
7.2.3. Të dhëna mbi raportimin e planeve të zbatimit të kontratave nga autoritetet kontraktore.	97
Plane zbatimi të grupuara sipas tipit të kontratës.	97
Plane zbatimi të grupuara sipas llojit të AK	98
Plane zbatimi të grupuara sipas muajit të dërgimit	98
7.2.4. Të dhëna mbi korrektësinë e zbatimit të kontratave të raportuara nga AK-të nëpërmjet formularëve të raportimit, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022.	101
7.2.5. Problematika të evidentuara nga AK gjatë zbatimit të kontratave nga analizimi i formularëve standardë të raportimit të ecursisë së zbatimit të kontratave.	103
7.2.6. Modifikimet e kontratave	104
7.2.7. Trajtimi i raporteve përfundimtare për ecurinë e zbatimit të kontratës, të dërguara nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara	105
7.2.8. Hartimi i Planit të Monitorimit të Kontratave	105
7.2.9. Zhvillimi i takimeve informuese për çështje që lidhen me procesin e monitorimit të zbatimit të kontratave.	106
PËRJASHTIMI I OPERATORËVE EKONOMIKË	107
Vendimet e marra në përfundim të procedimeve administrative ndaj operatorëve ekonomikë	108
PËRFAQËSIMI I APP NË PROCESET GJYQËSORE	111
TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR PUBLIKIMIN	117
10.1. Publikimi i njoftimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik	118
10.2. Publikimi i Njoftimeve për Ankande Publike në Buletinin e Njoftimeve Publike	119
10.3. Publikimi i Njoftimeve për Qera në Buletinin e Njoftimeve Publike	120
10.4. Njoftime për Koncesione/Partneritet Publik Privat dhe të njoftime të tjera	120
10.5. Publikimi i elementëve të regjistrit në sistem	121
10.6. Praktikat e shqyrtuara	121
10.7. Statistika mbi transaksionet e miratuara nga AFMIS	122



TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR MENAXHIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE DHE PUBLIKIMEVE	123
11.1. Praktikat e shqyrtuara	127
11.2. Krijimi i përdoruesve të rinj për vitin 2022	128
11.3. Statistika të tjera në lidhje me përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik	131
11.4. Aktiviteti i faqeve për vizitore	133
11.5. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas 24 orëve.	134
11.6. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas ditëve të javës.	135
11.7. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas muajve të vitit.	136
11.8. Përdoruesit të cilet përdorin me se shumti sistemin e prokurimit elektronik	137
11.9. Aktiviteti i përdoruesve sipas ndërfaqeve më të klikuara në portalin e APP.	138
11.10. Aktiviteti i përdoruesve sipas fjalëve kyç më të përdorura për kërkimin e portalit të APP.	139
11.11. Aksesimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas shfletuesve dhe sistemeve operative.	141
11.12. Aksesimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas llojeve të pajisjeve më të përdorura nga përdoruesit	143
MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCËS	145
12.1. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	145
12.2. Autoriteti Përgjegjës për konfliktin e interesit	145
12.3. Koordinatorin për të drejtën e informimit	145
12.4. Aktivitetet në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve administrative të stafit të APP dhe specialistëve të prokurimit publik pranë autoriteteve kontraktore	146
12.4.1. Pjesëmarrja në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare	146
12.4.2. Trajnimet e punonjësve të prokurimeve pranë Autoriteteve Kontraktore	149
12.4.3. TAKIME DHE WORKSHOPE	149
KONFERENCA NDËRKOMBËTARE PRIMO	149
12.5. KORRESPONDENCA ME MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË	152
12.5.1. Kontrolli i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm	152
12.5.2. Përdorimi i Web Portalit	152
12.6. PËRDORIMI DHE RUAJTJA E AKTIVEVE	153
12.7. PERFORMANCA E REALIZIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2022	153
PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT E PUNËS PËR VITIN 2023	154



SHKURTIME:

AK - Autoritet Kontraktor

APP - Agjencia e Prokurimit Publik

ASPA - Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

ATRAKO - Agjencia e Trajtimin të Koncesioneve

BB - Banka Botërore

BNJP Buletini i Njoftimeve Publike

BOE –Bashkim i Operatorëve Ekonomikë

OE -Operator Ekonomik

ILDKPKI - Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit

KVO - Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

KPA - Kodi i Procedurave Administrative

KLSH -Kontrolli i Lartë i Shtetit

KM - Këshilli i Ministrave

KPP - Komisioni i Prokurimit Publik

LAP -Ligji për Ankandin Publik

LPP -Ligji i Prokurimit Publik

MK-Marrëveshje Kuadër

NJP- Njësi Prokurimi

OQB - Organi Qendror Blerës

PBB- Produkt i Brendshëm Bruto

PPP - Partneriteti Publik Privat

QKB - Qendra Kombëtare e Biznesit

SA - Strategjia Antikorrupsion.

SAE - Sistemi i Arkivës Elektronike

SMFP - Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike

SPE- Sistemi i Prokurimit Elektronik

OBT- Organizata Botërore e Tregtisë

GPA- Marrëveshja për Prokurimin Publik

OSBE- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë



PËRKUFIZIME:

Në funksion të interpretimit të kësaj analize, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

Fondi limit i prokuruar - Vlera pa TVSH, që përlogaritet nga autoriteti kontraktor në çastin e publikimit të njoftimit të kontratës ose në çastin e fillimit të procedurës së prokurimit, në rastet kur nuk kërkohet një publikim i tillë.

Vlera e fituar – Vlera e ofertës së shpallur fituese.

Fond i kursyer - Diferenca midis fondit limit të prokuruar dhe vlerës së fituar

Procedura të tjera - Procedura prokurimi të zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, pas publikimit të njoftimit të kontratës.

Marrëveshje kuadër - Një marrëveshje ndërmjet një apo më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore dhe një a më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave, që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasinë e parashikuara.

Procedurë prokurimi me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës – Lloj procedure e cila zhvillohet në rrugë elektronike dhe përdoret në rrethana të veçanta të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik.

Procedura të papërfunduara (anuluara) - Procedura prokurimi që nuk janë finalizuar me njoftim fituesi

Pezullim - Ndërprerje e zhvillimit të procedurës së prokurimit në rastet kur ka ankesa në Autoritetin Kontraktor apo në Komisionin e Prokurimit Publik.

Asistim/koordinim - Proces i zhvilluar në kuadër të dhënies së asistencës autoriteteve kontraktore, të cilat ndërmarrin një procedurë prokurimi, sa i takon hartimit të dokumenteve të tenderit.

Verifikim - Proces i zhvilluar pas përfundimit të procedurës së prokurimit me finalizimin e një kontrate për të verifikuar nëse procedura e prokurimit e zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor është kryer në përputhje me parashikimet ligjore.

Monitorim kontrate - Procesi i monitorimit të implementimit të kontratës së nënshkruar nga ana e autoriteteve kontraktore nëpërmjet raporteve të dërguara nga ana e tyre.



Ky raport pasqyron punën e Agjencisë së Prokurimit Publik (në vijim “APP”) dhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik për periudhën nga 1 Janar 2022 deri në 31 Dhjetor 2022.

APP e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Ligjit Nr. 125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”, Ligjit Nr. 9874/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar.

Raporti paraqet në mënyrë të detajuar edhe të dhëna statistikore në lidhje me funksionimin e sistemit të prokurimit publik në përgjithësi, përfshirë sistemin elektronik të prokurimit.

1.1 ARRITJET KRYESORE GJATË VITIT 2022

Gjatë vitit 2022, APP ka vijuar punën për monitorimin e zbatimit të kuadrit të ri ligjor dhe plotësimin e tij me akte të reja nënligjore. Duke qenë se viti 2022 shënon vitin e parë të plotë kalendarik dhe buxhetor me një kuadër të ri ligjor, i është kushtuar një rëndësi e posaçme jo vetëm monitorimit të zhvillimit të procedurave, por edhe raportimeve për zbatimin e kontratave nga ana e autoriteteve/ enteve kontraktore.

Gjithashtu, një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Prokurimit Publik, hartimit të raporteve përkatëse dhe matjes së të gjithë indikatorëve të performancës të identifikuar për këtë qëllim.

Nga ana tjetër, hapja e negociatave për anëtarësim në BE ka shtuar angazhimin e APP në drejtim të procesit të integritetit evropian dhe përgatitjes për këtë proces në cilësinë e institucionit kryesues të Kapitullit 5 të acquis, “Prokurimi publik”, si një nga kapitujt që i përket Grupit të Parë të kapitujve negociues.

Përmirësimi i sistemit elektronik të prokurimit është gjithashtu një sfidë e vazhdueshme sidomos në funksion të implementimit të kuadrit të ri ligjor.

Puna e vazhdueshme e APP ka gjetur pasqyrim edhe në arritjet konkrete të vlerësuara edhe nga raportet e ndryshme ndërkombëtare, ndër të cilat mund të përmendim:

- Sipas raportit vjetor për 2022 të Komisionit Evropian, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në prokurimet publike. Është bërë **përparim i mirë, veçanërisht sa i takon vijimit të procesit të miratimit të legjislacionit dytësor** në zbatim të ligjit të ri për prokurimin publik, zhvillimit dhe implementimit të kurseve të trajnimit me certifikim për prokurimin publik, publikimit të raportit të parë të monitorimit për strategjinë e prokurimit publik dhe vendosjen e “të dhënave të hapura”/open data në kohë reale për procedurat e prokurimit dhe përfshirjes së risqeve të korrupsionit të lidhura me prokurimin në planet e integritetit të institucioneve.



- Gjatë vitit 2022, APP ka pasur angazhimin maksimal kundrejt procesit të integritetit Evropian. APP në rolin e institucionit lider dhe koordinues për kapitullin 5 “Prokurimin Publik” udhëhoqi me sukses procesin lidhur me takimin biletaral Shqipëri-BE, në kuadër të *Screening* për këtë kapitull, duke depozituar brenda afateve kohore gjithë materialet dhe dokumentacionin e kërkuar dhe duke përgatitur prezantime gjithëpërfshirëse, ku pasqyroheshin të gjithë elementët dhe informacioni përsa i përket fushës së prokurimeve publike. Përfaqësuesit e BE në fund të takimit dypalësh theksuan se takimi rezultoi shumë i suksesshëm dhe se legjislacioni shqiptar është në një masë të madhe i përafuar me *Acquis* e BE.
- Një arritje shumë e rëndësishme sikundër rezulton nga të dhënat, është rritja e përdorimit të kriterit të vlerësimit *Oferta Ekonomikisht më e Favorshme*, bazuar në kosto duke synuar rritjes së cilësisë së kontratës të lidhur në fund të procesit të prokurimit. Një rritje e tillë, vjen edhe si rezultat i legjislacionit të ri, i cili parashikon qartazi përdorimin nga ana e autoriteteve kontraktore të kriterëve që lidhen me cilësinë e produktit, kriteret mjedisore, sociale apo ciklin jetësor të tij duke garantuar efikasitet më të lartë dhe kosto më të ulët për autoritetin/entitetin kontraktor. Nga 4507 procedura të fituara në vitin 2022, 328 procedura (7,3%) janë përzgjedhur duke përdorur si kriter vlerësimi ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto dhe 4179 procedura (92,7%) me metodë vlerësimi ofertën ekonomikisht më të favorshme, bazuar në çmim.
- Në dokumentin *SME Policy Index 2022: Western Balkans and Turkey*¹ nëpërmjet të cilit OECD monitoron dhe vlerëson progresin e arritur dhe politikat përkatëse të cilat mbështesin Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme në vende si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Turqia u theksua se, dimensionin 5B: Prokurimi publik është **një nga fushat me performancë të fortë**. Për sa më sipër, kuadri institucional dhe rregullator dhe ofrimi i shërbimeve qeveritare dixhitale cilësohet si një nga aspektet më të rëndësishme së bashku me kuadrin e ri ligjor të miratuar në 2020, në përputhje me standardet evropiane. Si një nga arritjet më të rëndësishme në këtë drejtim u theksua gjithashtu edhe miratimi i Strategjisë së parë Kombëtare në fushën e prokurimeve publike, 2020-2023. Shqipëria u rendit si një nga vendet dhe ekonomitë që kanë miratuar dhe zbatuar masa politike për të lehtësuar aksesin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në prokurimin publik. Gjithashtu, u përmendëm si një nga ekonomitë që kanë miratuar rregulla që thjeshtojnë procedurat e prokurimit publik dhe reduktojnë barrën administrative për operatorët ekonomikë, sidomos SME.
- APP ka vijuar procesin e **plotësimit të kuadrit ligjor dytësor** me udhëzime, udhërrëfyes, manuale teknike etj, të cilat ndihmojnë palët e treta përfshirë Autoritetet Kontraktore, Operatorët Ekonomikë dhe çdo palë të interesuar të informohet dhe të ketë njohuri shtesë rreth procesit të prokurimeve publike.
- APP në rolin e institucionit monitorues dhe mbikëqyrës të **Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik** ka realizuar me sukses procesin e koordinimit, mbledhjes dhe përpunimit të informacionit duke monitoruar zbatimin dhe realizimin e aktiviteteve të kësaj strategjie bazuar në periudhat përkatëse referuar në dokument. Gjithashtu, APP si një nga institucionet kryesore përgjegjëse për realizimin e aktiviteteve dhe plotësimin e indikatorëve kyç të performancës është angazhuar maksimalisht duke realizuar në një shkallë të konsiderueshme aktivitetet e parashikuara për vitin 2022.

¹ <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/d22fdb37-en/index.html?itemId=/content/component/d22fdb37-en>



- Prokurimi Publik është një nga fushat kryesore të përfshira edhe në Strategji të tjera Kombëtare e Ndërsektoriale si Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit dhe Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike, ku APP jep kontributin e saj, duke raportuar rregullisht në kuadër të hartimit të raporteve periodike të monitorimit në lidhje me zbatimin e masave përkatëse dhe realizueshmërinë e indikatorëve të performancës. Në këtë kuadër, vërejmë se APP ka realizuar plotësisht aktivitetet dhe indikatorët e performancës në lidhje me këto dokumenta strategjikë. Gjithashtu, APP ka dhënë kontributin e saj edhe në lidhje me rishikimin e këtyre strategjive dhe hartimin e strategjive dhe planeve të reja të veprimit për periudhën 2024-2030.
- APP ka vijuar punën me angazhim maksimal për të publikuar në faqen e saj zyrtare, në kohë reale, çdo të dhënë për procedurat e prokurimit publik, procedurat koncesionare/ppp dhe procedurat e ankandit që zhvillohen në vend si dhe çdo informacion tjetër të vlefshëm, si aktet nënligjore, vendime dhe manuale, rekomandime, njoftime etj.
- Gjatë vitit 2022 ka vijuar procesi i **asistencës së dhënë autoriteteve kontraktore** në hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, duke u asistuar pothuajse gjysma e procedurave të publikuara në Sistemi i Prokurimit Elektronik (SPE), si dhe duke asistuar çdo kërkesë paraprake të paraqitur nga autoritetet kontraktore. Niveli i procedurave pa problematika në hartimin e dokumenteve të tenderit, është rritur krahasimisht me vitin 2021 me masën 12%, si dhe niveli i reflektimit të autoriteteve kontraktore, kundrejt rekomandimeve të APP, rezulton në nivele pothuajse të njëjta krahasimisht me vitin 2021.
- APP ka vijuar punën për verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit nëpërmjet monitorimit ex post të tyre. Një rëndësi e posaçme gjatë këtij viti i është kushtuar monitorimit të ankandëve dhe procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë për të cilat në strukturën e APP është parashikuar një njësi e dedikuar.
- Gjithashtu me rëndësi është edhe procesi i hetimit administrativ në lidhje me operatorët ekonomikë veçanërisht respektimit nga ana e tyre e detyrimit për plotësimin e kriterëve të detyrueshme për kualifikim të parashikuara nga ligji dhe rritjen e përgjegjshmërisë së tyre në këtë drejtim.
- Gjatë vitit 2022, APP ka shqyrtuar formularët e planeve të zbatimit të kontratës dhe formularët e raportimit për zbatimin e kontratës, të dërguara nga autoritetet kontraktore, duke evidencuar mangësitë dhe problematikat e tyre dhe duke asistuar autoritetet kontraktore, për shmangien e këtyre mangësive dhe problematikave dhe zbatimin e kontratave sipas kushteve në të cilat janë prokuruar.
- Gjatë vitit 2022 ka vijuar bashkëpunimi me Shkollën e Administratës Publike për **ngritjen e kapaciteteve të Autoriteteve Kontraktore** si dhe bashkëpunime me OSBE dhe mediat e shoqërisë civile në kuadër të Cybersecurity bashkëpunimi me U.S. Department of Commerce and Infrastructure Security Agency (CISA) në Workshop Data monitoring and analysis-Good practices from the SEE region Good practices from Albania.



- **Përmirësimi i sistemit elektronik** të prokurimit me qëllim përshtatjen e tij me ndryshimet e parashikuara në ligjin e ri. Parashikimi i procedurave dhe mekanizmave të rinj nga ligji i ri i prokurimit e bën të nevojshme edhe përmirësimin e sistemit elektronik si nga ana funksionale dhe rritje e mëtejshme e sigurisë me qëllim garantimin e mjeteve të duhura për zbatimin e plotë të dispozitave ligjore.

Krijimi i procedurës **shërbime sociale dhe të tjera në SPE**. Referuar Vendimit Nr. 768, datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe të tjera”, është krijuar ne sistem procedura e prokurimit “Shërbime sociale” me qëllim zhvillimin e saj ne sistem nga autoritetet kontraktore referuar VKM se sipërcituar. Ky zhvillim është realizuar si për elementet e regjistrit ashtu edhe për procedure e prokurimit.

- Është **realizuar integrimi me sistemin e thesarit**. Asnjë autoritet kontraktor i cili ndërvepron me sistemin e thesarit nuk mund të vijojë me krijimin e procedurës së prokurimit pa u miratuar dhe kontrolluar disponueshmëria e fondeve në sistem. Gjithashtu ne bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është përgatitur Manuali i Përdorimit dhe njoftimi për te gjithë përdoruesit e SPE, për mënyrën se si duhet te veprojnë me krijimin e procedurës se prokurimit.
- **Implementimi i kodit output investime dhe shërbime**. Autoritetet kontraktore, të cilat nuk ndër veprojnë me thesarin apo janë me fondet e tyre duhet të përcaktojnë në sistem fillimisht nëse procedura e prokurimit është investim apo shërbim si dhe kodin dhe fondin përkatës, që më pas të vijojnë me krijimin e fazave të tjera të procedurës se prokurimit.
- APP ka vijuar ti kushtojë rëndësinë e duhur **forcimit të kapaciteteve institucionale** si një instrument i rëndësishëm dhe thelbësor në mirëfunksionimin e institucionit dhe në mirë zbatimin e dispozitave ligjore.




TË DHËNA STATISTIKORE MBI SISTEMIN E PROKURIMIT PUBLIK NË SHQIPËRI

Prokurimi publik është një nga fushat kryesore të veprimtarisë shtetërore dhe një nga proceset më të rëndësishme në menaxhimin e financave publike. Sikundër tregohet edhe nga shifrat dhe të dhënat e përpunuara në këtë kuadër, fondi buxhetor i shpenzuar për prokurime publike në vendet e rajonit për vitin 2021 shkon mesatarisht nga 4.47-11% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Konkretisht sikundër paraqitet edhe në Grafikon nr. 1 më poshtë, sipas të dhënave të publikuara rezultojnë se:

- **Kosova:** Sipas raportit të Komisionit Europian, në vitin 2021, Prokurimi Publik arriti në 5.65% të PBB, me një ulje nga përqindja e vitit 2020, kur Prokurimi Publik zinte 7.5% të PBB.²
- **Serbia:** Sipas raportit të Komisionit Europian, në vitin 2021, Prokurimi Publik arriti në rreth 8.9% të PBB, duke pësuar një rritje nga përqindja e vitit 2020, kur Prokurimi Publik zinte 6.8% të PBB.³
- **Mali i Zi:** Sipas raportit të Komisionit Europian, në vitin 2021, Prokurimi Publik zë 4.47% të PBB, duke pësuar një ulje të konsiderueshme nga përqindja e vitit 2020, kur Prokurimi Publik zinte 13.1% të PBB.⁴
- **Maqedonia e Veriut:** Sipas raportit të Komisionit Europian, në vitin 2021, Prokurimi Publik, përfaqëson 11% të PBB, duke pësuar një rritje nga përqindja e vitit 2020, kur Prokurimi Publik zinte 8.5% të PBB.⁵
- **Shqipëria:** Sipas analizës vjetore të vitit 2021, publikuar nga APP, prokurimi publik për vitin 2021 zinte rreth 8.9% të PBB, duke pësuar një ulje nga përqindja e vitit 2020, kur Prokurimi Publik zinte 14.7% të PBB.⁶

Grafiku 1



2 European Commission (2022), Kosovo Report, pg. 71
https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2022_en

3 European Commission (2022), Serbia Report, pg. 79
https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/serbia-report-2022_en

4 European Commission (2022), Montenegro Report, pg. 72
https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/montenegro-report-2022_en

5 European Commission (2022), North Macedonia Report, pg. 60
https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2022_en

6 Analiza Vjetore 2021, APP, pg. 8



Burimi: Të dhëna të marra nga Raportet e Komisionit European për vendet e Rajonit dhe analiza vjetore e APP


Nga përpunimi i të dhënave në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe bazuar në të dhënat paraprake të siguruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë⁷ mbi Produktin e Brendshëm Bruto (PBB), rezulton se, për vitin 2022 **fondi total limit i publikuar zë 9.4% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB)**. Tabela dhe grafiku i mëposhtëm paraqesin të dhënat në lidhje me raportin “Fond total limit i publikuar-PBB”:

Tabela 1

Treguesi makroekonomik	Vlera (në miliardë Lekë)
PBB- Produkti Brendshëm Bruto	1,803,000,000,000
Fondi total limit i publikuar në Republikën e Shqipërisë	170,200,854,721
Fondi total limit i publikuar në Republikën e Shqipërisë në raport me PBB (në %)	9.4%

Grafiku 2

Raporti i Fondit total Limit të publikuar në 2022, ndaj PBB



■ Fondi total Limit i publikuar në Republikën e Shqipërisë ■ PBB- Produkti i Brendshëm Bruto

Siç tregohet nga të dhënat e mësipërme, gjatë vitit 2022 raporti i fondit total limit me PBB ka pësuar rritje të lehtë në krahasim me atë të vitit 2021 (8.9%).

⁷ Sipas parashikimeve zyrtare paraprake për 2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (<https://financa.gov.al/kuadri-makroekonomik-dhe-fiskal-2/>) Produkti i Brendshëm Bruto për vitin 2022 është: 1,803,000,000,000.



2.1 Statistika në lidhje me regjistrat e parashikimeve të krijuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik për vitin 2022

Regjistri i parashikimit dhe regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit publik përgatiten elektronikisht dhe publikohen në Sistemin e Prokurimit Elektronik, ku janë të aksesueshme pa pagesë nga çdo i interesuar dhe në çdo kohë.

Publikimi dhe automatizimi i këtyre dy regjistrave ka një rëndësi shumë të madhe jo vetëm për planifikimin në kohë të nevojave të Autoriteteve Kontraktore për vitin në vijim, por edhe për garantimin e transparencës në lidhje me përdorimin dhe menaxhimin e fondeve publike duke ofruar informacion në kohë reale mbi të gjitha procedurat dhe fondet publike që do të prokurohen gjatë vitit për operatorët ekonomikë dhe çdo person tjetër të interesuar.

Gjithashtu, automatizimi i regjistrave i mundëson APP-së identifikimin e të dhënave për prokurimet e planifikuara dhe të realizuara nga autoritetet kontraktore në kohë reale.

Nga të dhënat e Regjistrin Kombëtar të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit për vitin 2022, rezultone janë publikuar gjithsej 39,687 elementë në regjistrat e parashikimit të prokurimeve (element të rinj dhe ndryshime).

Konkretisht, detajimi i elementëve në Regjistrin Kombëtar të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit është si më poshtë:

Tabela 2


Tipi i Kontratës	Lloji i procedurës së prokurimit	VITI 2022
Punë	Prokurime me vlerë mbi Kufirin monetar për prokurimet me vlerë të vogël	1869
	Prokurime me vlerë të vogël	561
	Procedura me negociim, pa shpallje paraprake	16
	Modifikimet e Kontratës	8
Mallra	Prokurime me vlerë mbi Kufirin monetar për prokurimet me vlerë të vogël	5457
	Prokurime me vlerë të vogël	8463
	Procedura me negociim, pa shpallje paraprake	54
	Modifikimet e Kontratës	5
	Blerje me vlerë nën 100,000 lekë	7040
Shërbime	Prokurime me vlerë mbi Kufirin monetar për prokurimet me vlerë të vogël	2656
	Prokurime me vlerë të vogël	5715
	Procedura me negociim, pa shpallje paraprake	46
	Modifikimet e Kontratës	9
	Blerje dinamike e biletave	369
	Blerje me vlerë nën 100,000 lekë	7270



Nga monitorimi i Elementeve të Regjistrit të Parashikimeve dhe Realizimeve në SPE në vitin 2022, rezulton se janë **39687** elementë të parashikuar në regjistrë, nga të cilët **35460** elementë ose 89% e totalit kanë vijuar me procedurat, ndërsa **4227** elemente ose 11% e totalit janë me statusin të anuluar. Në formë grafike, të dhënat paraqiten si më poshtë vijon:

Grafiku 3

Elementët në Regjistrin Kombëtar të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit



■ Elementët e parashikuar me statusin të paanulluar ■ Elementët e parashikuar me statusin të anuluar

Nga analizimi i elementeve në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik, të cilët kanë vijuar me shpalljen e procedurave nga autoritetet kontraktore rezulton se 5402 elementë kanë pësuar ndryshime gjatë vitit.

Shkalla e ndryshimeve në regjistrin e parashikimeve, është një tregues i rëndësishëm i performancës në zbatimin e buxhetit dhe mirë planifikimit nga ana e autoriteteve kontraktore.

Nëse do analizojmë vetëm Performancën e Regjistrit të Parashikimeve të shprehur në përqindje si raport i elementëve të ndryshuara ndaj totalit të elementëve me statusin të pa anuluar ($5402/35460 \times 100$), rezulton se ato paraqiten në masën **15.23 %**, sikurse paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3

Performanca e Regjistrit të Parashikimit	
Janar-Dhjetor 2022	Numri i Elementeve
Total Numri i elementëve të Regjistrit të Parashikimit (të paanulluar)	35460
Numri i elementeve të Regjistrit të Parashikimit të ndryshuara	5402
Performanca ose % e elementeve të ndryshuara ($5402/35460 \times 100$)	15.23%


Siç vërehet më lart, rreth 85% e elementeve që janë Elemente të Regjistrit të publikuara (të parashikuara e të realizuara, si dhe në proces realizimi) janë pa ndryshime.

Krahasuar me vitin 2021 ku përqindja e zërave të regjistrit që kanë pasur ndryshime ishte 16.1%, në vitin 2022 vërehet një ulje e kësaj përqindje në masën 15.23%, duke treguar një performancë më të mirë krahasuar me vitin 2021.

Në diagramën e mëposhtme paraqitet performanca e elementeve të regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit për vitin 2022.

Grafiku 4

Performanca e Regjistrimit të Parashikimit Janar-Dhjetor 2022



- Numri i elementeve të Regjistrimit të Parashikimit të Ndryshuara
- Numri i elementeve të Regjistrimit të Parashikimit të Pandryshuara

Pavarësisht një përmirësimi të lehtë dhe trendit pozitiv krahasuar me vitin 2021, nevojitet ende angazhim nga të gjithë aktorët e përfshirë për përmirësim të mëtejshëm të performancës së sistemit të prokurimit publik.

2.2 Statistika në lidhje me numrin e procedurave të prokurimit publik të shpallura gjatë vitit 2022 në Sistemin e Prokurimit Elektronik

Në këtë seksion paraqiten të dhënat e detajuara, lidhur me procedurat e prokurimit publik, përfshirë procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, procedurat me vlerë të vogël dhe sistemin dinamik të zhvilluara në Republikën e Shqipërisë, gjatë vitit 2022.

Në mënyrë të përmbledhur, të dhënat kryesore për procedurat me vlerë mbi kufirin monetar për **prokurimet me vlerë të vogël** dhe procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, si dhe raportet në përqindje dhe fondi i kursyer në total, për vitin 2022, paraqiten si më poshtë:

Tabela 4

Procedura prokurimi tewshpallura dhe Procedura me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit për Periudhën Janar-Dhjetor 2022	
Nr.Total i Procedurave/Loteve të shpallura në SPE	6,494
Fondi limit total i shpallur në SPE	170,200,854,721
Nr.total i Procedurave/Loteve të shpallura në SPE dhe të vazhduara	4,679
% që ze nr.total i Procedurave/Loteve të shpallura në SPE dhe të vazhduara ndaj totalit të procedurave	72%
Fondi limit i Procedurave/Loteve të shpallura në SPE dhe të vazhduara	147,038,493,139
% që zë fondi i procedurave të vazhduara ndaj fondit limit të totalit të procedurave	86%
Numri Total i Procedurave të përfunduara me fitues	4,507
% që ze numri Total i Procedurave të përfunduara me fitues ndaj totalit të procedurave	69.4%



Fondi total limit i procedurave të përfunduara me fitues (vlera në lekë)	134,398,774,490
Nr. Total i Procedurave të fituara Negocim pa shpallje	157
Fondi limit total për procedurat me negociim pa shpallje	1,273,811,249
% që zë nr Total i procedurave me negociim pa shpallje paraprake ndaj nr total të procedurave të përfunduara me fitues (procedura të tjera+negocim pa shpallje)	3.3%
% që zë fondi total limit për procedurat me negociim pa shpallje ndaj fondit total limit të procedurave të përfunduara me fitues (procedura të tjera+negocim pa shpallje)	0.9%
KURSIMI TOTAL	
% që zë Vlora totale e fituar ndaj Fondit total limit të prokuruar	91,6%
Vlora totale e kursyer në lekë pa TVSH	11,290,275,257
% që zë Vlora totale e Kursyer ndaj Fondit total limit të prokuruar	8,4%

Sikurse tregohet nga tabela e mësipërme, përsa i përket numrit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, për periudhën Janar–Dhjetor 2022 janë zhvilluar gjithsej 157 procedura.

Krahasuar me numrin total të procedurave të përfundura me fitues (procedura të tjera+negocim pa shpallje), procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës përbëjnë **3.3%** të tyre, duke mbetur pothuajse në të njëjtat nivele me vitin 2021 ku këto procedura zinin 3.4% të procedurave të përfunduara me fitues.

Në çdo rast, sikundër rezultojnë nga të dhënat e mësipërme, fondi limit i publikuar për këtë lloj procedure (**1,273,811,249** lekë) është shumë më i ulët, krahasuar me fondin limit total të procedurave të përfunduara me fitues (procedura të tjera+negocim pa shpallje) (135,672,585,738 lekë) duke zënë vetëm **0.9%** të fondit total të procedurave të përfundura me fitues.

2.3. Statistika për procedurat konkurruese të prokurimit, të zhvilluara në Sistemin e Prokurimit Elektronik

Në këtë pjesë të analizës vjetore, do të pasqyrohen dhe interpretohen të dhënat mbi numrin e procedurave konkurruese të prokurimit publik mbi kufirin monetar për prokurimet me vlerë të vogël, të cilat janë shpallur për t'u zhvilluar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Gjithashtu, në këtë pjesë do të pasqyrohen të dhënat respektive për numrin e njoftimeve të fituesve dhe numrin e njoftimeve të kontratave të nënshkuara dhe do të bëhet analiza e këtyre të dhënave.

2.3.1. Statistika sipas Tipit të kontratës

Numri total i njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2022 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas tipit të kontratës, shërbim, mall, punë, është **6494** (1415 më shumë se në vitin 2021 ku janë shpallur 5079 procedura konkurruese).



Konkretisht, numri i procedurave sipas kontratave paraqitet si më poshtë:

Tabela 5

Njoftime Procedurash Viti 2022					
Shërbime		Mallra		Punë publike	
Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve procedurave
Procedurë e hapur	286	Procedurë e hapur	854	Procedurë e hapur	502
E hapur për Shërbimet Sociale dhe shërbimet e tjera specifike	1	E hapur për Shërbimet Sociale	0	E hapur për Shërbimet Sociale	0
E hapur mbi kufirine lartë monetar	248	E hapur mbi kufirine lartë monetar	556	E hapur mbi kufirin e lartë monetar	39
E Hapur e Thjeshtuar	899	E Hapur e Thjeshtuar	2289	E Hapur e Thjeshtuar	541
Shërbim Konsulence/ Konkurs Projektimi	98	Shërbim Konsulence/ KonkursProjektimi	0	Shërbim Konsulence/ Konkurs Projektimi	0
E kufizuar	3	E kufizuar	2	E kufizuar	11
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	15	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	5	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	0
E kufizuar përRindërtimin	79	E kufizuar për Rindërtimin	0	E kufizuar përRindërtimin	62
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	3	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	0	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	1
TOTALI	1,632	TOTALI	3,706	TOTALI	1,156

Nga analizimi i të dhënave për vitin 2022 vërehet se, numrin më të madh të procedurave të shpallura e zënë procedurat për prokurimin e mallrave me 3,706 procedura të shpallura në total ose 57% të procedurave të shpallura, duke vijuar me procedurat për prokurimin e shërbimeve me 1,632 procedura të shpallura në total ose 25% dhe procedurat për punë civile me 1,156 procedura të shpallura në total ose 18%.

Sikurse vërehet nga tabela e mësipërme, rezulton se, gjatë vitit 2022 është rritur ndjeshëm numri i procedurave “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” me 843 procedura të shpallura ose 12,9% të totalit të procedurave të shpallura, nga 280 (5.5%) që ishin në vitin 2021.

Gjithashtu, fondi limit i këtyre procedurave për vitin 2022 (81,464,153,241 lekë) përbën një vlerë të konsiderueshme krahasuar me fondin limit të shpallur në vitin 2021 për këtë lloj procedure. Fondi limit i procedurave “e hapur mbi kufirin e lartë monetar” ze 48% të fondit total limit të procedurave të shpallura në vitin 2022 nga 40.3% që zinte në vitin 2021.

Rritja e numrit dhe vlerave përkatëse të këtyre lloj procedurave shpjegohet me ndryshimin e kufijve monetarë nga legjislacioni i ri i prokurimit duke ulur vlerën e kufirit të lartë monetar në mënyrë të konsiderueshme.



Vlen të theksohet se, viti 2022 është viti i parë kalendarik i plotë gjatë të cilit janë zbatuar dispozitat e reja ligjore pas miratimit të ligjit të ri të prokurimit, ndërkohë që gjatë vitit 2021 këto rregulla të reja u zbatuan vetëm në gjysmën e dytë të vitit.

2.3.2. Statistika sipas llojit të procedurave


Të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurës, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2022 dhe fondet limite përkatëse, janë si më poshtë:

Tabela 6

Numri total i procedurave të shpallura të ndarë sipas llojit të procedurave për Periudhën Janar - Dhjetor 2022	
Numri Total i Procedurave të shpallura	6,494
Fondi total limit i procedurave të shpallura (vlera në lekë pa TVSH)	170,200,854,721
Numri i procedurave Shërbim konsulence dhe konkurs projektimi	98
Fondi limit i procedurave Shërbim konsulence dhe konkurs projektimi (vlera në lekë pa TVSH)	2,113,307,703
Numri i procedurave E hapur për shërbimet sociale dhe shërbimet e tjera specifike	1
Fondi limit i procedurave E hapur për shërbimet sociale dhe shërbimet e tjera specifike	40,113,896
Numri i procedurave E hapur mbi kufirin e lartë monetar	843
Fondi limit i procedurave E hapur mbi kufirin e lartë monetar (vlera në lekë pa TVSH)	81,464,153,241
Numri i Procedurave E hapur	1,642
Fondi limit i Procedurave E hapur (vlera në lekë pa TVSH)	48,133,758,110
Numri i procedurave E hapur e Thjeshtuar	3,729
Fondi limit i procedurave E hapur e Thjeshtuar (vlera në lekë pa TVSH)	10,514,963,892
Numri i procedurave E Kufizuar	16
Fondi limit i procedurave E Kufizuar (vlera në lekë pa TVSH)	3,574,219,674
Numri i procedurave E kufizuar mbi Kufirin e lartë	20
Fondi limit i procedurave E kufizuar mbi Kufirin e lartë (vlera në lekë pa TVSH)	7,234,348,405
Numri i procedurave E Kufizuar për Rindërtimin	141
Fondi limit i procedurave E Kufizuar për Rindërtimin (vlera në lekë pa TVSH)	15,689,910,055
Numri i procedurave E kufizuar mbi kufirin e lartë për Rindërtimin	4
Fondi limit i procedurave E kufizuar mbi kufirin e lartë për Rindërtimin (vlera në lekë pa TVSH)	1,436,079,745

Grafiku i mëposhtëm paraqet, përqindjen e numrit të procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurës, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2022:

Grafiku 5



Sikurse vërehet në të dhënat e mësipërme numrin më të madh të procedurave e zë procedura “**E Hapur e Thjeshtuar**” me 3,729 procedura të shpallura ose 58% të numrit total të procedurave të shpallura.

Gjithashtu, sa i takon llojeve të tjera të procedurave rezulton se procedura “E hapur” përbën 25% të numrit total me 1,642 procedura të publikuara, procedura “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” zë 12.9% të numrit total me 843 procedura të publikuara, procedura “Shërbim Konsulence” zë 2% të numrit total me 98 procedura të publikuara, procedura “E kufizuar” zë 0,2% të numrit total me 16 procedura të publikuara, procedura “E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar” zë 0,3% të numrit total me 20 procedura të publikuara, procedura “E kufizuar për Rindërtimin” zë 2% të numrit total me 141 procedura të publikuara dhe procedura “E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin” zë vetëm 0,06% të numrit total me 4 procedura të publikuara .

Ndërkohë, shpërndarja e fondeve sipas llojit të procedurave paraqitet si në vijim.


Tabela e mëposhtme paraqet, përqindjen e Fondit Limit të procedurave të prokurimit publik të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2022, detajuar sipas llojit:



Tabela 7

Lloji i procedurës	Fondi limit sipas llojit të procedurave	% e Fondit limit të procedurave sipas llojit ndaj totalit
E Hapur	48,133,758,110	28,3%
E hapur për Shërbimet Sociale dhe shërbimet e tjera specifike	40,113,896	0,02%
E Hapur mbi Kufirin e lartë monetar	81,464,153,241	47,9%
E Hapur e Thjeshtuar	10,514,963,892	6,2%
Shërbim Konsulence + Konk.Projekt	2,113,307,703	1,2%
E kufizuar	3,574,219,674	2,1%
E kufizuar për Rindërtimin	7,234,348,405	4,3%
E kufizuar mbi kufirin e lartë	15,689,910,055	9,2%
E kufizuar mbi kufirin e lartë për Rindërtimin	1,436,079,745	0,8%
TOTALI	170,200,854,721	100,0%

Grafiku 6



Sa i takon Fondit Limit të procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurave të zhvilluara për vitin 2022, sikur vërehet në të dhënat e mësipërme, përqindjen më të madhe e zë procedura “E Hapur mbi kufirin e lartë monetar” me fond limit 81,464,153,241 lekë pa TVSH, ose 47,9% të Fondit Limit total të procedurave të shpallura.

Krahasuar me vitin 2021 ku procedura “E Hapur mbi Kufirin e lartë monetar” ka pasur Fondin Limit 60,320,831,429 lekë pa TVSH, sikurse e theksuam edhe më sipër, rezulton se fondi limit i procedurës “E Hapur mbi Kufirin e lartë monetar” (81,464,153,241 lekë) publikuar në vitin 2022 është 35% më i madh se në vitin 2021.



Sikurse analizuar më sipër, ky fakt ka ndodhur për shkak të ndryshimeve të kufijve monetarë, duke bërë që të prokurohen më shumë fonde se çdo vit tjetër me procedura konkurruese mbi kufijtë e lartë monetarë, për të cilat zbatohen të njëjtat afate dhe kërkesa të parashikuara në Direktivat e BE-së. Kjo do të thotë që pothuajse 60% e fondit limit për vitin 2022 është prokuruar sipas afateve dhe kërkesave të parashikuara dhe të zbatuara në vendet e BE-së.

2.3.3. Statistika për procedurat e prokurimit të publikuara dhe të vazhduara gjatë vitit 2022, sipas 3 muajorëve

Në formë tabelore, të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2022 dhe fondet limite përkatëse, sipas 3 muajorëve janë si më poshtë:

Tabela 8

Statistika mbi Procedurat e Prokurimit të vazhduara sipas 3 muajoreve Viti 2022					
Nr.	Emërtimi	Nr. Procedura/ Lote Publikuara	Fondi limit Lekë pa TVSH	% Numrit të procedurave/ Loteve të 3 muajorit ndaj totalit	% e Fondit Limit të 3 muajorit ndaj totalit
1	Publikime Procedura Prokurimi në SPE 3 muajori I-rë viti 2022	652	24,267,393,416	14%	17%
2	Publikime Procedura Prokurimi në SPE 3 muajori II-të viti 2022	1379	43,388,303,610	29.5%	30%
3	Publikime Procedura Prokurimi në SPE 3 muajori III-të viti 2022	1286	37,584,705,566	27.5%	26%
4	Publikime Procedura Prokurimi në SPE 3 muajori IV-t viti 2022	1362	41,798,090,546	29%	28%
	TOTALI	4679	147,038,493,138	100%	100%

Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme, në tremujorin e II-të dhe të IV-të kemi numrin më të madh të procedurave të shpallura dhe të vazhduara që zënë 58,5 % të totalit. Po kështu, edhe fondi limit i procedurave të shpallura e të vazhduara në tremujorin e II-të dhe të IV-të ka zënë 58% të totalit.

Numri i lartë i procedurave të shpallura në tremujorin e IV-të shpjegohet me faktin se në këtë periudhë fillojnë të shpallen edhe procedura të reja për vitin e ardhshëm buxhetor.


Megjithatë, vërehet që në krahasim me vitin 2021 ka një rritje të konsiderueshme të procedurave që janë shpallur në tremujorin e III-të. Me qëllim rritjen e performancës të sistemit të prokurimit publik në përgjithësi duhet të rritet angazhimi i Autoriteteve Kontraktore për shpalljen e procedurave kryesisht në gjysmën e parë të vitit.



Grafiku i mëposhtëm paraqet, përqindjen e procedurave të prokurimit publik të vazhduara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2022, sipas 3 mujorëve:

Grafiku 7

Publikimet e Procedurave të vazhduara në % sipas tre-mujorëve



- Publikime Procedura Prokurimi në SPE 3 mujori I-rë viti 2022
- Publikime Procedura Prokurimi në SPE 3 mujori II-të viti 2022
- Publikime Procedura Prokurimi në SPE 3 mujori III-të viti 2022
- Publikime Procedura Prokurimi në SPE 3 mujori IV-t viti 2022

2.3.4. Statistika mbi numrin e njoftimeve të kontratave për procedurat e prokurimit të publikuara gjatë vitit 2022, krahasuar me vitin 2021.

Për sa i përket, numrit të njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të publikuara, sipas tipit të kontratës për vitin 2022, krahasuar me vitin 2021 paraqitet si më poshtë:

Tabela 9

Krahasime Publikime Procedura Konkurruese Viti 2022 me Vitin 2021 sipas Tipit të kontratës		
Viti	2021	2022
Shërbime	1,421	1,632
Mallra	2,575	3,706
Punë	1,083	1,156
Numri Total i Procedurave	5,079	6,494
Vlera totale Fondi limit	149,320,420,249	170,200,854,721



Përsa i përket, numrit të njoftimeve për procedurat e prokurimit për vitin 2022, sipas llojit të procedurës krahasuar me vitin 2021 paraqitet si më poshtë:

Tabela 10

Numri i njoftimeve të procedurave Konkurruese krahasimore viti 2022 me vitin 2021, sipas llojit të procedurës së prokurimit		
Lloji i procedurës	Viti 2021	Viti 2022
Procedurë e Hapur	1,452	1,642
E hapur për Shërbimet Sociale dhe shërbimet e tjera specifike	0	1
E Hapur mbi Kufirin e lartë monetar	280	843
E Hapur e Thjeshtuar	3,098	3,729
Shërbim Konsulence+Konk.Projekt	98	98
E kufizuar	6	16
E kufizuar për Rindërtimin	142	141
E kufizuar mbi kufirin e lartë	0	20
E kufizuar mbi kufirin e lartë për Rindërtimin)	3	4
Numri i Procedurave	5,079	6,494
Vlera totale Fondi limit	149,320,420,249	170,200,854,721

Ajo që vërehet nga të dhënat e kësaj tabele, është fakti se për vitin 2022 rezultojnë të shpallura një numërmë i madh i procedurave (6,494), krahasuar me vitin 2021 ku janë shpallur (5,079), ose e thënë në përqindje 27.8% më shumë procedura.


Gjithashtu, fondi limit i procedurave të shpallura për vitin 2022 (170,200,854,721 lekë pa TVSH), është kon- siderueshëm më i lartë (14%) se fondi limit i procedurave të shpallura për vitin 2021 (149,320,420,249 lekë pa TVSH).

Në vitin 2022 rezultojnë të shpallura 181 procedura “E Kufizuar” dhe “E Kufizuar mbi kufirin e lartë monetar” me fond limit total prej 27,934,557,879 lekë, por këto procedura kanë pasur si objekt kryesisht shërbimet e mbikqyrjes apo të rikonstruksionit të punimeve që zhvillohen në kuadër të procesit të rindërtimit (145).

Në grafikun e mëposhtëm, paraqitet numri i procedurave të shpallura në mënyrë krahasimore sipas llojit të procedurës, respektivisht në vitin 2021 dhe 2022.



Grafiku 8



Përsa i përket të dhënave mbi vlerat e fondit limit për procedurat e shpallura në vitin 2022 krahasuar me vlerat e fondit limit për procedurat e shpallura në vitin 2021, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 11


Vlerat e Fondit Limit të njoftimeve të procedurave Konkurruese Krahasime viti 2021 me vitin 2022, sipas llojit të procedurës së prokurimit		
Lloji i procedurës	Viti 2021	Viti 2022
Procedurë e Hapur	56,079,357,875	48,133,758,110
E hapur për Shërbimet Sociale dhe shërbimet e tjera specifike	0	40,113,896
E Hapur mbi Kufirin e lartë monetar	60,320,831,429	81,464,153,241
E Hapur e Thjeshtuar	9,414,018,648	10,514,963,892
Shërbim Konsulence+Konk.Projekt	3,356,417,307	2,113,307,703
E kufizuar	770,879,530	3,574,219,674
E kufizuar për Rindërtimin	15,767,419,365	15,689,910,055
E kufizuar mbi kufirin e lartë	0	7,234,348,405
E kufizuar mbi kufirin e lartë për Rindërtimin	3,611,496,095	1,436,079,745
Vlera totale Fondi limit	149,320,420,249	170,200,854,721

Nga analiza e vlerave krahasuese të paraqitura në tabelën e mësipërme, vërehet se ka një rritje të vlerës së prokuruar në vitin 2022, krahasuar me atë të prokuruar në vitin 2021.

Në grafikun e mëposhtëm, paraqiten numri i procedurave të shpallura në mënyrë krahasimore dhe vlerate fondit limit, respektivisht për vitin 2021 dhe 2022.

Grafiku 9

Fondi limit i procedurave Janar- Dhjetor




Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, paraqitet numri i procedurave të shpallura në mënyrë të detajuar, respektivisht në periudhën Janar – Dhjetor 2021 dhe Janar – Dhjetor 2022, sipas muajve.

Tabela 12

Krahasim Numri i procedurave të shpallura në Sistemin e Prokurimit Elektronik viti 2021 me vitin 2022		
Viti	2021	2022
Janar	291	164
Shkurt	629	350
Mars	794	396
Prill	249	699
Maj	327	856
Qershor	339	529
Korrik	314	423
Gusht	390	758
Shtator	381	657
Tetor	427	594
Nentor	521	488
Dhjetor	417	580
Totali	5,079	6,494



Grafiku 10



Vihet re se ecuria e procedurave të vazhduara gjatë vitit 2022, reflekton ritmin dhe shpërndarjen e procedurave të shpallura gjatë vitit.

2.4. STATISTIKA SIPAS NJOFTIMEVE TË FITUESIT

Në këtë pjesë të raportit, do të pasqyrohen të dhënat respektive në lidhje me publikimin e njoftimeve të fituesve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe do të bëhet analiza e këtyre të dhënave.

Numri total i njoftimeve të fituesit të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2022 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas tipit të kontratave, shërbim, mall, punë, është 4,507 (429 më shumë se në vitin 2021).

2.4.1. Statistika mbi numrin e njoftimeve të fituesve të publikuar gjatë vitit 2022, sipas tipit të kontratës

Në formë tabelore, të dhënat për procedurat e prokurimit elektronik, të ndara sipas tipit të kontratës të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues në SPE gjatë vitit 2022, janë si më poshtë:



Tabela 13

Numri i njoftimeve të fituesve të shpallur sipas tipit të kontratës Viti 2022					
Shërbime		Mallra		Punë publike	
Lloji i Procedurës	Numri njoftime fituesi	Lloji i Procedurës	Numri njoftime fituesi	Lloji i Procedurës	Numri njoftime fituesi
Procedurë e hapur	170	Procedure e Hapur	433	Procedure e Hapur	413
E hapur për Shërbimet Sociale dhe shërbimet e tjera specifike	1	E hapur për Shërbimet Sociale dhe shërbimet e tjera specifike	0	E hapur për Shërbimet Sociale dhe shërbimet e tjera specifike	0
E hapur mbi kufirin e lartë monetar	155	E hapur mbi kufirin e lartë monetar	508	E hapur mbi kufirin e lartë monetar	30
E Hapur e Thjeshtuar	695	E Hapur e Thjeshtuar	1430	E Hapur e Thjeshtuar	389
Shërbim Konsulence e Konkurs Projektimi	74	Shërbim Konsulence e Konkurs Projektimi	0	Shërbim Konsulence e Konkurs Projektimi	0
E kufizuar	1	E kufizuar	0	E kufizuar	9
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	12	E kufizuar mbi Kufirin e lartë monetar	1	E kufizuar mbi Kufirin e lartë monetar	0
E kufizuar per Rindërtimin	119	E kufizuar për Rindërtimin	13	E kufizuar për Rindërtimin	48
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	1	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	0	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	5
TOTALI	1,228	TOTALI	2,385	TOTALI	894

Nga të dhënat e tabelës rezulton se numri më i lartë i procedurave të përfunduara me fitues është për kontratat e mallrave me 2,385 fitues ose 53 % të totalit të fituesve, më tej “Shërbime”, me 1,228 fitues ose 27,2 % të totalit të fituesve, si dhe “Punë publike”, me 894 fitues ose 19,8 % të totalit të fituesve.



Tabela 14

Fondi limit i procedurave të përfunduara me fitues sipas tipit të kontratës Viti 2022					
Shërbime		Mallra		Punë publike	
Lloji i Procedurës	Fondi limit njoftime fituesi	Lloji i Procedurës	Fondi limit njoftime fituesi	Lloji i Procedurës	Fondi limit njoftime fituesi
Procedurë e hapur	2,738,489,886	Procedurë e Hapur	6,310,975,680	Procedurë e Hapur	29,479,954,891
E hapur për Shërbimet Sociale dhe shërbimet e tjera specifike	40,113,896	E hapur për Shërbimet Sociale dhe shërbimet e tjera specifike	0	E hapur për Shërbimet Sociale dhe shërbimet e tjera specifike	0
E hapur mbi kufirin e lartë monetar	15,159,993,088	E hapur mbi kufirin e lartë monetar	26,733,925,028	E hapur mbi kufirin e lartë monetar	19,825,170,910
E Hapur e Thjeshtuar	1,751,555,760	E Hapur e Thjeshtuar	4,088,463,212	E Hapur e Thjeshtuar	2,025,655,619
Shërbim Konsulence e Konkurs Projektimi	1,564,254,298	Shërbim Konsulence e Konkurs Projektimi	0	Shërbim Konsulence e Konkurs Projektimi	0
E kufizuar	12,732,014	E kufizuar	0	E kufizuar	2,707,194,412
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	6,052,816,930	E kufizuar mbi Kufirin e lartë	271,602,530	E kufizuar mbi Kufirine lartë	0
E kufizuar per Rindërtimin	622,624,162	E kufizuar E kufizuar per Rindërtimin	485,418,871	E kufizuar E kufizuar per Rindërtimin	11,688,778,270
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	6,009,109	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	0	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	2,833,045,924
TOTALI	27,948,589,143	TOTALI	37,890,385,321	TOTALI	68,559,800,026

Sa i takon raportit në vlerë, sikurse vërehet nga tabela me sipër, vlera më e madhe është fituar në procedurat për “Punë Publike”(që zë 51% të fondit total të fituesve), ndjekur nga procedurat e prokurimit për mallra (28% të fondit total) dhe më pas për shërbime (21% të fondit total).



2.4.2. Statistika mbi numrin e procedurave të përfunduara me fitues të publikuara gjatë vitit 2022, sipas llojit të procedurës së prokurimit

Tabela e mëposhtme paraqet procedurat e përfunduara me fitues gjatë vitit 2022 të ndara sipas llojit të procedurës, fondit limit të prokuruar dhe vlerës së fituar:

Tabela 15

Të dhëna për procedurat e prokurimit të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues Janar -Dhjetor 2022						
Llojet e procedurave	Nr.Total i Proce-durave	Fondi limit total i publikuar (vleranë Lekë pa TVSH)	Vlera totale e ofruar (Fituar) (vlera në Lekë pa TVSH)	% që zë fondi i ofruar ndaj fondit limit të publikuar	Fondi total i kursyer (vleranë Lekë)	% që ze fondi i kursyer ndaj fondit limit të publikuar
Procedurë e hapur	1,016	38,529,420,458	31,795,976,674	83%	6,733,443,784	17%
E hapur për Shërbimet Sociale dhe shërbimet e tjera specifike	1	40,113,896	38,080,000	95%	2,033,896	5%
E hapur mbi kufirin e lartë monetar	693	61,719,089,026	57,850,597,289	94%	3,868,491,737	6%
E Hapur e Thjeshtuar	2514	7,865,674,590	7,823,029,545	99%	42,645,045	1%
Shërbim Konsulencë e Konkurs Projektimi	74	1,564,254,298	1,530,828,163	98%	33,426,134	2%
E kufizuar	10	2,719,926,426	2,440,117,733	90%	279,808,693	10%
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	13	6,324,419,460	6,246,091,833	99%	78,327,627	1%
E kufizuar per Rindërtimin	180	12,796,821,303	12,624,987,947	99%	171,833,356	1%
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	6	2,839,055,033	2,758,790,048	97%	80,264,985	3%
TOTAL	4,507	134,398,774,490	123,108,499,233	91,6%	11,290,275,257	8.4%



Sikundër vërehet nga të dhënat e mësipërme, vlera më e lartë e kursimit ndaj fondit limit të publikuar, është tek “Procedura e Hapur”, që zë edhe përqindjen më të madhe prej 17% të vlerës totale të kursyer për procedurat konkurruese mbi kufirin monetar për prokurime me vlerë të vogël e ndjekur nga procedura e kufizuar me 10% kursim.


Sikurse vihet re edhe nga tabela e mesiperme ne procedurat e prokurimit mbi kufirin e larte monetar ka nje kursim te ulet.

Nga ana tjetër, sa i takon përqindjes së ulët të kursimit të fondit limit të evidentuar tek procedura “E Hapur mbi kufirin e larte monetar”, “E Kufizuar mbi Kufirin e lartë monetar (jo-rindërtim) dhe “E kufizuar për Rindërtimin”, duhet theksuar se nëpërmjet këtyre procedurave janë prokuruar kryesisht **Marrëveshje Kuadër** me kohëzgjatje më shumë se një vit për implementimin e të cilave është e nevojshme zhvillimi i minikonkurseve nga ana e AK përgjegjëse në varësi të nevojave që ka gjatë gjithë kohëzgjatjes së MK.

Në këtë kuptim, vlera reale e marrëveshjes kuadër nuk mund të matet me të dhënat e një viti, por mund të përlloraget vetëm në përfundim të afatit të saj të vlefshmërisë, duke përlloragitur edhe fondin e kursyer pas nënshkrimit të minikontratave.

Diagrama e mëposhtme paraqet, raportin në përqindje të numrit të procedurave të prokurimit publik, të përfunduara me fitues, të ndara sipas llojit të procedurës për 2022.


Grafiku 11



Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme numrin më të madh të procedurave e zë procedura “E Hapur e Thjeshtuar” me 2,514 njoftime fituesish të publikuar ose 56% të numrit total të procedurave të përfunduara me fitues.

Grafiku 12

% që zë fondi i prokuruar ndarë sipas llojit të procedurës ndaj fondit total të prokuruar



Ndërkohë, sikurse tregohet në grafikun e mësipërm, vlera më e madhe e fituar është në procedurën e hapur mbi kufirin e lartë monetar dhe e hapur.

2.4.3. Statistika mbi numrin e njoftimeve të fituesve të publikuar gjatë vitit 2022, krahasuar me vitin 2021

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, jepen të dhënat statistikore në lidhje me njoftimet e fituesve të 2022 krahasuar me 2021.

Tabela 16


Krahase Numri i Njoftimeve të Fituesve të shpallur në SPE për vitin 2022 me vitin 2021		
Viti	2021	2022
Numri i Procedurave	4,078	4,507
Vlera totale Fondi limit	189,155,455,459	134,398,774,490
Vlera totale e Prokuruar	178,422,510,498	123,108,499,233

Në grafikun e mëposhtëm, jepen të dhënat statistikore në lidhje me njoftimet e fituesve të 2021 krahasuar me 2020.



Grafiku 13

NJOFTIME FITUESI PROCEDURA SPE
JANAR - DHJETOR



Pavarësisht se numri i procedurave të shpallura gjatë vitit 2022 është më i lartë se në 2021, vlera e këtyre procedurave është më e ulët, gjë që tregon se vlerat janë shpërndarë në më shumë procedura, duke krijuar mundësi për ofertim dhe kontraktim të më shumë operatorëve ekonomikë, sidomos SME.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, paraqiten numri i njoftimeve të fituesve të shpallur në Sistemin e Prokurimit Elektronik, në mënyrë të detajuar, respektivisht në periudhën Janar–Dhjetor 2021 dhe Janar –Dhjetor 2022, sipas muajve.


Tabela 17

Krahase Numri i njoftim fituesve të shpallur në Sistemin e Prokurimit Elektronik Periudhen Janar - Dhjetor 2021 me Periudhen Janar - Dhjetor 2022		
Viti	2021	2022
Janar	299	254
Shkurt	315	214
Mars	430	302
Prill	600	236
Maj	406	321
Qershor	370	471
Korrik	227	572
Gusht	265	409
Shtator	279	360
Tetor	273	468
Nentor	287	420
Dhjetor	327	480
Totali	4078	4,507



Nga analiza e bashkënduar e tabelave vihet re se, shpërndarja e njoftimeve të fituesit sipas muajve reflekton shpërndarjen e shpalljes së procedurave.

Grafiku 14



Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme, gjatë vitit 2022 numri më i madh i njoftimeve të fituesve është shpallur gjatë 6 muajorit të II-të të vitit.

Këto të dhëna janë tregues të performancës së sistemit të prokurimit në përgjithësi, që reflekton përmirësim të planifikimit të procedurave dhe realizimit të tyre në kohë duke ndjekur dhe reflektuar ritmin e shpalljes së procedurave.

Megjithatë, nga analiza e të dhënave, rezulton se ka nevojë për më shumë angazhim nga Autoritetet Kontraktore për shpallje dhe kontraktim kryesisht në gjashtëmuajorin e parë të vitit.

2.5. STATISTIKA PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA

Në këtë pjesë të raportit, do të pasqyrohen të dhënat respektive në lidhje me publikimin e njoftimeve të Kontratave të Nënshkruara dhe Marrëveshjet Kuadër në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe do të bëhet analiza e këtyre të dhënave.

Numri total i njoftimeve të kontratave të nënshkruara dhe marrëveshjet kuadër të procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2022 në sistemin e prokurimit elektronik shpallur në faqen zyrtare të APP është 3992.



2.5.1. Statistika mbi numrin e njoftimeve të kontratave të nënshkruara dhe Marrëveshjeve Kuadër gjatë vitit 2022, sipas Tipit të kontratës

Njoftimet e kontratave të nënshkruara dhe marrëveshjet kuadër sipas llojit të procedurave dhe tipit të kontratave paraqiten si më poshtë:


Tabela 18

Njoftime Kontratash të nënshkruara për Periudhën Janar-Dhjetor 2022					
Shërbime		Mallra		Punë publike	
Lloji i Procedurës	Numri kontrata të nën-shkruara	Lloji i Procedurës	Numri kontrata të nënshkruara	Lloji i Procedurës	Numri kontrata të nënshkruara
Procedurë e Hapur	149	Procedurë e Hapur	393	Procedurë e hapur	374
E hapur për shërbimet sociale dhe shërbimet e tjera specifike	0	E hapur për shërbimet sociale dhe shërbimet e tjera specifike	0	E hapur për shërbimet sociale dhe shërbimet e tjera specifike	0
E hapur mbi kufirin e lartë monetar	113	E hapur mbi kufirine lartë monetar	349	E hapur mbi kufirin e lartë monetar	28
E hapur e Thjeshtuar	662	E hapur e Thjeshtuar	1,325	E hapur e Thjeshtuar	375
Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	68	Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	0	Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	0
E kufizuar	0	E kufizuar	0	E kufizuar	6
E kufizuar për Rindërtimin	88	E kufizuar për Rindërtimin	0	E kufizuar për Rindërtimin	46
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	12	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	1	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	0
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	0	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	0	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	3
TOTALI	1,092	TOTALI	2,068	TOTALI	832

Në diagramën e mëposhtme paraqitet, në % numri i njoftimeve të kontratave të nënshkruaradhe marrëveshjeve kuadër të ndara sipas tipit të kontratës, të shpallura në Sistemin e Prokurimit Elektronik për vitin 2022.

Grafiku 15

Njoftimet e lidhjes së kontratave në procedurat e prokurimit publik, të ndara sipas tipit të kontratës



Nga të dhënat e pasqyruara më sipër, rezulton se numri më i lartë i kontratave të nënshkruara dhe marrëveshjeve kuadër deri më tani është tipi Mall me 2,068 kontrata ose 52% të kontratave në total, më tej “Shërbime”, me 1,092 kontrata ose 27% të totalit, si dhe “Punë publike”, me 832 kontrata ose 21% të totalit.

2.5.2. Statistika mbi numrin e njoftimeve të kontratave dhe marrëveshjeve kuadër të nënshkruara gjatë vitit 2022, sipas llojit të procedurës së prokurimit

Njoftimet e kontratave dhe marrëveshjeve kuadër të nënshkruara sipas vlerës totale dhe llojit të procedurës paraqiten si më poshtë:



Tabela 19

Të dhëna për procedurat e prokurimit të përfunduara me Kontrata të nënshkruara Viti 2022					
Llojet e procedurave	Numri i kontratave të nënshkruara	Fondi limit total i prokuruar (vlera në Leke pa TVSH)	Vlera totale e fituar (Kontraktuar) (vlera në Leke pa TVSH)	% që ze vlera e fituar ndaj fondit limit të prokuruar	Fondi total i kursyer (vlera në Leke pa TVSH)
Procedurë e hapur	916	30,372,443,609	26,505,594,345	87,3%	3,866,849,264
E hapur për Shërbimet Sociale dhe shërbimet e tjera specifike	0	-	-	0,0%	-
E hapur mbi kufirin e lartë monetar	490	48,237,578,320	45,024,616,087	93,3%	3,212,962,232
E Hapur e Thjeshtuar	2,362	7,474,251,460	7,451,104,009	99,7%	23,147,451
Shërbim Konsulence e Konkurs Projektimi	68	2,265,005,754	2,032,727,376	89,7%	232,278,378
E kufizuar	6	1,750,111,079	1,612,130,843	92,1%	137,980,236
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	13	6,324,419,460	6,217,328,651	98,3%	107,090,810
E kufizuar për Rindërtimin	134	12,845,916,698	12,719,379,268	99,0%	126,537,429
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	3	2,087,583,961	2,083,984,777	99,8%	3,599,184
TOTAL	3,992	111,357,310,340	103,646,865,355	93.1%	7,710,444,985



Siç vërehet nga të dhënat e analizuara në tabelat e mësipërme rezulton se, numri i kontratave dhe marrëveshjeve kuadër të nënshkruara , 3,992 në total, është më i vogël se numri i njoftimeve të fituesve 4,507 në total, me një diferencë midis tyre prej 515 njoftimesh. Kjo diferencë shpjegohet me faktin se, pavarësisht përfundimit me fitues të procedurave, kontrata mund të mos jetë nënshkruar ende deri në datë 31 Dhjetor 2022, pasi janë procedura të zhvilluara për vitin në vijim.

Në tabelat e mëposhtme pasqyrohen të dhënat për numrin e kontratave dhe marrëveshjeve kuadër të nënshkruara në vitin 2022, fondin limit përkatës, vlerat e kontraktuara dhe kursimi në vlerë absolute dhe në përqindje.

Tabela 20

Statistika Total të Kontratave dhe Marrëveshjeve Kuadër të Nënshkruara SPE Janar - Dhjetor 2022	
Nr.Total i Proç. te fituara	3,992
Fondi total limit	111,357,310,340
Fondi total i prokuruar	103,646,865,355
% qe ze Fondi i prokuruar ndaj Fondit limit	93,1%
Fondi total i kursyer	7,710,444,985
% qe ze Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	6,9%
TË DETAJUARA	
Statistika për Marrëveshjet Kuadër të Nënshkruara Janar - Dhjetor 2022	
Nr.Total i Proç.te fituara	1,097
Fondi total limit	41,499,047,418
Fondi total i prokuruar	40,319,679,858
% qe ze Fondi i prokuruar ndaj Fondit limit	97.2%
Fondi total i kursyer	1,179,367,560
% qe ze Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	3%
Statistika vetëm Kontrata Nënshkruara Janar - Dhjetor 2022	
Nr.Total i Proç.te fituara	2,895
Fondi total limit	69,858,262,923
Fondi total i prokuruar	63,327,185,497
% qe ze Fondi i prokuruar ndaj Fondit limit	91%
Fondi total i kursyer	6,531,077,426
% qe ze Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	9%

Në një vështrim të përgjithshëm konstatojmë se Fondi i Kursyer për Marrëveshjet Kuadër në vlerën 1,179,367,560 lekë ose 3% ndaj fondit limit të Marrëveshjeve Kuadër, është më i ulët se Fondi i Kursyer për kontratat e nënshkruara që janë në vlerën 6,531,077,426 lekë ose 9% ndaj fondit limit për këto kontrata.



Nisur nga këto përqindje të kursimit të krijohet ideja se për kontratat e nënshkuara ka kursim 3 herë më të lartë se Marrëveshjet Kuadër (3%).

Në fakt duhet të vemë në dukje se, në Marrëveshjet Kuadër, veçanërisht për ato me kohëzgjatje mbi 1 vit, për efekte statistikore, vlera e prokuruar njehsohet me fondin limit. Kjo ndodh sepse për 1(një) Marrëveshje Kuadër gjatë zbatimit të saj nënshkruhen disa minikontrata dhe vlera e saktë e Marrëveshjes Kuadër përlogaritet në fund të afatit përfundimtar që mund të jetë nga 1(një) në 4(katër) vjet.

Nga ana tjetër, në lidhje me kursimin, përdorimi i Marrëveshjeve Kuadër ka avantazh, sepse duke përdorur minikontratat, Autoritetet Kontraktore shmangin stoqet dhe skadimin e produkteve, si në rastin e medikamenteve, përcaktohen me saktësi materialet që përdoren në riparime e mirëmbajtje si edhe garantojnë cilësi të lartë në furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, si dhe ul përdorimin e procedurave me negociim pa shpallje.


2.5.3. Statistika mbi numrin e njoftimeve të kontratave dhe MK të nënshkuara gjatë vitit 2022, krahasuar me vitin 2021

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, jepen të dhënat statistikore në lidhje me njoftimet e kontratave të nënshkuara dhe marrëveshjet kuadër për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021.

Tabela 21

Krahasime Njoftime Kontrata të Nënshkuara Viti 2021 me Vitin 2022		
Viti	2021	2022
Numri i Kontratave	4,185	3,992
Vlera totale Fondi limit	200,407,943,449	111,357,310,340
Vlera totale e Prokuruar	189,498,515,769	103,646,865,355

Grafiku 16



Sa më sipër, vlen të theksohet fakti se në vitin 2022 janë nënshkuar 193 kontrata dhe marrëveshje kuadër më pak se në vitin 2021. Gjithashtu, fondi limit dhe vlera e kontratave të nënshkuara dhe marrëveshjet kuadër në vitin 2022 është shumë më i ulët se në vitin 2021, ndërkohë që fondi limit është më i lartë.




Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, paraqitet krahasimi i numrit të njoftimeve të kontratave dhe marrëveshjeve kuadër të nënshkruara, të shpallura në Sistemin e Prokurimit Elektronik, në mënyrë të detajuar, respektivisht për periudhën Janar-Dhjetor, viti 2021 me vitin 2022.

Tabela 22

Krahasime Numri i njoftim i lidhjes së kontratës të shpallura në Sistemin e Prokurimit Elektronik Viti2021 me Vitin 2022		
Viti	2021	2022
Janar	381	213
Shkurt	487	271
Mars	384	278
Prill	499	213
Maj	456	291
Qershor	428	312
Korrik	245	315
Gusht	207	403
Shtator	250	391
Tetor	265	415
Nentor	265	391
Dhjetor	318	499
Totali	4,185	3,992

Grafiku 17



Rezulton se numri më i madh i njoftimeve për lidhjen e kontratës është shpallur në 6 mujorin e dytë të vitit.



2.6. MARRËVESHJET KUADËR

Gjatë vitit 2022, autoritetet kontraktore kanë vijuar të përdorin procedurat e prokurimit për Marrëveshje Kuadër, kryesisht për mallra dhe shërbime te vazhdueshme.

Konkretisht, të dhënat në lidhje me përdorimin e këtij instrumenti, paraqiten si më poshtë:

Tabela 23

Shpalljet e procedurave për Marrëveshje Kuadër te vazhduara Janar-Dhjetor 2022		
Lloji i procedurës	Numër i procedurave	Fondi total Limit (lekë pa TVSH)
Procedurë e hapur	285	12,640,765,402
E hapur për Shërbimet Sociale dhe shërbimet e tjera specifike	0	-
E hapur mbi kufirin e lartë monetar	121	31,627,549,239
E Hapur e Thjeshtuar	439	1,822,784,162
Shërbim Konsulence e Konkurs Projektimi	9	1,204,434,662
E kufizuar	4	60,622,079
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	5	7,234,348,405
E kufizuar per Rindërtimin	125	15,003,902,475
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	4	1,436,079,745
TOTAL	992	71,030,486,169

Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me shpalljet e Marrëveshjeve Kuadër që kanë vazhduar në sistem për vitin 2022.

Tabela 24

Procedura për Marrëveshje Kuadër që kanë vazhduar Janar - Dhjetor 2022	Numri i procedurave (jo Lote)	Fondi limit total
Shërbime	289	8,628,943,426
Mallra	397	26,858,656,323
Punë Civile	77	21,163,891,868
TOTAL	763	56,651,491,617



Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me publikime Marrëveshje Kuadër për vitin 2022, krahasuar me publikime Marrëveshje kuadër të vitit 2021.

Tabela 25


Krahasime Publikime Marrëveshje Kuadër të vazhduara Janar - Dhjetor		
Viti	2021	2022
Numri i Procedurave	702	763
Vlera totale Fondi limit	34,956,916,575	56,651,491,617

Nga tabela e mësipërme, rezulton se kemi një rritje të numrit të Marrëveshjeve Kuadër në vitin 2022 krahasuar me 2021 me 61 MK më shumë.

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat krahasuese të vitit 2022, me të dhënat e vitit 2021, respektivisht në numër dhe në vlerë.

Grafiku 18

PUBLIKIME MARRËVESHJE KUADËR JANAR - DHJETOR 2022



Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me shpalljet e Marrëveshjeve Kuadër të finalizuara me njoftim fituesi në sistem për vitin 2022.

Diferenca midis numrit të procedurave të shpallura me ato të përfunduara me njoftim fituesi në sistem, shpjegohet me argumentin se shumë procedura të publikuara në vitin 2022, kanë vazhduar me shpalljen e fituesit apo me lidhjen e Marrëveshjeve Kuadër në vitin pasardhës.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me Marrëveshje Kuadër të përfunduara me njoftim fituesi në sistem për vitin 2022, krahasuar me Marrëveshje Kuadër të përfunduara me njoftim fituesi në sistem për vitit 2021.




Tabela 26

Procedura prokurimi Marrëveshje Kuadër krahasuese të përfunduara me fituesJanar - Dhjetor		
Viti	2021	2022
Numri i Procedurave	742	740
Vlera totale Fondi limit	44,609,417,069	59,310,160,580
Vlera totale e Prokuruar	43,005,629,444	55,040,750,642

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelat e mësipërme, rezulton se numri total i procedurave Marrëveshje Kuadër të përfunduara me njoftim fituesi në sistemin e prokurimit elektronik është 740 (2 procedura Marrëveshje Kuadër më pak krahasuar me vitin 2021 ku ishin 742 procedura përfshi edhe procedurat për tërmetin).

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat krahasuese të vitit 2022, me të dhënat e vitit 2021, respektivisht në numër dhe vlerë.

Grafiku 19



Përsa i përket minikontratave të nënshkruara në bazë të Marrëveshjeve kuadër, të aplikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik gjatë vitit 2022 rezultojnë të dhënat e mëposhtme:

Tabela 27

MINI Kontrata te referuara nga publikimet në SPE			
Viti 2021		Viti 2022	
Numri i Mini Kontratave	Vlera e Kontratave	Numri i Mini Kontratave	Vlera e Kontratave
2789	8,621,006,413	4038	85,526,757,960

Duhet mbajtur në vëmendje që numri i minikontratave të nënshkruara gjatë vitit 2022, janë rezultat i Marrëveshjeve Kuadër që janë prokuruar gjatë viteve të mëparshme.



2.7. Të dhëna mbi procedurat e prokurimit të kryera gjatë vitit 2022 në kuadër të procesit të rindërtimit

Në mbështetje të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, edhe gjatë vitit 2022 autoritetet kontraktore përgjegjëse (njësitë zbatuese), kanë zhvilluar procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e fituesve të marrëveshjes kuadër për procesin e rindërtimit në sistemin e prokurimit publik.

Nga të dhënat e analizuar nga sistemi i prokurimit elektronik dhe nga Buletinet e Posaçme, rezultojnë se:

Numri total i njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të shpallura gjatë vitit 2022 në sistemin e prokurimit elektronik, në kuadër të procesit të rindërtimit për shkak të Tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, sipas tipit të kontratës, shërbim, mallra, punë është 313 procedura me fond limit 107,759,835,777 lekë pa TVSH.

Gjatë vitit 2022 rezultojnë 137 njoftime të kontratave të shpallura, me fond limit 14,332,098,683 lekë pa TVSH.

Konkretisht, numri i procedurave që kanë lidhur kontratë në 2022 sipas tipit të kontratave paraqitet si më poshtë:

Tabela 28

Njoftime Procedurash të vazhduara Rindërtim Viti 2022					
Shërbime		Mallra		Punë publike	
Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve procedura	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve procedura	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve procedura
E kufizuar	88	E kufizuar	-	E kufizuar	40
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	0	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	2	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	7
TOTALI	88	TOTALI	2	TOTALI	47

Në tabelën e mëposhtme paraqitet fondi limit total për procedurat që kanë vazhduar sipas tipit të kontratave:

Tabela 29

Fondi limit për Procedurat e vazhduara Rindërtim Viti 2022					
Fondi limit total			Tipi i kontratës		
Lloji i procedurës	Nr procedura / lote	Fondi limit total	Shërbime	Mallra	Punë publike
E kufizuar	128	11,708,719,282	618,104,582	-	11,090,614,700
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	9	2,623,379,401	-	114,984,602	2,508,394,799
TOTALI	137	14,332,098,683	618,104,582	114,984,602	13,599,009,499



Njoftimet e kontratave për procedurat e prokurimit në kuadër të procesit të rindërtimit janë publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, por gjithashtu, janë publikuar edhe në Buletinet e Posaçme të publikuarapër vitin 2022.

Nga të dhënat e mësipërme, vërehet se numri më i madh i procedurave për rindërtimin është për shërbime gjë që mund të shpjegohet me faktin e lidhjes së kontratave të mbikqyrjes dhe kolaudimit për punët e kryera gjatë 2021 dhe 2022.

2.8. Statistika mbi kriteret e parashikuara nga ligji për vlerësimin e ofertës fituese për procedurat të finalizuara me njoftim fituesit gjatë 2022

Miratimi i legjislacionit të ri të prokurimit solli një ndryshim të rëndësishëm sa i takon kriterit të vlerësimit, duke përcaktuar si kriter bazë ofertën ekonomikisht më të favorshme, e cila mund të identifikohet në bazë të çmimit (çmimi më i ulët) ose në bazë të kostos (bazuar në raportin çmim-cilësi).

APP ka analizuar përdorimin e kriterit të mësipërm për vlerësimin e ofertës fituese gjatë vitit 2022 të dhënat e kësaj analize pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 30

Statistika Procedura fituar me oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto Viti 2022							
Nr.	Emërtimi	Nr. Procedura/Lote	Fondi limit Leke paTVSH	Fondi Prokuruar Leke pa TVSH	% Numrit të procedurave përkatëse ndaj totalit	% Fondit Limit përkatës ndaj totalit	% e vlerës përkatëse të fituar ndaj totalit
1	Procedura te fituara me oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto	328	45,015,131,386	41,755,352,546	7,28%	33,49%	33.92%
2	Procedura te fituara me oferta ekonomikisht mëe favorshme bazuar në çmimin më të ulët	4,179	89,383,643,104	81,353,146,688	92,72%	66,51%	66.08%
TOTALI		4,507	134,398,774,490	123,108,499,233	100%	100%	100%



Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme, sa i takon numrit të procedurave të fituara për të cilat është përdorur oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto, kemi një rritje krahasuar me vitin 2021 nga 5.9% në 7,28% të numrit total të procedurave të fituara.

Nga ana tjetër, në vlerë, në raport me fondin total të prokuruar këto procedura përbëjnë 33.92% të procedurave të fituara.

Tabela 31

Lloji i procedurave me oferta ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto për vitin 2022	
Lloji i procedurës	Numri i procedurave
Sherbim konsulence	68
E hapur për Shërbimet Sociale dhe shërbimet e tjera specifike	1
E hapur mbi kufirin e lartë monetar	19
E hapur	46
E hapur e thjeshtuar	7
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar”	18
E kufizuar	169

Sikurse vërehet në tabelën e mësipërme numrin më të lartë të procedurave në të cilat si metodë vlerësimi është zgjedhur “Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto” e përbëjnë procedurat “E kufizuar” dhe “Shërbim konsulence”.

Megjithatë, vlen të theksohet se, për herë të parë gjatë vitit 2022 vihet re përdorimi i kësaj metode vlerësimi në procedurat e hapura.

2.9. Statistika mbi përqindjen e kursyer nga procedurat e kryera në sistemin elektronik

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik të zhvilluar në sistemin elektronik (pa përfshirë negociimet pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës) gjatë vitit 2022, fondin limit përkatës, numrin e procedurave të anuluar, numrin e procedurave të vazhduara, numrin e procedurave të fituara me fondin limit dhe fondin e ofruar përkatës, si dhe kursimin në përqindje.

Tabela 32

Procedura prokurimi të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik në periudhën VITI 2022	
Numri Total i procedurave të publikuara	6,494
Fondi total limiti procedurave të publikuara (vlera në lekë)	170,200,854,721
Numri Total i procedurave të cilat kanë vazhduar	4,674
Fondi total limit i procedurave të cilat kanë vazhduar (vlera në lekë)	146,888,009,228
Numri Total i Procedurave të fituara	4,507
Fondi total limit i procedurave të fituara (vlera në lekë)	134,398,774,490
Vlera totale e fituar (vlera në lekë)	123,108,499,233
% që zë Vlera totale e fituar ndaj Fondit total limit të procedurave të fituara	91,6%
Fondi total i kursyer (vlera në lekë)	11,290,275,257
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit total limit të procedurave të fituara	8,4%



Sqarojmë se numri i procedurave të fituara në vitin 2022 është më i lartë se numri i procedurave të fituara në 2021 dhe gjithashtu ka një rritje të përqindjes së kursyer në krahasim me 2021 ku kursimi ka qenë 5.5%.

2.10. Statistika mbi numrin e anulimeve të procedurave të prokurimit mbi kufirin monetar për procedurën me vlerë të vogël gjatë 2022


Nga analizimi i të dhënave rezulton se, sipas përcaktimeve të kryera në sistemin e prokurimit elektronik, nga vete autoritetet kontraktore në lidhje me anulimet për procedurat e shpallura konkurrese pas publikimit sipas arsyeve ligjore të përcaktuara në legjislacion.

Nga 1877 procedura të anuluar: 62 janë procedura me negociim pa shpallje paraprake dhe 965 janë lote të anuluar. Gjithsesi, sikur analizuar dhe me sipër, pavarësisht numrit të procedurave të anuluar, vlera e fondit limit të këtyre procedurave zë vetëm 14% të fondit total të procedurave të shpallura.

Nga analizimi i të dhënave të marra në SPE, arsyet ligjore me të cilat janë anuluar procedurat konkurrese të prokurimit (përveç procedurave me negociim pa shpallje) janë si më poshtë:

Tabela 33

Arsyeja e Anullimit të deklaruar në sistem	Numri i procedurave dhe loteve të anuluar
Nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza	81
Nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë	1373
Për shkak se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme	120
Për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar	176
Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP	53
Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021	12
Totali	1815



APP do të vijojë punën për të vlerësuar nevojën e ndryshimeve të mundshme me qëllim uljen e mëtejshme të numrit të anulimeve, megjithatë vlen të theksohet që gati gjysma e procedurave të anuluar janë lote dhe numrin më të lartë të procedurave me lote e zënë ilaçet (medikamentet) që prokurohen të ndara, një ilaç (medikament)-një lot.

2.11. TË DHËNA MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT ME NEGOCIM PA SHPALLJE PARAPRAKË TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS

Procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sikurse parashikuar në nenin 47 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” mund të përdoret nga Autoritetet Kontraktore për plotësimin e nevojave të tyre vetëm në raste përjashtimore, në rrethana të veçanta dhe vetëm nëse plotësohen kushtet e parashikuara në këtë nen.

Kjo procedurë prokurimi zhvillohet me mjete elektronike në përputhje me nenin 17 të ligjit 162/2020 dhe VKM Nr. 384, datë 30.06.2021 “Për formën e komunikimit në procedurat e prokurimit publik”.

Në këtë seksion analizohet në mënyrë të detajuar përdorimi i kësaj lloji procedure në vitin 2022 në raport me procedurat e tjera si edhe në raport me vitet e tjera.


Konkretisht, sikurse rezulton nga të dhënat e SPE, numri total i procedurave të prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, të zhvilluara gjatë vitit 2022 është **157** ose 3,3%, i numrit total (procedura të tjera + negociim pa shpallje) të procedurave të përfunduara me fitues nga 143 të tilla të realizuara në vitin 2021.



Në grafikun e mëposhtëm jepen të dhënat krahasimore të numrit të procedurave të fituara me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës (**157 procedura**) ndaj numrit total të procedurave të prokurimit të përfunduara me fitues (**4664 procedura**) (procedura të tjera+negocim pa shpallje).

Grafiku 21


% e nr. të procedurave me negociim pa shpallje Janar-Dhjetor 2022



Ndërkohë sa i përket vlerës së prokuruar me procedurën me negociim pa shpallje, kjo vlerë është 0.9% në raport me vlerën e prokuruar (procedura të tjera+negocim pa shpallje).

Grafiku 22

% e fondit që zenë procedurat me negociim ndaj fondit total të procedurave totale, viti 2022





Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021.

Tabela 34

Krahase Procedurat e prokurimit negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës Viti 2021 me Vitin 2022		
Viti	2021	2022
Numri i Procedurave	143	157
Vlera totale Fondi limit	6,512,211,253	1,273,811,249
Vlera totale e Prokuruar	6,463,162,957	1,261,433,790

Sikurse vërehet nga tabela, megjithëse numri i procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ka pësuar një rritje me 14 procedura më shumë gjatë vitit 2022, vlera e këtyre procedurave është ndjeshëm më e ulët se në vitin 2021, (rreth 5 herë më pak se vlera e prokuruar në 2021 me këtë lloj procedure).

Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës të detajuar sipas tipit të kontratës, për vitin 2022.

Tabela 35

Procedura e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës Janar – Dhjetor 2022		
Tipi i kontratës:	Nr.	Fondi Prokuruar
Shërbime	72	506,531,952
Mallra	73	456,231,066
Punë	12	298,670,772
TOTALI	157	1,261,433,790

Të dhënat në lidhje me numrin e kontratave të nënshkruara sipas procedurave me negociim pa shpallje paraprake të realizuara sipas muajve për vitin 2022, paraqiten si më poshtë:




Tabela 36

Njoftime kontratash të nënshkuara për procedurat me negociim pa shpallje paraprake VITI 2022			
Muaji	Numri i procedurave	Fondi limit (vlera në lekë pa TVSH)	Vlera e kontratës (në lekë pa TVSH)
Janar	3	11,883,075	11,829,017
Shkurt	60	202,994,009	200,524,370
Mars	11	66,210,609	64,454,700
Prill	3	52,203,239	51,996,828
Maj	7	78,392,831	77,989,800
Qershor	7	44,253,227	43,732,161
Korrik	15	72,819,983	71,086,826
Gusht	4	52,154,766	52,068,418
Shtator	18	122,433,069	119,343,810
Tetor	9	316,311,380	315,361,640
Nëntor	12	218,992,158	218,196,890
Dhjetor	8	35,162,901	34,849,330
TOTAL VITI 2022	157	1,273,811,249	1,261,433,790


Nga analizimi në kontekstin historik të të dhënave mbi numrin e procedurave me negociim pa shpallje para- prake të njoftimit, rezulton se ky numër për 4 vitet e fundit (2018-2022) është ulur në mënyrë drastike krahasuar me periudhën paraardhëse që nga viti 2010.

Grafiku 23

Numri i procedurave Fituara me Negocime pa shpallje si dhe numri i procedurave të Shpallura 2010-2022



Grafiku 24



Siç vihet re edhe nga grafiku i mësipërm, % në vlerë e procedurave të negocimeve pa shpallje në raport me fondin limit të procedurave ka shënuar vlera në rënie vit pas viti. Gjatë vitit 2022 vlera totale e negocimeve pa shpallje ka zënë vetëm 0.9% të fondit total të procedurave fituese.

Vlen të theksohet se, minimizimi i rasteve të përdorimit të procedurës me negocim pa shpallje para-prake të njoftimit të kontratës gjatë 4 viteve të fundit, është rezultat i ndërgjegjësimit të autoriteteve kontraktore.

Ky ndryshim pozitiv ka ardhur edhe si rezultat i automatizimit të procesit, duke e zhvilluar procedurën në SPE, duke filluar që nga krijimi i regjistrit, njoftimi i Operatorëve Ekonomikë, ofertimi, vlerësimi, dërgimi i mesazheve për kualifikimin, shpalljen e fituesit dhe publikimin online të njoftimit të lidhjes së kontratës.

Zhvillimi i kësaj procedure prokurimi në sistemin e prokurimit elektronik, që nga pasqyrimi në zërin përkatës të regjistrit të parashikimeve, ku autoritet kontraktore duhet të përshkruajnë edhe arsyet që detyrojnë për- zgjedhjen e kësaj procedure sipas kushteve ligjore, ka rritur përgjegjësinë e këtyre të fundit në këtë drejtim.

Gjithashtu, ndikim kanë patur edhe rekomandimet dhe njoftimet e vazhdueshme nga Agjencia e Prokurimit Publik që të merren masat për publikimin e procedurave konkurruese në kohë, mundësisht Marrëveshje Kuadër për shërbime/mallra të vazhdueshme, pikërisht që autoritet kontraktore të mos gjenden pa shër- bim/mall në fillim vitit.

2.12. PROCEDURAT E PROKURIMIT ME VLERË TË VOGËL

Sipas parashikimeve në legjislacionin e prokurimit, Autoritetet Kontraktore përdorin procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për të blerë mallra, shërbime dhe punë, vlera e përlogaritur e të cilave gjatë gjithë vitit kalendarik është nga 100.000 lekë deri në 1.000.000 lekë pa t.v.sh.

Nga analizimi i të dhënave, rezulton se numri i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara gjatë vitit 2022 dhe fondet përkatëse, paraqiten si më poshtë:



Tabela 37

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël Janar-Dhjetor 2022	
Numri Total i procedurave të Prokurimit me Vlerë të Vogël të publikuara per vitin 2022	16581
Fondi total limit i shpallur për procedurat e prokurimit me Vlerë të Vogël (vlera në lekë)	6,379,275,975
Numri Total i procedurave të Prokurimit me Vlerë të Vogël të përfunduara me njoftim fituesi	12,400
Fondi total Limit për procedurat e prokurimit me Vlerë të Vogël të përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)	4,925,155,213
Vlera totale e fituar në procedurat e prokurimit me Vlerë të Vogël të përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)	4,272,218,663
% që zë vlera totale e fituar ndaj Fondit total limit të procedurave të përfunduara me fitues	87%
Fondi total i kursyer (vlera në lekë)	652,936,550
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit total limit të procedurave të përfunduara me fitues	13%

Numri dhe vlerat e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara gjatë vitit 2022 dhe krahasime ato të vitit 2021, paraqiten në tabelën më poshtë.

Tabela 38

Procedura Prokurime me Vlerë të Vogël perfunduara me Fitues Krahasime Viti 2022 me Vitin 2021		
Viti	2021	2022
Numri i Procedurave prokurim me vlerë tëvogël	12,249	12,400
Vlera totale Fondi limit	4,348,492,512	4,925,155,213
Vlera e Prokuruar	3,750,454,014	4,272,218,663
Vlera e kursyer	598,038,498	652,936,550

Po të krahasojmë numrin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të përfunduara me fitues në vitin 2022 (12,400), me numrin respektiv në vitin 2021 (12,249), rezulton se gjatë vitit 2022 në numër janë përfunduar më shumë procedura me fitues.

Një tregues tjetër shumë i rëndësishëm që rezulton nga të dhënat në tabela, është diferenca midis fondit me të cilin janë shpallur procedurat, me vlerën me të cilin janë fituar ato dhe konkretisht kursimi është 13%. Gjithashtu, kursimi në vlerë absolute 652,936,550 lekë i realizuar në vitin 2022, është më i lartë se kursimi prej 598,038,498 lekë i realizuar në vitin 2021.

Këto të dhëna tregojnë se nga përmirësimet e herëpas herëshme që i bëhen kësaj procedure në SPE, sigurohet konkurrueshmëri e lartë dhe e drejtë, duke sjellë në vëmendje se kjo është e vetmja procedurë ku nuk shfaqet fondi limit, me qëllimin për të synuar ofertën sa më të përgjegjshme nga operatorët ekonomikë.



2.13. Statistika në lidhje me procedurat e krijuara në sistemin elektronik

Numri total i procedurave të prokurimit të vijua me fitues, duke përfshirë edhe prokurimet me vlerë të vogël në Sistemin e Prokurimit Elektronik për vitin 2022, është 16,907, të detajuara sipas tabelës së mëposhtme:


Tabela 39

Lloji i procedurës	Numri Total i Procedurave/ lote të elektroniketë përfunduara me fitues	Vlera totale e fituar në procedurat e prokurimit të përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)
Procedura Prokurimi konkurruese mbi kufirin monetar për procedurat me vlerë të vogël	4,507	123,108,499,233
Prokurimit me Vlerë të Vogël	12,400	4,272,218,663
Totali	16,907	127,380,717,896

Në diagramën e mëposhtme tregohet raporti i numrit të prokurimeve me vlerë të vogël, ndaj procedurave të prokurimit mbi kufirin monetar për procedurat me vlerë të vogël ku, sikurse del edhe nga treguesit e analizuar më sipër, del qartë numri që zënë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël ndaj procedurave të tjera.

Grafiku 25

Raporti ne % i numrit te procedurave te vazhduara me vlere te vogel dhe prokurimeve mbi kufirin monetar ndaj totalit




- Procedura Prokurimi konkurruese mbi kufirin monetar për procedurat me vlerë të vogël
- Prokurimit me Vlerë të Vogël

Ndërkohë Raporti në vlerë rezulton në të kundërt, ku fondi i procedurave me vlerë të vogël zë vetëm 3.3% të të gjithës fondit të prokuruar



Grafiku 26

Raporti në % e vlerës së fondit të prokuruar për prokurimet me vlerë të vogël dhe atyre mbi kufirin e lartë monetar ndaj totalit



2.14. Sistemi dinamik blerje bileta transporti ajror ndërkombëtar

Autoritetet kontraktore përdorin Sistemin e thjeshtuar Dinamik të Blerjeve, si një mënyrë për të siguruar blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar. Ky sistem është i hapur për të gjithë operatorët ekonomikë, që janë të regjistruar në sistemin e prokurimit elektronik dhe që kanë si objekt të ushtrimit të aktivi-tetit të tyre, shërbimin e transportit ajror ndërkombëtar.

Sikurse është parashikuar në udhëzimin përkatës të APP, autoritetet kontraktore kanë zbatuar procedurën, duke marrë në konsideratë për realizimin e shërbimit të gjithë operatorët ekonomikë të kualifikuar.

Nga analizimi i të dhënave, numri i procedurave të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar të zhvilluara gjatë vitit 2022 dhe fondet përkatëse, krahasuar me 2021 paraqitet si më poshtë:

Tabela 40


Krahasime Sistemi dinamik blerje bileta të transportit ajror ndërkombëtar		
Viti	2021	2022
Numri Total i procedurave blerje e biletave të transportit ajror ndërkombëtar	861	2,254
Numri Total i Procedurave të papërfunduara (anulluar, etj)	124	290
Numri Total i procedurave blerje e biletave të cilat kanë përfunduar me fitues	735	1,959
Vlera totale e fituar në procedurat blerje e biletave të përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)	124,328,925	302,460,125



Siç vihet re, numri i procedurave blerje e biletave të transportit ajror ndërkombëtar të shpallur për vitin 2022, është më i madh krahasuar me vitin 2021, konkretisht kemi 1,393 procedura më shumë (për vitin 2021 janë shpallur 816 procedura).

Kjo rritje e numrit të këtyre procedurave lidhet me hapjen e negociatave për anëtarësim në BE dhe zhvillimin e takimeve shpjeguese dhe takimeve dypalëshe në Bruksel në muajt Shtator-Dhjetor 2022, të cilët janë edhe muajt me numër më të lartë procedurash sikurse tregohet nga të dhënat e mëposhtme.

Grafiku 27




Nr i procedurave dhe vlerat e fondit limit dhe të prokuruar për sistemin dinamik të blerjes së biletave, respektivisht sipas muajve për vitin 2022 jepet si më poshtë:

Tabela 41


Muaji	Nr. Procedurave	Fondi limit	Vlera e Prokuruar
Janar	22	2,870,774	2,725,225
Shkurt	57	6,400,135	6,360,705
Mars	126	15,850,581	15,494,681
Prill	159	19,627,845	19,435,692
Maj	223	31,134,147	31,314,412
Qershor	194	40,932,102	38,750,233
Korrik	94	19,200,662	18,451,227
Gusht	98	13,056,547	12,723,310
Shtator	272	43,955,469	43,444,049
Tetor	276	46,918,321	45,002,184
Nentor	305	45,131,046	44,378,229
Dhjetor	133	24,814,166	24,380,177
Totali	1,959	309,891,795	302,460,125



Grafiku 28



Grafiku 29



Sikurse tregohet nga grafikët e mësipërm, në raportin në vlerë % më të madhe e zenë procedurat me vlerë mbi kufirin monetar për blerje të vogël (96%), ndërkohë që në raportin në numër procedurash % më të madhe e zenë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël (65%).



2.15. Statistika në lidhje me Autoritet Kontraktore që kanë krijuar procedura me vlerë të vogël dhe mbi kufirin monetar për procedura me vlerë të vogël

Numri total i autoriteteve dhe enteve kontraktore aktive që kanë krijuar procedura prokurimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik gjatë vitit 2022 është 1303, nga të cilët **892** prej tyre kanë krijuar vetëm procedura prokurimi me vlerë të vogël. Numri i autoriteteve kontraktore që kanë krijuar procedura prokurimi me vlerë mbi kufirin monetar për prokurime me vlerë të vogël është **411**.

Tabela 42

Lloji i procedurës së prokurimit të shpallur në SPE	Numri i Autoriteteve Kontraktore
Autoritete Kontraktore që krijojnë vetëm procedura prokurimi me vlerë të vogël	892
Autoritete Kontraktore që krijojnë procedura prokurimi me vlerë mbi kufirin monetar për procedura me vlerë të vogël	411
Totali	1,303

Më poshtë paraqiten 10 autoritetet kontraktore që kanë shpallur më shumë procedura/lotë me vlerë mbi kufirin monetar për procedurat me vlerë të vogël, gjatë vitit 2022:

Tabela 43

Nr.	Autoriteti kontraktor	Numri i procedurave/ lotëve me fond mbi kufirin monetar për procedura me vlerë të vogël	Numri i Procedurave/ Lotëve të anuluar	Numri i Procedurave/ Lotëve të vijuar
1	Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë	392	257	135
2	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	296	54	242
3	Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë	241	151	90
4	Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara	203	62	141
5	Bashkia Tiranë	176	15	161
6	Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës	161	135	26
7	Bashkia Krujë	114	25	89
8	Bashkia Durrës	96	15	81
9	Bashkia Kamëz	87	4	83
10	Bashkia Elbasan	86	21	65

Sikurse vërehet nga të dhënat, Autoritetet Kontraktore që kanë më shumë anulime, janë ato që kanë fushë përgjegjësie shëndetësinë, dhe prokurojnë blerjen e medikamenteve, duke i ndarë në lotë.



Më poshtë paraqiten 10 autoritetet që kanë shpallur më shumë procedura prokurimi me vlerë të vogël gjatë vitit 2022:

Tabela 44

Nr.	Autoriteti kontraktor	Numri i Procedurave të publikuar në sistem	Numri i Procedurave/Loteve të anuluar	Numri i Procedurave/ Loteve të vijura
1	Bashkia Korçë	126	29	97
2	Bashkia Maliq	125	41	84
3	Bashkia Pukë	127	42	85
4	Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kolonjë	112	69	43
5	Bashkia Shkodër	105	23	82
6	Drejtoria Vendore e Policisë Durrës	101	37	64
7	Komanda Mbështetëse, Reparti Ushtarak Nr. 4001	99	15	84
8	SHISH Shërbimi Informativ i Shtetit	99	48	51
9	Bashkia Patos	95	23	72
10	Bashkia Vlore	86	7	79

2.16. Statistika mbi ofertat e dorëzuara gjatë 2022

Në tabelën e mëposhtme tregohet numrit i ofertave të dorëzuara në procedurat e prokurimit me vlerë mbi 1.000.000 lekë, nga operatorët ekonomikë sipas llojit të procedurës:



Tabela 45

Lloji i Procedurës	Tipi i Kontratës	Numri i procedurave	Numri Total i ofertave të dorëzuara	Mesatarja e Ofertave
Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	Shërbime	98	546	5.6
E hapur ndërkombëtare	Shërbime	248	614	2.5
E hapur ndërkombëtare	Punë	39	235	6
E hapur ndërkombëtare	Mallra	556	1121	2
E hapur lokale	Shërbime	286	638	2.2
E hapur lokale	Mallra	854	1217	1.4
E hapur lokale	Punë	502	3003	6
E hapur e thjeshtuar	Shërbime	899	2605	2.9
E hapur e thjeshtuar	Mallra	2289	3731	1.69
E hapur e thjeshtuar	Punë	541	1306	2.49
E Kufizuar Ndërkombëtare	Shërbime	18	87	4.89
E Kufizuar Ndërkombëtare	Punë	1	11	11
E Kufizuar Ndërkombëtare	Mallra	5	10	2
e Kufizuar lokale	Shërbime	82	554	6.8
E Kufizuar lokale	Mallra	2	6	3
E Kufizuar lokale	Punë	73	453	6.2
E hapur shërbimet sociale	Shërbime	1	1	1
Totali		6494	16138	2.5

Në tabelën e mëposhtme, paraqitet mesatarja e dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë në procedurat e prokurimit me vlerë mbi 1.000.000 lekë sipas tipit të kontratës:

Tabela 46

Tipi i Kontratës	Numri i procedurave	Numri total i ofertave të dorëzuara	Numri mesatar i ofertave
Mallra	3706	6085	1.6
Punë	1156	5008	4.3
Shërbime	1632	5045	3.1
Totali	6494	16138	2.5



Tabela 47

Tipi i Kontratës	Numri i procedurave	Vlera e fondit limit	% që zë ndaj fondit total
Mallra	3706	28,031,284,141.85	18.5%
Punë	1156	85,371,415,907.01	56.2%
Shërbime	1632	38,403,619,951.77	25.3%
Totali	6494	151,806,320,000.63	

Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, mesatarja më e lartë e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë është në tipet e kontratave “Punë” dhe “Shërbime”, qe përbëjnë dhe 81.5% të fondeve.

Përsa i përket procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, në tabelën e mëposhtme tregohet mesatarja e dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë, sipas tipit të kontratës:

Tabela 47

Lloji i Procedurës	Tipi i Kontratës	Numri i procedurave	Numri total i ofertave të dorëzuara	Numri mesatar i ofertave
Prokurim me vlerë të vogël	Mallra	10738	148700	13.8
Prokurim me vlerë të vogël	Shërbime	5432	38734	7.1
Prokurim me vlerë të vogël	Punë	412	3891	9.4
Totali		16582	191325	11.5

Përsa i përket Sistem Dinamik, Blerje biletash te transportit ajor, në tabelën e mëposhtme tregohet mesatarja e dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë:

Tabela 48

Lloji i Procedurës	Tipi i Kontratës	Numri i procedurave	Numri total i ofertave të dorëzuara	Numri mesatar i ofertave
Sistem Dinamik, Blerje biletash te transportit ajor	Shërbime	2111	7354	3.5
Sistem Dinamik, Blerje biletash te transportit ajor	Mallra	142	516	3.6
Totali		2253	7870	3.5



2.16.1. Statistika mbi procedurat e prokurimit me një ofertë të dorëzuar të përfunduara me fitues gjatë 2022

Nga të dhënat e nxjerra nga sistemi i prokurimit elektronik, rezulton se numri i procedurave të prokurimit mbi 1 000 000 lekë, me një ofertë të dorëzuar dhe të finalizuar me njoftim fituesi është 1645. Në tabelen e mëposhtme tregohet i detajuar numri i procedurave me 1 ofertë të dorëzuar dhe të finalizuar me njoftim fituesi, sipas llojit të procedurës së prokurimit.

Tabela 49

Lloji i procedurës së prokurimit	Numri i procedurave	Numri i procedurave me 1 ofertë të dorëzuar të finalizuar me njoftim fituesi/lidhje kontrate
Shërbim Konsulence	98	0
E hapur, ndërkombetare	843	293
E hapur për Shërbimet sociale dhe të tjera, nën kufirin monetar	1	1
E hapur	1642	320
E hapur e thjeshtuar	3729	1031
E Kufizuar	157	0
E Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar	24	0
Totali	6494	1645

Nga tabela e mësipërme rezulton se përqindja e procedurave të realizuara me 1 ofertë për vitin 2022 ka qenë në nivelin 25%.

2.17. STATISTIKA NË LIDHJE ME PJESËMARRJEN E SME-VE NË PROCEDURAT E PROKURIMIT

Gjatë vitit 2022 APP ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për të kryqëzuar të dhënat që kanë respektivisht të dy institucionet me qëllim përlllogaritjen e procedurave të prokurimit të fituara nga Operatorë Ekonomikë Ndërmarrje të Mesme dhe të Vogla (SME).

Pjesëmarrja e SME-ve në procedurat e prokurimit dhe shpallja fitues e tyre në këto lloj procedurash është një tregues shumë i rëndësishëm për promovimin e konkurrencës në prokurimin publik.

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm paraqesin numrin e procedurave të prokurimit të fituara nga SME-të qoftë si pjesëmarrës të vetëm, në bashkime operatorësh me SME të tjera apo në bashkime operatorësh me biznese të mëdha apo operatorë të huaj në raport me numrin total të procedurave të shpallura me fitues.


Tabela 50

Procedurat e fituara nga SME ndaj totalit të procedurave të fituara		
OE SME /BOE SME	2269	50.3%
BOE SME/Të tjerë	224	5.0%
Të tjerë	2014	44.7%
Total procedura të fituara	4507	100.0%



Grafiku 30

% e procedurave të fituara nga SME ndaj totalit te procedurave te fituara



Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme, procedurat e prokurimit të fituara nga SME (ofertues të vetëm apo bashkim operatorësh SME) përbëjnë 50.3% të totalit të procedurave të fituara.

Ndërkohë, SME-të janë operatorë fitues edhe në 5% të procedurave të fituara nëpërmjet bashkimit me operatorë të tjerë (biznes i madh apo të huaj) duke e çuar në total 55.3% numrin e procedurave të fituara nga këta lloj operatorësh.

2.18. STATISTIKA PËR PROKURIMET NË FUSHËN E MBROJTJES DHE SIGURISË GJATË VITIT 2022

Në vijim të hyrjes në fuqi të ligjit 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë” dhe miratimit të legjislacionit dytësor, gjatë vitit 2022 janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike njoftime kontratash për këto lloj procedurash.

Sikurse rezulton nga tabela e mëposhtme, në vitin 2022, janë publikuar 23 procedura në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, prej të cilave 5 procedura janë anuluar, 17 procedura kanë përfunduar me fitues dhe janë 18 kontrata të nënshkruara.

Numri i procedurave të vazhduara në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë të publikuara në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe njoftimet e fituesit për vitin 2022, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 51

Procedura në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë	Numri i procedurave
Njoftim Kontrate/ Ftesë për oferta	23
Procedura të anuluar	5
Njoftime Fituesish	17
Kontrata të nënshkruara	18



2.19. STATISTIKA NË LIDHJE ME NUMRIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES ME KONCESION/ PPP GJATË VITIT 2022

Gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2022, janë publikuar në SPE 3(tre) procedura koncesionare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, prej të cilave asnjë procedurë koncesionare nuk është anuluar, dhe 1(një) procedurë koncesionare është finalizuar me fitues (procedurë e cila filloi dhe u finalizua në vitin 2022).

Numri i procedurave për dhënie me koncesion/PPP, të shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik dhe njoftimet e fituesit gjatë vitit 2022, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 52

Procedura për dhënie me koncesion /PPP	Numri i procedurave	Vlera e Investimit
Njoftime Kontratash	3	
Njoftime Fituesish	1	320,000,000 Euro

2.20. STATISTIKA NË LIDHJE ME PROCEDURAT E ANKANDIT PUBLIK TË ZHVILLUARA GJATË VITIT 2022

Gjatë vitit 2022 janë publikuar 358 njoftime ankandesh nga të cilat 120 janë të anuluar.

Tabela 53

Muajt	Publikime ankande 2022	Anullime ankande 2022
Janar	24	6
Shkurt	29	9
Mars	47	8
Prill	28	21
Maj	33	7
Qershor	21	9
Korrik	27	8
Gusht	30	9
Shtator	29	9
Tetor	43	13
Nentor	28	12
Dhjetor	19	9
Totali	358	120

Gjatë vitit 2022 janë shpallur me njoftim fitues në Buletinin e Njoftimeve Publike 136 procedura të ankandit publik, procedura këto, të cilat zhvillohen vetëm në rrugë shkresore.



Konkretisht, të dhënat në lidhje me këtë procedurë paraqiten si më poshtë:

Tabela 54

Procedura të ankandit publik	Numri	Vlera e ofertuar në lekë
Njoftime Fituesish Ankandi	136	233,031,718
Njoftime Kontratash të Nënshkuara Ankandi	43	104,557,973

Të shpërndarë sipas muajve, njoftimet e fituesit të procedurave të ankandit, paraqiten si më poshtë:

Tabela 55

Njoftime Fituesish për Ankandet Janar- Dhjetor 2022		
Muaji	Numri i Pro-cedurave	Vlera e Ofertuar në lekë
Janar	10	3,562,305
Shkurt	6	8,409,400
Mars	11	7,884,139
Prill	20	36,156,928
Maj	13	5,025,822
Qershor	10	14,075,803
Korrik	7	25,807,267
Gusht	6	9,906,105
Shtator	16	20,971,905
Tetor	11	4,637,185
Nëntor	13	53,024,338
Dhjetor	13	43,570,521
Totali	136	233,031,718

Të shpërndarë sipas muajve, njoftimet e kontratave të nënshkuara të procedurave të ankandit, paraqiten si më poshtë:



Tabela 56

Njoftime Kontratash të Nënshkuara për Ankandet Janar-Dhjetor 2022		
Muaji	Numri i Kontratave	Vlera e Kontraktuar
Janar	3	359,557
Shkurt	3	396,000
Mars	1	25,000
Prill	5	2,158,426
Maj	2	281,200
Qeshor	7	862,250
Korrik	5	10,270,056
Gusht	3	25,662,646
Shtator	3	7,413,309
Tetor	6	53,131,604
Nentor	5	3,997,925
Dhjetor	0	0
Totali	43	104,557,973

Në analizimin e të dhënave të paraqitura në tabelat e mësipërme, duhet mbajtur në konsideratë fakti që në shumë raste ka rezultuar se një subjekt që është shpallur fitues në disa lote të procedurave të ankandëve, ka nënshkruar një kontrate, prandaj edhe numri i kontrave të lidhura është më i vogël se numri i njoftimeve të fituesit.



3

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, ZBATIMI DHE MONITORIMI I TYRE

Agjencia e Prokurimit Publik është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për prokurimin publik.

Njëkohësisht, duke qenë se Prokurimi Publik është pjesë edhe e strategjive të tjera kombëtare, APP ndjek zbatimin e aktiviteteve dhe përmbushjen e indikatorëve përkatës për këto strategji në mënyrë të vazhdueshme.

Gjatë vitit 2022, APP ka kontribuar gjithashtu edhe në procesin e rishikimit dhe hartimit të strategjive të reja ku është pjesë prokurimi.

3.1. Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2020-2023

Strategjia Kombëtare për Prokurimit Publik 2020-2023 është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 850, datë 04.11.2020 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020-2023 dhe të Planit të veprimit për Zbatimin e saj” duke përcaktuar objektivat në fushën e prokurimit publik në Shqipëri.

SKPP-ja udhëhiqet nga vizioni për të garantuar një sistem prokurimi eficient dhe të qëndrueshëm, në përputhje me parimet për transparencë, konkurrencë të drejtë dhe të lirë, mos diskriminim dhe trajtim të barabartë, përmes nxitjes dhe inkurajimit të një sistemi të qëndrueshëm që garanton raportin kosto-përfitim.

Kjo është një strategji ndërsektoriale dhe në këtë proces kompleks Agjencia e Prokurimit Publik është institucioni që bashkërendon dhe monitoron zbatimin e saj nëpërmjet edhe të kontributeve të deponuara nga institucionet raportuese .

Gjatë vitit 2022, APP, në cilësinë e institucionit përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e zbatueshmerisë së Strategjinë Kombëtare për Prokurimin Publik (SKPP) 2020-2023, ka bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e masave dhe raportimin e progresit të aktiviteteve dhe treguesve të performancës së parashikuar.

Në këtë kuadër, gjatë këtij viti, është riformatuar struktura monitoruese SKPP, e mbikëqyrur nga Komiteti Drejtues, i cili kryesohet nga drejtori i përgjithshëm i APP, duke vijuar me përditësimet e anëtarëve të Grupeve të Qëllimit të Politikave dhe me Sekretariatit Teknik në APP, i cili siguron mbarëvajtjen e punës. Gjatë 2022, KD ka zhvilluar dy mbledhje në të cilat ka miratuar raportet përkatëse të monitorimit:

- (i). Mbledhja e datës 7 Qershor 2022, ku është miratuar Raporti i Monitorimit 1 vjeçar për vitin 2021 të SKPP 2020-2023;
- (ii). Mbledhja e datës 22 dhjetor 2022, ku është miratuar Raporti i Monitorimit 6 mujori i I (parë) për vitin 2022 të SKPP 2020-2023.

Në takimin e Komitetit Drejtues është kërkuar nga institucionet kontribuese bashkëpunimi i tyre dhe marrja e masave në raportimin e aktiviteteve dhe treguesëve të performancës të pa raportuar. Nga ana e përfaqësuesve të KD u theksua rëndësia e forcimit të bashkëpunimit, duke synuar realizimin me sukses të aktiviteteve dhe rritje të indikatorëve të performancës të parashikuar.



3.2. STRATEGJITË NDER SEKTORIALE

Prokurimi Publik është gjithashtu pjesë e rëndësishme e katër Strategjive ndër sektoriale kryesore të Qeverisë Shqiptare, konkretisht,

- (i) Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022;
- (ii) Strategjia Ndër sektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 ;
- (iii) Strategjia për Reformën në Administratën Publike 2015-2022 dhe
- (iv) Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030;

APP angazhohet maksimalisht duke bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet koordinuese dhe të përfshira në këto strategji, duke dhënë kontributin përkatës në kohë reale dhe duke raportuar lidhur me realizimin e aktiviteteve apo indikatorëve të parashikuara në këto dokumente.

3.2.1. Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022

APP është një nga institucionet pjesë e Strategjisë për menaxhimin e Financave publike, duke dhënë kontribut dhe informacione lidhur me aktivitetet dhe indikatorët e parashikuar në fushën e prokurimeve në këtë strategji.

Aktivitetet e parashikuara në këtë strategji janë realizuar i dhe është përmbushur indikator i parashikuar. Përqindja në vlerë e procedurave të realizuara me fitues për gjashtëmujorin e parë të vitit në raport me fondin total të parashikuar për këtë periudhë në regjistrin e parashikimeve ka shënuar vlerën 80.3 % në vitin 2022 krahasuar me vlerën prej 60.2% që rezultonte në 2021 duke shënuar rritje.

Në parim, realizueshmëria e lartë e procedurave të parashikuara në regjistrin e parashikimeve është një tregues shumë i rëndësishëm që lidhet me mirë planifikimin e procedurave të prokurimit nga ana e Autoriteteve Kontraktore dhe rritjen e efencës në shpenzimin e fondeve publike.

APP gjithashtu është anëtare në grupin e punës për hartimin e Strategjisë së RE për Menaxhimin e Financave Publike, duke dhënë kontributin e saj lidhur me aktivitetet që parashikon të realizojë në të ardhmen.

3.2.2. Strategjia Ndër sektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023

APP është institucioni që raporton realizimin e 3 indikatorëve konkret të parashikuar në Strategjinë Ndër sektoriale kundër Korrupsionit mbi baza të rregullta 3 mujore, 6 mujore dhe vjetore.

Duhet theksuar se, sa i takon zbatimit të masave dhe realizimit të treguesve të performancës sipas këtyre strategjive situata paraqitet shumë pozitive për vitin 2022 dhe APP ka përmbushur të gjithë indikatorët e parashikuar në strategjinë antikorrupsion për këtë vit, si më poshtë:



- A.2.a: Përqindja e elementëve të modifikuar në Planet Vjetore të Prokurimit- për vitin 2022 kjo vlerë është 13.6 (duke mos kaluar vlerën prej 20%)
- A.2.b: Përqindja e kontratave të dhëna përmes procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës-kjo vlerë për vitin 2022 është 3.3% (duke mos tejkalluar vlerën 10%);
- A.2.c: Përqindja e kontratave të ndryshuara gjatë vitit-Kjo vlerë për vitin 2022 është 4.9% (duke mos tejkalluar 10%)

Përmbushja e indikatorëve të mësipërm lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me transparencën e procesit të prokurimit, mirë planifikimin e procedurave të prokurimit dhe efikasitetin në shpenzimin e fondeve publike dhe realizimin e kontratave.

APP gjithashtu është anëtare në grupin e punës për hartimin e Strategjisë së re Antikorrupsion, duke dhënë kontributin e saj lidhur me aktivitetet që parashikon të realizojë në të ardhmen.

3.2.3. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030

Agjencia e Prokurimit Publik, gjatw vitit 2022 ishte një nga institucionet pjesë e grupit të punës dhe kontribuuese në draftimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe integrim Evropian 2022-2030.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 është dokumenti kryesor strategjik që jep drejtimit dhe përcakton përparësitë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të Shqipërisë në rrugën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Draft -Strategjia parashikon shprehimisht se procesi i prokurimit publik është krejtësisht i digjitalizuar, i lehtë, i aksesueshëm, transparent, në të gjitha fazat e tij.



PROCESI I INTEGRIMI EUROPIAN DHE BASHKËPUNIMI MË TË TRETËT

Përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian, si edhe harmonizimi i sistemit të prokurimit në Shqipëri me praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare është një nga drejtimet kryesore të veprimtarisë së Agjencisë së Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, APP, në cilësinë e kryesuesit të punës për Kapitullin 5 të acquis-së: Prokurimi Publik ka marrë të gjitha masat e nevojshme për koordinimin e aktiviteteve të nevojshme në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga ky kapitull.

Si një institucion lider dhe koordinator për kapitullin e 5-të “Prokurimi Publik”, APP jep kontribut në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), raporton në mënyrë periodike pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, raporton pranë Komitetit të Stabilizim-Asociimit, Nënkomitetit për “Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën, përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit”, Nën komitetit për Çështjet Ekonomike dhe Financiare dhe Statistikat, Nën komitetin për Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit, Politikat Sociale”, si dhe jep kontributin e tij për Progres Raportin.

Më datë 15 Shkurt 2022, u zhvillua online takimi i 12-të Komitetit të Stabilizim-Asociimit, në të cilin APP raportoi mbi shkallën e përafrimit të Acquis së BE-së në fushën e prokurimit publik, kuadrit strategjik, kapacitetet monitoruese të saj, si dhe informacion statistikor mbi performancën e sistemit të prokurimit publik në Shqipëri.

Nën komiteti “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca, përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit” Takimi i 13-të i Nën komitetit “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit”, u zhvillua në Bruksel, në Maj 2022. APP paraqiti një raport të hollësishëm të aktivitetit të institucionit, lidhur me procesin e përafrimit të legjislacionit dhe nismat e parashikuara në të ardhmen, informacion statistikor lidhur me procedurat e prokurimit, aktivitetet zbatuese dhe implementimin e ligjit, si dhe lidhur me rritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.

APP paraqet kontribute dhe raporte të rregullta mbi baza mujore, 3-mujore, 6-mujore sa herë që kërkohet nga zyra e Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatorin.

Sipas raportit vjetor për 2022 të Komisionit Evropian, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në prokurimet publike. Është bërë përparim i mirë, veçanërisht sa i takon vijimit të procesit të miratimit të legjislacionit dytësor në zbatim të ligjit të ri për prokurimin publik, vënies në punë të sistemit elektronik të ankesave, zhvillimit dhe implementimit të kurseve të trajnimit me certifikim për prokurimin publik, publikimit të raportit të parë të monitorimit për strategjinë e prokurimit publik dhe vendosjen e “të dhënave të hapura”/open data në kohë reale për procedurat e prokurimit dhe përfshirjes së risqeve të korrupsionit të lidhura me prokurimin në planet e integritetit të institucioneve.

Sa i takon fushës së prokurimit publik, me anë të miratimit të Ligjit të ri për prokurimin publik në vitin 2020, të rregullave për prokurimin publik në maj të 2021, DST-ve, udhëzimeve, VKM për format e komunikimit, VKM për kodet CPV është arritur një përafrim i konsiderueshëm i Direktivës 2014/24/BE dhe Direktivës 2014/25/BE. Megjithatë, nevojitet përafrim i mëtejshëm i direktivave, veçanërisht sa i takon kufijve monetarë.



Sa i takon koncesioneve dhe PPP-ve, shkalla e përafritimit me Direktivën 2014/23/BE është vlerësuar si e pjesshme. Në bazë të analizës së boshllëkut ligjor të realizuar nga ekspertët e SIGMA, është konstatuar që ligji aktual është bazuar në direktivën e mëparshme të koncesioneve dhe nevojitet një ligj i ri cili të reflektojë dispozitat e Direktivës 2014/23.

Sa i takon prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, me anë të miratimit të Ligjit Nr. 36/2020 për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, të rregullave për prokurimet në këtë fushë në dhjetor të vitit 2020, si dhe të DST-ve në prill të 2021 është arritur një përafrim shumë i konsiderueshëm i Direktivës 2009/81/KE. Megjithatë, nevojitet përafrim i mëtejshëm i direktivës, veçanërisht sa i takon kufijve monetarë.

Në përgjithësi, acquis e BE-së për Kapitullin 5 janë përafuar në masën më të gjerë me anë të ndryshimeve të fundit ligjore, me përjashtim fusha e koncesioneve e cila do të kërkojë një përafrim të mëtejshëm. Për këtë arsye, në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025, është parashikuar miratimi i një ligji të ri për koncesionet dhe PPP-të në përputhje me Direktivën 2014/23/EU.

4.1. PROCESI SCREENING

Në vijim të Konferencës së Parë Ndërqeveritare të mbajtur në 19 Korrik 2022 në Bruksel, është punuar dhe zhvilluar takimi shpjegues dhe dypalësh në kuadër të procesit “screening” për Kapitullin 5, si pjesë e Grupimit 1 “Themeloret”.

Më datë 15 Shtator, në Bruksel, u zhvillua takimi shpjegues në kuadër të procesit “screening” për Kapitullin 5. Në këtë takim delegacioni shqiptar u kryesua nga Ministri i Shtetit dhe Kryenegociatori Znj. Mjalinda Dhuka dhe Drejtori i Përgjithshëm i APP dhe njëkohësisht Negociatori për Kapitullin 5, Znj. Reida Kashta. Në këtë takim, pala shqiptare u njoh me acquis-në për Kapitullin 5, duke përfshirë dhe përditësimet që nga takimi shpjegues i fundit në 2018, si dhe u dhanë shpjegime mbi zhvillimin e takimit bilateral, i planifikuar për tu zhvilluar në Nëntor.

Më datë 18 Nëntor 2022, në Bruksel, u përmyll takimi dypalësh Shqipëri-BE, në kuadër të procesit “screening”, për Kapitullin 5 “Prokurimi Publik”. Delegacioni Shqiptar u pwrfaqwsua nga Ministri i Shtetit dhe Kryenegociatori , Znj.Majlinda Dhuka, nga Zv. Ministri i Drejtësisë Znj. Adea Pirdeni, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik dhe njëkohësisht Negociatori për Kapitullin 5 :Prokurimi Publik”, Znj. Reida Kashta.

Paraprakisht , pranë shërbimeve të Komisionit Evropian u dërguan informacione dhe materiale mbështetëse lidhur me fushën e prokurimit publik. Shërbimet e Komisionit Evropian dërguan një pyetësor me disa pyetje, të cilat u përgatiten dhe u dërguan brenda afateve kohore të përcaktuara, pyetje të cilat mbulonin jo vetëm pjesën e procedurave të prokurimeve publike, mënyrën e funksionimit dhe element proceduralë por edhe rishikimin-ankimin ndaj procedurave të prokurimit publik, të dhëna statistikore, informacione rreth kuadrit ligjor dhe atij institucional të institucioneve që merren me prokurimet publike, mirëfunksionimin e sistemit elektronik etj. Pjesë e dokumentacionit që u dërgua ishin edhe prezantimet , që do të mbaheshin në takimin bilateral midis palëve, të cilat përmbanin informacion të detajuar dhe duke mbuluar çdo aspekt lidhur me prokurimet publike. Gjatë takimit, u prezantuan dhe u diskutuan 10 tema, në përputhje me axhendën e detajuar dërguar nga ana e Komisionit Evropian, konkretisht:

- 1.Konsiderata të përgjithshme dhe pasqyra e kuadrit ligjor të prokurimit publik dhe e arkitekturës institucionale;
- 2.Prokurimet në sektorin klasik;
- 3.Prokurimet në sektorin utilitar;



- 4.Koncesionet dhe Partneriteti Publik-Privat;
- 5.Prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë;
- 6.Sistemi i shqyrtimit të ankesave;
- 7.Prokurimi elektronik;
- 8.Prokurimi inovativ, social dhe i gjelbër, SME, profesionalizimi;
- 9.Dimensioni ndërkombëtar, duke përfshirë marrëveshjet ndërqeveritare;
- 10.Lufta ndaj korrupsionit në prokurimet publike.

Komisioni Evropian, nën drejtimin e Z. Marc Jorna, theksoi se takimi rezultoi shumë i suksesshëm, ku u cilësua se legjislacioni shqiptar është në masën më të madhe i përafëruar me Acquis-të e BE-së dhe u inkurajua vijimi i punë për përmirësime të mëtejshme në këtë drejtim.

Janë organizuar takime të rregullta të GNPIE lidhur me hartimin e materialeve dhe raporteve të ndryshme sipas kërkesës së MEPJ dhe të Ministres së Shtetit dhe Kryenegociatores. Janë hartuar kontributi për nen komitetin “Tregu i brendshëm”, Progres Raportin, si dhe raportimet javore, dhe 3 mujore për Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociatorin. APP jep kontribut edhe në kuadër të kapitujve të tjerë ku është pjesë, përveç koordinimit dhe udhëheqjes së kapitullit 5 “Prokurimi Publik”.

Krahas Kapitullit 5, APP ka raportuar dhe ka marrë pjesë më takimet shpjeguese dhe dypalëshe screening për kapitujt e tjerë ku është përfshirë prokurimi publik, fizikisht dhe online. Konkretisht, APP ka raportuar për Kapitullin 20, dhe Kapitullin “Kriteri Ekonomik”. Gjithashtu, APP ka marrë pjesë fizikisht në Bruksel në takimin shpjegues në kuadër të procesit “screening” për Kapitullin “Kriteri Ekonomik”, ndërkohë që takimi dypalësh për këtë Kapitull është ndjekur online. Po ashtu, APP ka ndjekur online takimet shpjeguese dhe dypalëshe për Kapitullin 11, Kapitullin 20, Kapitullin 22 Kapitujt 23 dhe Kapitullin 24.

4.2. PROCESI I ADERIMIT TË SHQIPËRISË NË GPA TË OBT

Me Urdhër të Kryeministrit nr.156, datë 28.09.2022 “Për ngritjen e Grupit të Punës për përgatitjen e kushteve të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Prokurimit Publik të Organizatës Botërore të Tregtisë”, është formatuar Grupi i Punës që kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik dhe ka në përbërje përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë , Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, mbështetur nga një Sekretariat Teknik. Grupi i punës është përgjegjës për përgatitjen e kushteve për ndjekjen e procesit të aderimit të Shqipërisë në Marrëveshjen Qeveritare për Prokurimet Publike. Viti 2023 do të jetë një vit pune intensiv për sa i përket këtij procesi.

4.3. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË TJERA

Gjatë vitit 2022, APP ka vijuar bashkëpunimin periodik me institucionet, me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, si: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, nëpërmjet këmbimit të informacioneve respektive mbi operatorët ekonomikë fitues të procedurave të prokurimit dhe verifikimit të faktit nëse këta operatorë ekonomikë ushtrojnë veprimtarinë duke zbatuar kërkesat e legjislacionit në fuqi, sipas fushave respektive, që mbulon secili prej këtyre institucioneve.



Bashkëpunimi me këto institucione është i vazhdueshëm në drejtim të relatimit nga APP, të operatorëve ekonomikë që kanë përfituar fonde publike, dhe verifikimit nga AKU dhe ISHPSHSH nëse këta operatorë kanë qenë të penalizuar, për mosrespektim të kërkesave të legjislacionit të punës në fuqi.

Në këtë kuadër, nga këto institucione vijojnë të relatohen pranë APP raste, ku subjekte të ndryshëm janë dënuar me gjobë për shkelje të legjislacionit të punës ose rezultojnë të mos ushtrojnë aktivitetin në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Kjo ka sjellë që APP, të vijojë punën e saj për nisjen e procedimeve administrative për përjashtimin e këtyre operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike pasi, nga verifikimet e kryera ka rezultuar se një pjesë e tyre kanë marrë pjesë dhe janë shpallur fitues në procedura prokurimi, duke keqinformuar autoritetet.

APP ka vijuar bashkëpunimin me Komisionin e Prokurimit Publik, i cili është edhe një nga institucionet kontribuuese pjesë e kapitullit 5 “Prokurimi Publik”, kontribuues i rëndësishëm në procesin e takimit bilateral të Screening, pjesë e kontributeve në kuadër të realizimit të aktiviteteve dhe plotësimit të indikatorëve të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik, etj. Midis APP dhe KPP ka komunikim dhe bashkëpunim të vijueshëm në kuadër të realizimit të detyrimeve ligjore dhe angazhimeve të përbashkëta.

Gjatë vitit 2022, APP në kuadër të organizimit të takimeve shumëpalëshe si dhe bashkëpunimit me institucionet e treta por edhe në kuadër të realizimit të aktiviteteve të parashikuara në SKPP ka realizuar në dhjetor 2022 një tryezë diskutimi dypalëshe me Autoritetin e Konkurrencës të cilat kanë konkluduar në firmosje e përbashkët të një Udhërrëfyesi nga dy institucionet. Ky udhërrëfyes synon mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në prokurimet publike, me fokus parandalimin e marrëveshjeve të fshehta në prokurimet publike. Në këtë takim të datës 20 dhjetor, përveç përfaqësuesve të Autoritetit të Konkurrencës dhe të Agjencisë së Prokurimit Publik morën pjesë edhe përfaqësues të komunitetit të biznesit, dhomave të tregtisë dhe industrisë, studiove ligjore, etj .

Midis APP dhe Shkollës së Magjistraturës, në tetor 2022 është firmosur memorandumi i Bashkëpunimit, i cili synon rritjen e bashkëpunimit midis Shkollës së Magjistraturës dhe Agjencisë së Prokurimit Publik në fusha me interes të përbashkët. Palët angazhohen për të bashkëpunuar ngushtësisht për çështjet me interes të përbashkët, me qëllim arritjen e këtyre objektivave të tilla si vijimin e bashkëpunimit për përfshirjen e temave mbi prokurimin publik në programin e trajnimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës; Vijimin e bashkëpunimit për përfshirjen e temave mbi prokurimin publik në programet e trajnimit të vazhdueshëm për magjistratët, gjyqtarë e prokurorë, të cilët shqyrtojnë çështje që lidhen me procesin e prokurimit; Organizimin e konferencave të përbashkëta, leksioneve të hapura apo takimeve në lidhje me zhvillimet në fushën e prokurimit dhe problematikat e konstatuara; Shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit në lidhje me tematika të ndryshme në fushën e prokurimit publik, etj.

Midis APP dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Qershor 2022 kanë firmosur memorandumin e Bashkëpunimit, i cili ndër të tjera synon forcimin e bashkëpunimit midis palëve, në funksion të zbatimit të parashikimeve të Kodit Zgjedhor si dhe të legjislacionit të prokurimit publik, në kuadër të mire përdorimit të fondeve publike në procedurat e prokurimit publik.

Gjithashtu, ka pasur komunikim të vazhdueshëm dhe është hartuar një draft memorandum, i cili është në proces diskutimi me Ministrinë e Drejtësisë, Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit, në funksion të bashkëpunimit institucional për parandalimin dhe ndëshkimin e veprimeve abuzive dhe korrupsionit në procedurat e prokurimit publik dhe rritjen e integritetit të punonjësve që kryejnë këto procedura.



4.4. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË HUAJA

Gjatë këtij viti APP ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë me SIGMA/OECD në kuadër të nismave të reja ligjore sa i takon fushës së të prokurimit publik në Shqipëri.

Gjithashtu, ka pasur bashkëpunim të ngushtë me Bankën Botërore, në kuadrin e një projekti të saj, i cili synon të asistojë APP në përgatitjen e një metodologjie që lidhet me prokurimin e gjelbër (green public procurement) si edhe në përcaktimin në kuadrin ligjor dhe rregullator për prokurimin publik të standardeve për mallrat, shërbimet dhe punët dhe planifikimin e procedurave të prokurimit për reagimin ndaj katastrofave natyrore.

Po ashtu, APP po bashkëpunon ngushtësisht me Prezencën e OSBE dhe me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për të zhvilluar një program trajnimi gjithëpërfshirës dhe të certifikuar që synon profesionalizimin e funksionit të prokurimit publik në Shqipëri në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare. Aktualisht, është finalizuar Udhërrëfyesi i Profesionalizimit dhe po punohet për finalizimin e kurrikulave të trajnimit.

Pas fazës së përzgjedhjes së ekspertëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë në prokurimet publike, është hartuar Raporti i parë, material i cili përcakton me hollësi hapat që do të ndiqen lidhur me vijueshmërinë e projektit. Është mbajtur takimi midis ekspertëve dhe përfaqësuesve të APP lidhur me materialet dhe dokumentet të cilat do të pasojnë me përgatitjen e materialeve të tjera-kurrikulat përkatëse të cilat do të shërbejnë si bazë për organizmin e trajnimeve në kuadër të një plani trajnimesh shumëvjeçar që kanë në fokus krijimin e një rrjeti profesionistësh në prokurimet publike.



5

INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2022

Gjatë vitit 2022, APP ka vijuar punën për hartimin e akteve për plotësimin e legjislacionit dytësor në zbatim të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, me qëllim përafrimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator të prokurimit publik me Direktivat e BE në këtë fushë, si dhe adresimin e paqartësive apo problematikave të dala nga zbatimi i ligjit, në periudhën nga hyrja në fuqi e tij (Mars 2021), në funksion të mirë menaxhimit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve publike. Në këtë kontekst, janë hartuar aktet, si vijon:

- *Projektvendim “Për përcaktimin e rregullave për pavlefshmërinë e kontratave të prokurimit publik”, i cili është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.486, datë 21.07.2022;*
- *Projektvendim “Për Përcaktimin e Tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, për të cilin është hartuar një draft dhe ka vijuar komunikimi me Komisionin e Prokurimit Publik, si institucion në llogari të të cilit do të kalojë tarifa e ankimit;*
- *Dokumentet Standarde të Tenderit, për shërbimet sociale dhe shërbimet e tjera specifike, të cilat plotësojnë kuadrin rregullator të prokurimit publik, në përafrim edhe me legjislacionin evropian, konkretisht Direktivat 2014/24 dhe 2014/25, të miratuara me Vendimin e APP, Nr. 01 datë 25.02.2022.;*
- *Rishikimi i Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), për mallra, punë, shërbime, për procedurat e prokurimit publik, të miratuara me Vendimet respektive të APP, Nr. 02, datë 09.06.2021, Nr.03 datë 09.06.2021, Nr. 04 datë 11.06.2021, Nr. 05 datë 17.06.2021, Nr. 06 datë 23.06.2021, Nr. 07. 25.06.2021, Nr. 08 datë 25.06.2021, Nr. 09.25.06.2021, Nr. 10 datë 02.07.2021, Nr. 11 datë 02.07.2021.*

Gjithashtu, për t’i ardhur në ndihmë autoriteteve/enteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë, në funksion të mirë zbatimit të kuadrit ligjor për prokurimin publik, APP ka punuar për hartimin e udhëzimeve, rekomandimeve dhe njoftimeve të ndryshme. Konkretisht, janë hartuar 4 (katër) udhëzime, 1 (një) rekomandim dhe 9 (nëntë) njoftime.

Tabela 57

Udhëzime	Rekomandime	Njoftime
4	1	9

Këto akte kanë pasur në fokus:

- Reflektimin e parashikimeve të reja ligjore, sa i takon deklaratën të konfliktit të interesit, me synim parandalimin e tij në procedurat e prokurimit, në çdo situatë, ku titullari ose punonjësi të autoritetit ose entit kontraktor ose ofruesit e shërbimit të prokurimit, që veprojnë në emër të autoritetit/entit kontraktor të përfshirë në zhvillimin e procedurës së prokurimit, mund të ndikojnë në rezultatin e kësaj procedure, duke cenuar pavarësinë dhe pavarësinë e tyre në vendimmarrjen e procedurës së prokurimit.



- Për këtë qëllim, APP ka bashkëpunuar ngushtësisht me ILDKPI, si institucioni kompetent për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.
- Reflektimin e parashikimeve të reja ligjore, si dhe rregullimin e disa problematikave të evidencuara në praktikë, lidhur me procesin e administrimit të mostrave në një procedurë prokurimi, me qëllim garantimin e transparencës dhe integritetit në këtë proces.
- Rekomandimin e autoriteteve/enteve kontraktore për mirë zbatimin e legjislacionit të ri të prokurimit publik, duke orientuar mbi hartimin e kriterëve të pranimit në procedurat e prokurimit.
- Orientimin e operatorëve ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit mbi plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, duke vënë theksin që në çdo rast në këtë formular duhet të pasqyrojnë informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike, për të shmangur situata të keqinformimit të autoriteteve kontraktore në procedurat e prokurimit.
- Orientimin e autoriteteve/enteve kontraktore, mbi përdorimin dhe hartimin e setit të Dokumenteve Standarde të Prokurimit për Shërbimet Sociale dhe Shërbimet të tjera Specifike, si dhe faktin se, duhet të respektojnë kufirin monetar të parashikuar në VKM, për kontratat e shërbimeve sipas kodeve respektive, për të cilat do të zhvillohet procedura e prokurimit.



6

VEPRIMTARIA KËSHILLUESE DHE ASISTUESE E APP

6.1. Praktikave të shqyrtuara për dhënie mendimesh, këshilla apo udhëzimesh

Gjatë vitit 2022, APP, në zbatim të detyrave që i ngarkon legjislacioni, ka trajtuar një numër të konsiderueshëm praktikash, të cilat kanë pasur të bëjnë me dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve/enteve kontraktore, dhënien e mendimeve për projekt akte të ndryshme, shqyrtimin e propozimeve të autoriteteve/enteve kontraktore apo edhe të operatorëve ekonomikë për përjashtimin e subjekteve të ndryshme nga e drejta për të fituar kontrata publike.

APP ka asistuar autoritetet/entet kontraktore, si dhe operatorët ekonomikë, duke trajtuar kërkesat e tyre për mendim/sqarim, të paraqitura në rrugë shkresore apo elektronike.

Konkretisht:

- numri total i praktikave të shqyrtuara, në rrugë shkresore, për çështje që lidhen me procesin e prokurimit publik, koncesioneve/PPP-ve, dhe ankandeve publike është 1589 praktika.
- numri total i kërkesave të shqyrtuara, në rrugë elektronike rezultojnë të jetë rreth 540.

Gjatë vitit 2022, APP ka patur komunikime me institucione të ndryshme dhe kryesisht me:

- i. Komisionin e Prokurimit Publik, për çështje që lidhen me sistemin e prokurimit publik, në funksion të efikasitetit të këtij sistemi;
- ii. Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe organe të tjera audituese në vend, në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë për vlerësimin e gjetjeve në fushën e prokurimit publik, të këtyre institucioneve gjatë auditimeve të kryera në autoritetet kontraktore, si dhe për çështje të lidhura me sistemin e prokurimit publik;
- iii. autoritete të ndryshme kontraktore dhe operatorë ekonomikë, të cilët kanë kërkuar mendime dhe sqarime për paqartësi mbi çështje të lidhura me legjislacionin dhe procesin e prokurimit;
- iv. institucione të qeverisjes qendrore (ministri), në kuadër të dhënies së mendimeve mbi projektvendime apo projektligje që kalojnë për miratim në Këshillin e Ministrave, në fushën e prokurimit publik/koncesioneve/partneritetit publik privat dhe ankandeve publike;
- v. Institucionet e Prokurorisë, në lidhje me informacione të ndryshme të kërkuara nga ana e tyre mbi procedurat e prokurimit të kryera nga autoritete të ndryshme kontraktore, studio të ndryshme ligjore, të cilat në bazë të së drejtës për informim kanë kërkuar vënien në dispozicion të dokumenteve të procedurave të prokurimit apo kanë kërkuar informacion mbi procedura të caktuara prokurimi, organet e medias vizive apo gazetarë të ndryshëm, etj;
- vi. operatorë të ndryshëm ekonomikë, të cilët kanë kërkuar të pajisen me vërtetime që të pasqyrojnë gjendjen e tyre, si operatorë që nuk janë përjashtuar me një vendim të APP nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik. Vlen të theksohet se, me hyrjen në fuqi të Nr. 252, datë 29.04.2022 "Për procedurat e ofrimit të shërbimeve online dhe institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre", shërbimi do të kryhet vetëm nëpërmjet platformës e-albania;
- vii. Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë Kryeministrisë, mbi verifikimin e kërkuar për operatorë ekonomikë të caktuar, nëse ka patur një vendim përjashtimi për to nga APP;
- viii. Operatorët ekonomikë, të cilët janë kanë kontestuar procedura të ndryshme prokurimi.



Problematikat e asistuarra kanë pasur të bëjnë me çështje dhe paqartësi të ndryshme, gjatë procesit të prokurimit, të tilla si:

- mënyrës së plotësimit të Formularit të Vetëdeklarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit;
- momentin e dorëzimit të dokumentacionit nga operatori ekonomik, përpara se të shpallet fitues, sipas ndryshimeve më të fundit ligjore;
- lidhur me afatet e ankimimit, kur e ushtrojnë operatorët ekonomikë të drejtën e ankimimit në procedurat e prokurimit, sipas ndryshimeve më të fundit ligjore;
- vijimit të zbatimit të kontratave/marrëveshjes në proces me operatorët ekonomikë, të cilët janë të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike;
- në kushtet e shpalljes së situatës së veçantë me vendim të Këshillit të Ministrave, për shkak të rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore dhe karburantit, ka patur një komunikim të shpeshtë me autoritetet kontraktore, sa i takon impaktit që do të ketë rritja e çmimeve jo vetëm në kontratat e nënshkruara, por edhe gjatë procesit të ofertimit;
- zbatimin e rregullave procedurale në prokurimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike;
- rastet e modifikimit të kontratës apo marrëveshjes kuadër;
- momentin e plotësimit të deklaratave mbi konfliktin e interesit nga Zyrtaret/ Nëpunësit në procesin e prokurimit dhe zbatimin e kontratës;
- mbi rolet dhe përgjegjësit e autoritetit kontraktor në procesin e prokurimit.

Në formë tabelore, të dhënat mbi praktikat e shqyrtuara janë si më poshtë:

Tabela 58

Praktikat e shqyrtuara, në kuadër të asistencës ligjore	
Lloji i kërkesës	Numri
Kërkesa për dhënie mendimi/sqarimi/komunikim me institucione të tjera, në rrugë shkresore	180
Kërkesa për dhënie mendimi mbi projekt aktet e paraqitura	20
Verifikime të kërkuara nga DSIK	10
Vërtetime të lëshuara për operatorët ekonomikë që nuk janë në proces përjashtimi	1320
Kërkesa për informacion, të paraqitura nga institucione të ndryshme	24
Ankesa nga operatorë ekonomikë	13
Shkresa të adresuara gabimisht/përcjellë nga APP pranë institucioneve përkatëse	22
Kërkesa për dhënie mendimi/sqarimi/komunikim me institucione të tjera, në rrugë elektronike	540



6.2. VEPRIMTARIA ASISTUESE E APP

Në kuadër të këtij procesi, për periudhën **Janar-Dhjetor 2022**, nga **6494** procedura të shpallura në SPE⁸, janë asistuar në total **3012** procedura prokurimi, nga të cilat **59** me kërkesë paraprake të autoriteteve kontraktore përpara publikimit dhe **2953** pas publikimit të tyre në SPE. 2953 procedura që janë asistuar nga APP pas publikimit përbëjnë **45.5%** të procedurave të publikuara. Nga procedurat e asistuar, pas publikimit të tyre në SPE, 171 procedura janë anuluar dhe 2782 procedura kanë vijuar procesin e prokurimit.

6.2.1. Analizimi i të dhënave të procedurave të asistuar

Nga procedurat që kanë vijuar procesin e prokurimit, rezulton se:

- 53.6% e procedurave të asistuar janë procedura të shpallura nga institucionet e qeverisjes qendrore,
- 33.6% e procedurave të asistuar janë procedura të shpallura nga institucionet vendore,
- 7.7% e procedurave të asistuar janë procedura të shpallura nga shoqëritë anonime,
- 5.1% e procedurave të asistuar janë procedura të shpallura nga institucionet e pavarura.

Përqindja e procedurave të asistuar, krahasuar me vitin 2021, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 59

Procedurat	V i t i 2021	V i t i 2022
% e procedurave të asistuar kundrejt atyre të publikuara në SPE	60%	45.5%

Rënia e përqindjes së procedurave të asistuar, vjen si pasojë e rritjes së numrit të procedurave të shpallura përgjatë vitit 2022. Konkretisht, në vitin 2021 janë shpallur në SPE 5079 procedura prokurimi, ndërkohë që në vitin 2022 janë shpallur 6494. Megjithatë vlen të theksohet se APP në mënyrë të herëpashershme, gjetjet kryesore që ka konstatuar në procedurat që janë asistuar, i ka përmbledhur në rekomandime të përgjithshme duke iu kërkuar të gjithë Autoriteteve Kontraktore që ti mbajnë në vëmendje kur zhvillojnë procedura prokurimi. Si rezultat i këtyre rekomandimeve vërehet se numri i procedurave që APP ka asistuar gjatë vitit 2022, për të cilat nuk janë konstatuar problematika që duheshin adresuar, ka qënë më i lartë se në vitet paraardhëse.

Më poshtë paraqiten disa nga treguesit, të cilët konsiderohen si indikatorë të rëndësishëm, për të vlerësuar rezultatin e kësaj asistence të vazhdueshme.

6.2.2. Analizimi i të dhënave në lidhje me procedurat që rezultojnë pa problematika, kundrejt procedurave të asistuar

a) Analizimi i të dhënave në krahasim me vitin 2021

⁸ Përzgjedhja e procedurave që asistohen bëhet bazuar në fondin limit të tyre, duke i dhënë prioritet procedurave me fond limit më të lartë.




Nga 2782 procedura që janë asistuar pas shpalljes në SPE⁹, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022:

- 37% e procedurave të asistuar, kanë rezultuar përgjithësisht në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm për prokurimin publik apo me fushat specifike ku ekzekutimi i objektit të kontratës që prokurohet shtrin veprimtarinë e tij;
- 63% e procedurave të asistuar, kanë rezultuar me konstatime në lidhje me përm-bushjen e kushteve të legjislacionit të zbatueshëm dhe për të cilat u janë dërguar rekomandimet përkatëse autoriteteve kontraktore.

Paraqitja grafike e këtyre të dhënave është si më poshtë:

Grafiku 31



Nisur nga të dhënat e analizuara, rezulton se ka një rritje të përqindjes së numrit të procedurave që rezultojnë pa konstatime, pra me kriteret që konsiderohen në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, për vitin 2022, krahasuar me vitin 2021. Konkretisht, përqindja e procedurave pa konstatime në raport me procedurat e asistuar është në nivelin 37% dhe atyre me konstatime, në nivelin 63%, ndërkohë që në vitin 2021, këto përqindje kanë qenë respektivisht në nivelet 25% dhe 75%.

Megjithatë, numri i procedurave me konstatime nga APP, mbetet ende i lartë. Duke analizuar edhe ndikimin që ka patur publikimi nga ana e autoriteteve kontraktore, i procesverbalit të argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit, në nivelin e problematikave që janë hasur, rezulton se niveli i procedurave pa konstatime për këtë periudhë rezulton më i lartë se periudha paraardhëse. Nga sa më sipër, vihet re një ndikim pozitiv në rritjen e procedurave pa konstatime konkretisht me 12%.

Ky është një tregues i rritjes së ndërgjegjësimit të AK dhe rezultat i asistimit dhe rekomandimeve të përgjithshme të nxjerra herë pas here nga APP.

9 Në analizë nuk është përfshirë numri i procedurave të anuluar, si dhe lotet trajtohen si një procedurë e vetme.



b) Analizimi i të dhënave sipas tipologjisë së autoriteteve kontraktore.


Nga analiza e raportit të procedurave që kanë rezultuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe atyre që kanë rezultuar me konstatime, kundrejt procedurave të asistuar, të ndara sipas tipologjisë së autoriteteve kontraktore, rezulton dhe renditen si më poshtë:

- Për institucionet qendrore dhe institucionet e tyre të varësisë, 55% e procedurave të asistuar, paraqiten pa konstatime dhe 45% e tyre kanë rezultuar me konstatime;
- Për institucionet vendore dhe institucionet e tyre të varësisë, 15% e procedurave të asistuar paraqiten pa konstatime dhe 85% e tyre kanë rezultuar me konstatime.
- Për shoqëritë anonime me kapital shtetëror, 21.5% e procedurave të asistuar paraqiten pa konstatime dhe 78.5% e tyre kanë rezultuar me konstatime;
- Për institucionet e pavarura, 14% e procedurave të asistuar paraqiten pa konstatime dhe 86% e tyre kanë rezultuar me konstatime;

Nga të dhënat e mësipërme, rezulton se përqindja e procedurave pa problematika është në nivel më të lartë tek institucionet qendrore dhe në varësi të tyre, konkretisht 54.6% të procedurave të asistuar, dhe niveli më i ulët rezulton te institucionet vendore dhe në varësi të tyre, konkretisht 15% të procedurave të asistuar.

Paraqitja grafike e këtyre të dhënave është si më poshtë:

Grafiku 32



6.2.3. Analizimi i të dhënave në lidhje me reagimin/reflektimin e autoriteteve kontraktore, ndaj rekomandimeve të APP.

a) Analizimi i të dhënave në krahasim me vitin 2021

Nga analizimi i nivelit të reagimit të autoriteteve kontraktore kundrejt rekomandimeve që APP jep në lidhje me problematikat e konstatuara në hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, veçanërisht të kriterëve të veçanta për kualifikim, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në pjesëmarrje/konkurim në



prokurim, rezulton se për periudhën që analizohet janar-dhjetor 2022, nga procedurat e asistuar, për të cilat APP ka dërguar rekomandimet:

- në 69.2% të rasteve, autoritetet kontraktore kanë reflektuar ndaj rekomandimeve të APP;
- në 30.8% të rasteve, autoritetet nuk kanë reaguar ose nuk kanë reflektuar rekomandimet e APP.

Në një këndvështrim krahasimor në lidhje me vitin 2021, ku përqindja e reflektimeve ka qenë në nivelin 73% dhe përqindja e mos reflektimeve në nivelin 27%, rezulton se në vitin 2022 ka rënie të nivelit të reflektimit të autoriteteve kontraktore ndaj rekomandimeve të dhëna nga APP në lidhje me hartimin e dokumenteve të tenderit, në masën 3.8%.

Më poshtë, jepen të dhënat krahasimore, për vitet 2021-2022, në lidhje me numrin e procedurave për të asistuar :

Tabela 60

Procedurat	V i t i 2021	V i t i 2022
Procedurat e asistuar	2860	2782
Procedura prokurimi, për të cilat nuk janë evidentuar problematika ne hartimin e DT ose ku problematikat e evidentuara janë reflektuar nga AK	2282	2239
% e procedurave me reflektime kundrejt procedurave me rekomandime	79.8%	80.5%

Grafiku 33



Rezulton një rritje e lehtë e procedurave për të cilat nuk janë evidentuar problematika ne hartimin e DT ose ku problematikat e evidentuara janë reflektuar nga AK, më konkretisht 80.5%. Ky është një tjetër tregues i rritjes së ndërgjegjësimit të AK-ve në hartimin e DT ku ndikim ka patur dhënia e asistencës së vazhdueshme nga APP si dhe nxjerrja e rekomandimeve.



b) Analizimi i të dhënave sipas tipologjisë së autoriteteve kontraktore


Raporti i reflektimeve dhe mos reflektimeve, kundrejt rekomandimeve të dërguara nga APP, rezulton i ndryshëm për institucionet, sipas tipologjisë së tyre.

Konkretisht:

- Për shoqëritë anonime me kapital shtetëror, raporti i nivelit të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, është në masën 77%, ndërkohë që raporti i nivelit të mos reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP është në masën 23%.
- Për institucionet e pavarura, raporti i nivelit të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, është në masën 75%, ndërkohë që raporti i nivelit të mos reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP është në masën 25%.
- Për institucionet qendrore dhe institucionet e tyre të varësisë, raporti i nivelit të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, është në masën 72%, ndërkohë që raporti i nivelit të mos reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP është në masën 28%.
- Për institucionet vendore dhe institucionet e tyre të varësisë, raporti i nivelit të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, është në masën 64%, ndërkohë që raporti i nivelit të mos reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP është në masën 36%.

Paraqitja grafike e këtyre të dhënave është si më poshtë:

Grafiku 34



Nga sa më lart, rezulton se shoqëritë anonime kanë përqindjen më të lartë të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, konkretisht 77% të procedurave me konstatime, ndërkohë që institucionet e qeverisjes vendore kanë përqindjen më të ulët të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, konkretisht, 64% të procedurave me konstatime.

Në çdo rast, është me rëndësi të theksohet se rekomandimet e APP janë një vlerësim i përgjithshëm mbi informacionin që merret nga procedurat e shpallura në SPE dhe kanë qëllim rritjen e përgjegjshmërisë së AK-ve në hartimin e dokumentave të tenderit. Ndërkohë, çdo operator ekonomik që ka pretendime konkrete për kritere konkrete, në procedura specifike, duhet të ndjekë rrugët e ankimit dhe vendimmarrja përfundimtare mbi ligjshmërinë e kritereve në fjalë i takon Komisionit të Prokurimit Publik.



6.2.4. Analizimi i të dhënave në lidhje me mesataren e numrit të ofertave të paraqitura dhe ofertave të kualifikuara në procedurat e asistuar nga APP.


Një tregues shumë i rëndësishëm që monitorohet nga APP për procedurat e asistuar është edhe numri i pjesëmarrjes, si tregues i drejtpërdrejtë i konkurrencës në procedurat e prokurimit publik.

Nga shqyrtimi i të dhënave në lidhje me numrin e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e asistuar nga APP, për periudhën Janar-Dhjetor 2022, për të cilat janë dërguar rekomandime, rezulton se:

- Në procedurat që kanë reflektuar pjesërisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 4.49 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 2.65 oferta.
- Në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 3.77 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 2.29 oferta.
- Në procedurat që nuk kanë reaguar/reflektuar rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 3.08 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 1.66 oferta.

Grafikisht, mesatarja e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e asistuar, të ndara sipas reagimeve/reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, paraqiten si më poshtë:

Grafiku 35



Për sa më sipër, rezulton se mesatarja më e lartë e ofertave të paraqitura është në procedurat që kanë reflektuar plotësisht ose pjesërisht rekomandimet e APP, respektivisht në nivelin 3.77 dhe 4.49 oferta të paraqitura dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 2.29 dhe 2.65 oferta.

Gjithashtu, të dhënat e mësipërme mbi pjesëmarrjen janë analizuar edhe sipas tipologjisë së autoriteteve kontraktore. Konkretisht:

Nga shqyrtimi i të dhënave në lidhje me numrin e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e autoriteteve kontraktore të nivelit qendror, që janë asistuar nga APP për periudhën Janar-Dhjetor 2022, për të cilat janë dërguar rekomandime, rezulton se:



- Në procedurat që kanë reflektuar pjesërisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 4.75 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 2.59 oferta.
- Në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 3.64 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 2.05 oferta.
- Në procedurat që nuk kanë reaguar/reflektuar rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 2.57 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 1.57 oferta.

Grafikisht, mesatarja e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e asistuar të institucioneve qendrore, paraqiten si më poshtë:

Grafiku 36



Nga analizimi i mësipërm, rezulton se për autoritetet kontraktore të nivelit qendror, mesatarja më e lartë e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara është në procedurat që kanë reflektuar plotësisht ose pjesërisht rekomandimet e APP, respektivisht në nivelin 3.64 dhe 4.75 oferta të paraqitura dhe 2.05 dhe 2.59 oferta të kualifikuara.

Nga shqyrtimi i të dhënave në lidhje me numrin e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e autoriteteve kontraktore **të nivelit vendor**, që janë asistuar nga APP, për periudhën Janar-Dhjetor 2022, për të cilat janë dërguar rekomandime, rezulton se:

- Në procedurat që kanë reflektuar pjesërisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 4.75 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 2.98 oferta.
- Në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 3.84 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 2.47 oferta.
- Në procedurat që nuk kanë reaguar/reflektuar rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 3.05 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 1.86 oferta.



Grafikisht, mesatarja e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e asistuar, të ndara sipas reagimeve/reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, paraqiten si më poshtë:

Grafiku 37



Nga analizimi i mësipërm, rezulton se për autoritetet kontraktore të nivelit vendor, mesatarja më e lartë e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara është në procedurat që kanë reflektuar plotësisht ose pjesërisht rekomandimet e APP, respektivisht në nivelin 3.86 dhe 4.75 oferta të paraqitura dhe 2.47 dhe 2.98 oferta të kualifikuara.

Nga shqyrtimi i të dhënave në lidhje me numrin e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e autoriteteve kontraktore të pavarura, që janë asistuar nga APP, për periudhën Janar-Dhjetor 2022, për të cilat janë dërguar rekomandime, rezulton se:

- Në procedurat që kanë reflektuar pjesërisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 3.13 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 1.58 oferta.
- Në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 4.96 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 3.08 oferta.
- Në procedurat që nuk kanë reaguar/reflektuar rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 2.68 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 1.03 oferta.

Grafikisht, mesatarja e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e asistuar, të ndara sipas reagimeve/reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, paraqiten si më poshtë:



Grafiku 38



Nga analizimi i mësipërm, rezulton se për autoritetet kontraktore të pavarura, mesatarja më e lartë e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara është në procedurat që kanë reflektuar plotësisht ose pjesërisht rekomandimet e APP, respektivisht në nivelin 4.96 dhe 3.13 oferta të paraqitura dhe 3.08 dhe 1.58 oferta të kualifikuara.

Nga shqyrtimi i të dhënave në lidhje me numrin e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e autoriteteve kontraktore shoqëri anonime, që janë asistuar nga APP, për periudhën Janar-Dhjetor 2022, për të cilat janë dërguar rekomandime, rezulton se:

- Në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 3.32 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 2.28 oferta.
- Në procedurat që kanë reflektuar pjesërisht rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 2.84 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 1.88 oferta.
- Në procedurat që nuk kanë reaguar/reflektuar rekomandimet e APP, mesatarja e ofertave të paraqitura është 2.69 oferta dhe mesatarja e ofertave të kualifikuara është 1.85 oferta.



Grafikisht, mesatarja e ofertave të paraqitura dhe atyre të kualifikuara, në procedurat e asistuar, të ndara sipas reagimeve/reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, paraqiten si më poshtë.

Grafiku 39




Së fundmi, nga analizimi i raportit të ofertave të kualifikuara dhe atyre të skualifikuara, kundrejt ofertave të paraqitura, në procedurat e asistuar nga APP, për periudhën Janar-Dhjetor 2022, rezulton se:

- Në procedurat që kanë rezultuar pa problematika, përqindja e ofertave të kualifikuara është 67% e ofertave të paraqitura, ndërkohë që përqindja e ofertave të skualifikuara është 33%.
- Në procedurat që kanë reflektuar plotësisht rekomandimet e APP, përqindja e ofertave të kualifikuara është 61% e ofertave të paraqitura, ndërkohë që përqindja e ofertave të skualifikuara është 31%.
- Në procedurat që kanë reflektuar pjesërisht rekomandimet e APP, përqindja e ofertave të kualifikuara është 60% e ofertave të paraqitura, ndërkohë që përqindja e ofertave të skualifikuara është 40%.
- Në procedurat që nuk kanë reaguar/reflektuar rekomandimet e APP, përqindja e ofertave të kualifikuara është 60% e ofertave të paraqitura, ndërkohë që përqindja e ofertave të skualifikuara është 40%.

Grafikisht, raporti i ofertave të kualifikuara dhe atyre të skualifikuara, kundrejt ofertave të paraqitura, në procedurat e asistuar, të ndara sipas reagimeve/reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, paraqiten si më poshtë:



Grafiku 40



Nga sa më lart, rezulton se përqindja e ofertave të kualifikuara është më e lartë në procedurat që kanë rezultuar pa problematika, konkretisht në nivelin 67%.

6.2.5. Hartimi i rekomandimeve në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik dhe bashkëpunimi me AK-të.

Në vijimësi të mirë zbatimit të legjislacionit për prokurimin publik, APP pas analizimit të problematikave më të shpeshta të hasura gjatë asistimit të procedurave të prokurimit, në lidhje me hartimin e dokumenteve të tenderit dhe në veçanti të kriterëve të veçanta për kualifikim, është hartuar dhe publikuar Rekomandimi Nr.1797/1 datë 10.03.2022 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

Në kuadrin e bashkëpunimit me AK-të, APP ka realizuar takim informues me Njësitë e Qeverisjes Vendore, përsa i përket hartimit të kriterëve për kualifikim, procesverbalit të argumentimit dhe reflektimeve të rekomandimeve të dërguara nga APP.

Si konkluzion, vlerësojmë se për periudhën Janar–Dhjetor 2022, procesi i asistencës së dhënë autoriteteve kontraktore në hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ka vijuar normalisht, duke u asistuar pothuajse gjysma e procedurave të publikuara në SPE, si dhe duke asistuar çdo kërkesë paraprake të paraqitur nga autoritetet kontraktore. Niveli i procedurave pa problematika në hartimin e dokumenteve të tenderit, është rritur krahasimisht me vitin 2021 me masën 12%, si dhe niveli i reflektimit të autoriteteve kontraktore, kundrejt rekomandimeve të APP, rezulton në nivele pothuajse të njëjta krahasimisht me vitin 2021.

Për autoritetet kontraktore të nivelit qendror, të pavarura, si dhe shoqëritë anonime, niveli i reflektimeve dhe bashkëpunimit mbetet i lartë.

Ndërkohë, niveli i reflektimeve të autoriteteve kontraktore të nivelit vendor edhe pse mbetet në nivele më të ulëta se autoritetet e tjera kontraktore, informojmë se është rritur 8% krahasimisht me vitin 2021, ku si impakt pozitiv ka rezultuar takimi informues me Njësitë e Qeverisjes Vendore i zhvilluar nga sektori i Koordinimit.



VEPRIMTARIA MONITORUESE E APP

7.1. VERIFIKIMI I ZBATIMIT TË LIGJSHMËRISË SË PROCEDURAVE

7.1.1. Verifikimi ex-post i procedurave të prokurimit publik

APP kryen hetim administrativ lidhur me zbatimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit ose anulimit të procedurës. Afati për kryerjen e hetimit është jo më vonë se 3 vjet nga nënshkrimi i kontratës përkatëse të prokurimit/ anulimi i procedurës.

Hetimi administrativ nga APP, kryhet nëpërmjet hartimit të Planeve Monitoruese ose verifikimit të drejtpërdrejtë, si dhe nga indiciet e organeve audituese si KLSH, audite të brendshme të institucioneve, Drejtoria e Inspektimit Financiar, Koordinatori Kombëtar për Antikorrupsionin apo nga institucione të tjera që kërkojnë nga APP kryerjen e hetimit dhe marrjen e masave administrative ndaj personave përgjegjës.

Nëpërmjet procesit hetimor/verifikimit, APP nuk ka për qëllim vetëm penalizimin e personave, të cilët rezultojnë të kenë kryer veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore të prokurimit, por edhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për shmangien e problematikave të evidentuara dhe përmirësimin e procesit në të ardhmen.

Konkretisht, gjatë vitit 2022, APP ka kryer hetime administrative/verifikime, sipas të dhënave të tabelës së mëposhtme:

Të dhënat për numrin e autoriteteve kontraktore subjekt verifikimi dhe të procedurave të verifikuara ex post, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 61

Të dhëna mbi verifikimet e procedurave të prokurimit publik në vitin 2022	
Autoritete Kontraktore, subjekt verifikimi	42
Procedura prokurimi të verifikuara	177

Në vijim, në formë tabelore, paraqiten të dhëna mbi llojet e procedurave të prokurimit të verifikuara:

Tabela 62

Lloji i procedurës së prokurimit publik	Numri
Procedurë e hapur	45
Kërkesë për propozim	36
Procedurë e hapur e thjeshtuar	2
Negociim pa shpallje	3



Konkurs projektimi	1
Procedurë prokurimi me vlerë të vogël	57
Sistemi dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar	33
TOTALI	177

- Të dhënat mbi vendimmarrjen e APP në përfundim të verifikimeve të procedurave të prokurimit publik, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 63

Vendimmarrje e APP në përfundim të verifikimeve	
Vendime me masa administrative (gjobë dhe/ose propozim për masë disiplinore)	35
Vendime për mbyllje hetimi administrative/ Tërheqje vëmendje/mos-evidentim parregullsisht	8

- Të dhënat mbi masat administrative (gjobë/propozim masë disiplinore) të vendosura nga APP, në përfundim të verifikimeve të prokurimeve publike, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 64

Gjobë	Propozim për masë disiplinore
për 130 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi	për 95 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi

Gjithashtu, të dhënat mbi vendimet e dhëna sipas rolit të personit në procedurat e prokurimit të verifikuara dhe sipas numrit të autoriteteve kontraktore, pasqyrohen në tabelat e mëposhtme:

Tabela 65

Penalizime me gjobë	
Roli i zyrtarit	Numri
Anëtar i grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike	2 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Komisionit për hartimin e specifikimeve teknike, kriteret e kualifikimit/kapacitetet teknike	4 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Njësisë së Prokurimit	15 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	15 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave	3 Autoritete Kontraktore



Tabela 66

Propozim për masë disiplinore	
Roli i zyrtarit	Numri
Titullar i Autoritetit Kontraktor	3 Autoritete Kontraktore
Person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike	1 Autoritet Kontraktor
Anëtar i komisionit për përlllogaritjen e fondit limit/ i grupit të punës për përgatitjen e preventivit të punimeve	5 Autoritete Kontraktore
Person Përgjegjës për Prokurimin	2 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Njesisë së Prokurimit	7 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	9 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël	3 Autoritete Kontraktore
Anëtar i Komisionit të Sistemit Dinamik të Biletave	5 Autoritete Kontraktore

Referuar procedurave të verifikuara gjatë këtij viti;

- **59** procedura prokurimi kanë qenë objekt verifikimi kryesisht nga APP (plan verifikimi, denoncime nga operatorë ekonomikë), si dhe nga vendime të Komisionit të Prokurimit Publik.
- **118** procedura prokurimi kanë qenë objekt verifikimi si rezultat i indicieve nga raportet përfundimtare të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe audite të brendshme.

Autoritetet kontraktore subjekt verifikimi kryesisht nga APP, nga vendime të Komisionit të Prokurimit Publik dhe ato të dërguara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe audite të brendshme i përkasin në pjesën më të madhe institucioneve të nivelit qendror. Ndërkohë, një pjesë e vogël e tyre janë institucione vendore (bashki dhe institucione në varësi të tyre ose institucione te pavarura).

Procesi i hetimit administrativ/verifikimit gjatë këtij viti, është iniciuar kryesisht nga APP, në bazë të planeve të verifikimit, ose në vijim të denoncimeve të paraqitura nga operatorë ekonomikë, si dhe nga indiciet e organeve audituese dhe vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik, me të cilat i është propozuar APP, nisja e hetimit administrativ.

Nga hetimet/verifikimet e kryera janë konstatuar shkelje dhe mangësi të ndryshme, qoftë të aspektit procedural, të tilla si:

- *Mos-specifikim i personit/ave përgjegjës në urdhrin e prokurimit, sikurse përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Ndërkohë që, personi përgjegjës për prokurimin ka për detyrë ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të mbarëvajtjes së procesit të prokurimit, sipas detyrimeve që i ngarkon VKM këtij roli.*
- *Mospërcaktim i specialistit të fushës në procedurat e prokurimit, objekti i të cilave kërkon njohuri specifike. Edhe në përbërjen e komisionit të vlerësimit të ofertave ka rezultuar mospërcaktim i ekspertit të fushës, patur në konsideratë njohuritë e posaçme të nevojshme për objektin e prokurimit.*



- *Përcaktimi në përbërjen e komisionit të vlerësimit të ofertave të personave që kanë marrë pjesë në përgatitjen e dokumenteve të tenderit, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.*
- *Mungesë e argumentimit dhe dokumentimit të specifikimeve teknike, kritereve të veçanta të pranimit, përlogaritjes së fondit limit, sipas rregullave të prokurimit.*
- *Mospërcaktimi i specifikimeve teknike në shtojcën përkatëse të dokumenteve të tenderit.*
- *Mos-ngritje e një grupi pune apo caktim i përfaqësuesit/esve të autoritetit kontraktor për verifikimin e ligjshmërisë së specifikimeve teknike, në rastet kur, këto të fundit janë përgatitur nga subjekte private.*
- *Kërkesa, në të cilat nuk është përcaktuar qartë dokumenti konkret për t'u paraqitur nga operatorët ekonomikë, çka mund të krijojë problematika apo konfuzion si në plotësimin e vet kriterit nga operatorët ekonomikë ofertues, ashtu edhe gjatë vlerësimit të ofertave.*
- *Mosdokumentim i procesit të verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në formë të shkruar, të operatorit ekonomik fitues.*

Ashtu dhe ato me karakter thelbësor, si:

- *Kritere të veçanta apo specifikime teknike që pengojnë pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë, si*
 - *Staf teknik/Kategori licencash të panevojshme për objektin që prokurohet;*
 - *Certifikime të ndryshme që të disponohen nga i njëjti punonjës i operatorit ekonomik, çka krijon kushte për pengesë për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, që kanë punonjës me këto certifikime, por jo të disponueshme njëkohësisht nga i njëjti punonjës;*
 - *Kërkesa për certifikata të produktit konform standardeve europiane, pa specifikuar në kriter edhe variantin shqiptar, për ato standarde që janë adoptuar në këtë variant;*
 - *Kërkesë për autorizim prodhuesi pa argumentuar këtë kërkesë, në kushtet kur, operatorët ekonomikë mund t'i sigurojnë produktet objekt prokurimi nga distributorë të autorizuar dhe jo detyrimisht drejtpërdrejt nga vetë prodhuesi.*
- *Kualifikim i gabuar i operatorëve ekonomikë, me mangësi ose parregullsi në dokumentacionin e paraqitur, në përmbushje të kritereve të kualifikimit.*
- *Në disa procedura ka rezultuar mosplotësim i formularëve të deklarimit mbi gjendjen e konfliktit të interesit sipas rregullave të prokurimit publik. Konkretisht, ka rezultuar se, anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave kanë nënshkruar deklaratat përkatëse lidhur me ofertuesit pjesëmarrës, përpara ditës së hapjes së ofertave, duke e bërë këtë deklaram formal, pasi në datën e deklarimit anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave nuk kanë pasur dijeni mbi ofertuesit pjesëmarrës.*

Gjithashtu, anëtarë të njësisë së prokurimit nuk kanë nënshkruar deklaratat, në momentin e emërimit në këtë cilësi, apo persona të tjerë të caktuar për procese të ndryshme të prokurimit, si, për përlogaritjen e fondit limit apo për shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë.

APP ka sjellë në vëmendje të autoriteteve, parashikimet e rregullave të prokurimit lidhur me detyrimin e plotësimit të formularëve përkatës të deklarimit, në varësi të rolit të personave të përfshirë në proceset e prokurimit.



7.1.2. Verifikimi ex post në fushën e ankandeve publike, koncesioneve dhe prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë

Në zbatim të detyrave që i ngarkon legjislacioni respektiv, në fushën e ankandeve publike, koncesioneve dhe prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, si institucion monitorues, APP gjatë vitit 2022, ka ndërmarrë një sërë masash dhe veprimtarish, si për ngritjen e kapaciteteve administrative monitoruese në këto fusha, ashtu edhe për krijimin e praktikave dhe proceseve të punës, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Me riorganizimin dhe strukturën e re institucionale, në muajin mars të këtij viti, është krijuar një sektor i posaçëm monitorimi, për procedurat në fushat e sipërcituara, dhe janë ndërmarrë procedurat rekrutuese për plotësimin e vendeve vakante, ku në muajin gusht, sektori u plotësua me një Përgjegjës dhe një Inspektor, dhe pritet ende zhvillimi i konkursit për vendin vakant të një inspektori.

Menjëherë, me krijimin e sektorit, puna vijoi me proceset verifikuese, ku fillimisht u fokusua në fushën e ankandeve publike, duke iniciuar në muajin qershor një komunikim shkresor me të gjitha institucionet që kanë vepruar si Autoritet Shitës në vitin paraardhës, 2021 (77 të tilla), për mbledhjen e informacionit mbi ecurinë e veprimtarive të ankandeve të realizuara prej tyre, si dhe detyrimin ligjor për raportim periodik 6 mujor, pranë APP.

Me mbledhjen e këtij informacioni synohej një analizë e ecurisë së procesit, për të vlerësuar kryerjen e një monitorimi më të thelluar në verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të ankandeve që janë finalizuar me kontratë, me synim evidentimin e problematikave si në kryerjen e procesit, ashtu edhe në aspektin legjislativ, si dhe nxjerrjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës në këtë fushë.

Nga informacioni i administruar, rezultoi se gjatë vitit 2021 janë zhvilluar 336 procedura ankandi në total, nga të cilat vetëm 122 janë finalizuar me nënshkrim kontrate.

Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion, u hartua plani i verifikimit për 8 procedura ankandi, i ndarë në dy faza, ku në Fazën e I-rë të planit u përfshinë 4 subjekte autoritete shitëse. Në përzgjedhjen e autoriteteve shitëse u morën në konsideratë ato, të cilat kanë zhvilluar të paktën 2 procedura ankandi gjatë vitit 2021, të finalizuara me nënshkrim kontrate. Ndërsa, përzgjedhja e procedurave u bazua në kriteret e mëposhtme:

- llojin e procedurës së përdorur;
- vlerën fillestare të ankandit;
- objektin e ankandit;
- vlerën e fituar.

Sa i përket Fazës I-rë të planit, është përfunduar hetimi administrativ për 2 procedura, për të cilat është konkluduar me dhënien e masave administrative në mbështetje të nenit 7, pika 2/c të LAP, për shkak të konstatimit të shkeljeve/mangësive dhe veprimeve apo mosveprimeve të autoriteteve shitëse në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit të ankandit publik, si dhe për 2 procedurat e tjera hetimi administrativ është në proces.

Të dhënat statistikore mbi masat administrative të vendosura nga APP, në përfundim të hetimit administrativ, paraqiten në vijim:



Tabela 67

Gjobë	Propozim për masë disiplinore
për 3 punonjës në Autoritetin Shitës, subjekt verifikimi	për 3 punonjës në Autoritetin Shitës, subjekt verifikimi

Nisur nga roli i personit në procedurën e prokurimit të verifikuar, të dhënat sipas numrit të autoriteteve shitëse:

Tabela 68

Penalizime me gjobë	
Roli i zyrtarit	Numri
Anëtar i njësisë së ankandit	1 Autoritet Shitës

Tabela 69

Propozim për masë disiplinore	
Roli i zyrtarit	Numri
Anëtar i njësisë së ankandit	1 Autoritet Shitës

- **Në fushën e verifikimit të ligjshmërisë së prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë**, si një ndër kompetencat që i ngarkon ligji 36/2020, APP gjatë vitit 2022, ka marrë një sërë veprimesh si për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve administrative, ashtu edhe krijimin e proceseve të punës sipas kërkesave të legjislacionit të fushës në fuqi.

Duke qenë se, veprimtaria e APP, është e lidhur me trajtimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, në kuadër të implementimit të sistemit për ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e informacionit të klasifikuar, me të cilin punonjësit e APP do të njihen gjatë përbushjes së detyrave funksionale, janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), si rezultat i të cilave, është konkluduar:

- *DSIK-së i është paraqitur kërkesa për të pajisur Titullarin e institucionit, me Autorizim nga Kryeministri për të bërë klasifikimin origjinal “Sekret shtetëror”, të informacioneve që prodhon APP.*
- *Në muajin Tetor 2022, Kryeministri ka autorizuar Titullarin e APP, për të bërë klasifikimin origjinal “Sekret shtetëror”, të informacioneve që prodhon institucioni.*
- *Në vijim të këtij procesi, me urdhrin nr. 100, datë 18.10.2022 është krijuar Komisioni për Klasifikimin e Informacionit “Sekret shtetëror” në APP.*
- *Në funksion të përcaktimit në mënyrë sa më të qartë dhe shteruese të detyrave të Oficerit të Sigurisë, u miratua urdhri nr. 99, datë 18.10.2022 “Për caktimin e Oficerit të Sigurisë në Agjencinë e Prokurimit Publik”, strukturë, e cila është krijuar me urdhrin nr. 9168 prot., datë 24.05.2019 “Për ushtrimin e detyrave”.*
- *Më pas, u konsultua dhe u dakordësua me nëpunësit e DSIK projektlista e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror”, me nivelin përkatës të klasifikimit, si dhe afatin e ruajtjes së klasifikimit.*



- Me Vendimin nr. 1, datë 21.11.2022 “Për listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” në Agjencinë e Prokurimit Publik”, komisioni miratoi listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror”, që do të prodhojë institucioni gjatë veprimtarisë së tij, i cili i është përcjellë DSIK-së.
- Me urdhrin nr. 110, datë 16.12.2022 “Për përcaktimin e funksioneve që duhet të pajisen me “Certifikatën e Sigurimit të Personelit”, për njohje me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, në Agjencinë e Prokurimit Publik”, u miratua lista e funksioneve organike që për shkak të detyrave zyrtare, do të njihen me informacionin e klasifikuar. i cili i është përcjellë DSIK-së.
- Brenda datës 30 Dhjetor, nga nëpunësit e APP, sipas funksioneve të miratuara, u plotësua dokumentacioni i përcaktuar në nenin 10, të VKM nr. 188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, për pajisje me CSP, dhe aktualisht i është përcjellë kërkesa DSIK.

Në këtë kuadër, me plotësimin e sektorit dhe forcimin e kapaciteteve administrative të tij, nëpërmjet ndjekjes së trajnimeve në fushat respektive të veprimtarisë, si dhe pajisjen e punonjësve me SCP, synohet që në vitin 2023 në fokus të procesit të verifikimit të jenë procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, si dhe ato koncesionare.

7.2. MONITORIMI I KONTRATAVE

7.2.1. Hartimi i akteve të nevojshme për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë procesit të monitorimit të kontratave

Me synim përmirësimin dhe lehtësimin e punës së autoriteteve kontraktore për raportimin e ecurisë së zbatimit të kontratës, APP hartoi Udhëzimin nr.2, datë 18.03.2022, “Mbi raportimin e zbatimit të kontratës”, dhe Formularin Standard të Raportimit, në zbatim të parashikimeve të nenit 125, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Hartimi i këtij udhëzimi ka si qëllim, t’ju vijë në ndihmë autoriteteve kontraktore për raportimin e ecurisë së zbatimit të kontratës së nënshkruar. Autoritetet/entet kontraktore duhet të raportojnë sipas formularit standard të miratuar me udhëzimin e sipërcituar, sa herë evidentojnë situata dhe problematika të ndryshme, që ndikojnë në zbatimin e kontratës sipas termave dhe kushteve të saj, apo sipas kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe në legjislacionin në fuqi, si dhe në përfundim të kontratës së lidhur, për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.

7.2.2. Të dhëna mbi numrin e kontratave/marrëveshjeve kuadër të nënshkruara, në përfundim të procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022

Referuar të dhënave të Sistemit të Prokurimit Elektronik, rezulton se gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, janë nënshkruar në total **3992 kontrata/marrëveshje kuadër**. Numri i kontratave të nënshkruara, të ndara sipas tipit të kontratës (shërbim, mall, punë), rezulton si më poshtë:

- **2068** janë kontrata/marrëveshje kuadër të tipit *Mallra*.
- **1092** janë kontrata/ marrëveshje kuadër të tipit *Shërbime*.
- **832** janë kontrata/ marrëveshje kuadër të tipit *Punë publike*.



7.2.3. Të dhëna mbi raportimin e planeve të zbatimit të kontratave nga autoritetet kontraktore.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, janë administruar në formë elektronike ose/dhe shkresore, **3659** plane të zbatimit të kontratave të nënshkuara, nga **352** autoritete kontraktore. Referuar të dhënave të paraqitura nga AK në formularët përkatës, rezultojnë se nga 3659 plane zbatimi të regjistruara gjatë kësaj periudhe, **638** janë plane zbatimi për **minikontrata** (kontrata bazuar në një marrëveshje kuadër) dhe **445** plane zbatimi janë për **kontrata prokurimi me vlerë të vogël**.

Nga numri total prej 3659 planesh zbatimi, të dërguara nga autoritetet kontraktore, rezultojnë se:

- **3438** janë plane të zbatimit, për kontrata të lidhura gjatë **vitit 2022**, nga të cilat **596** janë për **minikontrata** dhe **473** janë për **kontrata prokurimi me vlerë të vogël**;
- **147** janë plane të zbatimit, për kontrata të lidhura **gjatë vitit 2021**, nga të cilat **26** janë për **minikontrata** dhe **13** janë për **kontrata prokurimi me vlerë të vogël**;
- **3** janë plane zbatimi për kontrata të lidhura gjatë vitit **2020**, nga të cilat **2** janë për **minikontrata**;
- **71** plane zbatimi (**14** prej të cilave janë për **minikontrata** dhe **5** janë për **kontrata prokurimi me vlerë të vogël**) nuk jepet si e dhënë në formular **data e lidhjes së kontratës**.

Ndërkohë, duke marrë në konsideratë faktin që autoritetet kontraktore në shumë raste nuk plotësojnë të dhënat e duhura (nëse kontrata është e lidhur në bazë të një marrëveshjeje kuadër, ose dërgojnë plane të zbatimit të kontratës edhe për kontrata të lidhura në përfundim të një procedure blerjeje e vogël, duke mos evidentuar këtë fakt në formularin përkatës), të dhënat e sipërcituara mund të ndryshojnë.

Nisur nga numri total i kontratave të nënshkuara në përfundim të procedurave të prokurimit mbi kufirin e prokurimeve me vlerë të vogël, për periudhën Janar-Dhjetor 2022, konkretisht 3992 kontrata/marrëveshje kuadër, rezultojnë se nga APP janë administruar për këtë periudhë, 2965 plane zbatimi për kontrata të lidhura gjatë këtij viti, që është në nivelin 74.3 % të kontratave të nënshkuara. Për kontratat e lidhura gjatë periudhës së fund-vitit, kryesisht gjatë muajit Dhjetor, AK vijojnë të dërgojnë planet e zbatimit edhe gjatë muajit Janar 2023 e në vijim.

Gjithashtu, vlen të theksohet fakti që gjatë periudhës 18.07.2022 – 04.08.2022, si pasojë e sulmit kibernetik mbi tërësinë e sistemeve elektronike shtetërore, është ndërprerë komunikimi elektronik i adresës elektronike: monitorimi.kontratat@app.gov.al. Për rrjedhojë, nuk janë administruar planet e zbatimit të kontratës, apo raportime të tjera të dërguara elektronikisht nga autoritetet kontraktore gjatë kësaj periudhe, duke mos evidentuar dot numrin e saktë të AK e të planeve të dërguara prej tyre. Duke marrë në konsideratë këtë fakt, rezultojnë se përqindja e numrit të planeve të zbatimit të kontratave dhe autoriteteve kontraktore është edhe më e madhe se 74.3 % e kontratave të nënshkuara.

Plane zbatimi të grupuara sipas tipit të kontratës.

Numri i planeve të zbatimit të kontratës, të administruara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, i ndarë sipas tipit të kontratës (shërbim, mall, punë), rezultojnë si më poshtë:


- **2002** janë plane zbatimi për kontrata/marrëveshje kuadër të tipit *Mallra*.
- **1166** janë plane zbatimi për kontrata/ marrëveshje kuadër të tipit *Shërbime*.
- **489** janë plane zbatimi për kontrata/ marrëveshje kuadër të tipit *Punë publike*.
- **2** plane zbatimi nuk kanë të përcaktuar tipin e kontratës dhe objektin.



Të dhënat e mësipërme, në formë grafike paraqiten si më poshtë:

Grafiku 41

NUMRI I PLANEVE TË ZBATIMIT SIPAS TIPIT TË KONTRATËS



Plane zbatimi të grupuara sipas llojit të AK

Ndërkohë, numri i planeve të zbatimit të kontratës, të ndara sipas tipologjisë së institucioneve që kanë dërguar këto plane zbatimi, rezulton si më poshtë:

- **1594** janë plane zbatimi për kontrata të lidhura nga institucione të nivelit **qendror**;
- **1179** janë plane zbatimi për kontrata të lidhura nga institucione të nivelit **vendor**;
- **517** janë plane zbatimi për kontrata të lidhura nga institucione **të pavarura**;
- **361** janë plane zbatimi për kontrata të lidhur nga **shoqëri anonime**;
- **8** janë plane zbatimi për kontrata të lidhura nga institucione **të tjera**.

Plane zbatimi të grupuara sipas muajit të dërgimit


Gjithashtu, numri i planeve të zbatimit të kontratës, të administruara për periudhën Janar-Dhjetor 2022, i ndarë sipas muajve, paraqitet si më poshtë:

- **82** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Janar**;
- **234** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Shkurt**;
- **292** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Mars**;
- **327** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Prill**;
- **165** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Maj**;
- **349** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Qershor**;
- **198** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Korrik**;
- **353** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Gusht**;
- **347** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Shtator**;
- **409** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Tetor**;
- **459** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Nëntor**;
- **444** plane zbatimi kontrate janë dërguar në muajin **Dhjetor**;



Të dhënat e mësipërme, paraqiten sipas grafikut të mëposhtëm:

Grafiku 42



Nga shqyrtim i këtij grafiku rezulton se brenda vitit 2022, në muajin **Nëntor** rezulton numri më i lartë i planeve të zbatimit të kontratës, respektivisht **459 plane zbatimi**, ndërsa gjatë muajit **Janar** rezulton numri më i ulët, konkretisht **82 plane zbatimi**.

APP ka regjistruar të dhënat e 3659 planeve të zbatimit të kontratës, të dërguara pranë institucionit.

APP ka komunikuar në vazhdimësi me autoritetet kontraktore për mangësitë e konstatuara në hartimin e planeve të zbatimit të kontratave, me qëllim ndërgjegjësimin dhe asistimin e tyre në këtë proces. Konkretisht, janë bërë rreth 563 komunikime në rrugë elektronike (me anë të e-mail-it zyrtar), ku u është kërkuar plotësimi i mangësive të evidentuara për çdo seksion respektiv të formularëve dhe janë asistuar sipas rasteve mbi mënyrën e plotësimit të planit të zbatimit të kontratës.

Gjithashtu, duke marrë shkas nga mangësitë e evidentuara në hartimin dhe dërgimin e planit të zbatimit të kontratës nga autoritetet kontraktore, APP, me njoftimin nr. 2638 Prot., datë 14.04.2022, ka sjellë në vëmendje të autoriteteve kontraktore plotësimin pa mangësi të formularit të planit të zbatimit të kontratës, si dhe respektimin e afateve ligjore në lidhje me hartimin dhe dërgimin e planit të zbatimit të kontratës.

Në vijimësi, duke qenë se janë konstatuar të njëjtat mangësi në hartimin e planeve të zbatimit, Sektori i Monitorimit të Kontratave hartoi Rekomandimin Nr. 6858 Prot., date 07.10.2022 “Mbi mënyrën e hartimit të formularëve të planit të zbatimit të kontratës”, drejtuar autoriteteve kontraktore.


Ndërgjegjësimi i AK-ve në lidhje me procesin e hartimit të planit të zbatimit të kontratës ka ardhur duke u rritur dhe vihet re një rritje e numrit të planeve të zbatimit të kontratës që dërgohen në APP.

Duke krahasuar të dhënat me vitin 2021, ku numri i kontratave/marrëveshjeve kuadër të lidhura ishte 4328, ndërkohë që numri i planeve të zbatimit të dërguara nga AK ishte 833 (që përbëjnë 19.2 % e kontratave/marrëveshjeve kuadër të lidhura), ndërsa për vitin 2022, numri i kontratave/marrëveshjeve kuadër të lidhura është 3992, ndërsa numri i planeve të zbatimit, për kontrata të lidhura përgjatë këtij viti, është 2965 (që përbëjnë 74.3 % e kontratave/marrëveshjeve kuadër të lidhura), rezulton se ka një rritje të konsiderueshme të numrit të planeve të zbatimit të kontratës, të dërguara nga AK për kontratat e lidhura gjatë vitit 2022.



Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhëna krahasimore në lidhje me numrin e planeve të zbatimit të kontratës të dërguara nga AK për vitin 2021 dhe vitin 2022.


Grafiku 43



Gjithashtu, nga 6 mujori i parë në 6 mujorin e dytë, numri i planeve të zbatimit të kontratës të administruara nga APP, ka ardhur duke u rritur. Krahasuar me 6 mujorin I të vitit 2022, ku numri i planeve të zbatimit të dërguara nga AK është 1449, në 6 mujorin II të këtij viti, numri i planeve të zbatimit të kontratës është 2210. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat krahasimore, në lidhje me planet e zbatimit të kontratës, të dërguara gjatë 6 mujorit I dhe II të vitit 2022.

Grafiku 44

NR. I PLANEVE TË ZBATIMIT TË KONTRATËS 6 MUJORIN I DHE II 2022



Hartimi i planit të zbatimit të kontratës ka një rol të rëndësishëm në procesin e ndjekjes së ecurisë së zbatimit të kontratës, për të siguruar mirë zbatimin e saj, sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, dhe për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. Plani i zbatimit të kontratës është dokumenti që ndihmon personat përgjegjës për monitorimin e kontratës për të ndjekur në mënyrë sistematike përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.



7.2.4. Të dhëna mbi korrektësinë e zbatimit të kontratave të raportuara nga AK-të nëpërmjet formularëve të raportimit, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022.


Autoritetet kontraktore dërgojnë në formë shkresore dhe/ose elektronike në adresën monitorimi.kontratat@app.gov.al, raportimet për ecurinë e zbatimit të kontratave të lidhura prej tyre, ku raportohet në formë të përmbledhur, sipas formularit standard të raportimit, sipas rasteve, nëse kontratat kanë përfunduar me sukses, apo nëse janë hasur problematika gjatë zbatimit të tyre, si edhe masat që janë marrë, për zgjidhjen e problematikave.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2022, janë administruar formularët e raportimit për zbatimin e **2622 kontratave**, të dërguara nga 246 autoritete kontraktore, prej të cilave:

- **1434** formularë raportimi janë për kontrata të lidhura **në vitin 2022**;
- **1101** formularë raportimi janë për kontrata të lidhura **në vitin 2021**;
- **84** formularë raportimi janë për kontrata të lidhura **në vitin 2020**;
- **3** formularë raportimi janë për kontrata të lidhura **në vitin 2019**;

Për sa më sipër, vihet re që raportimi i autoriteteve kontraktore është bërë edhe për kontrata të lidhura gjatë viteve 2019/2020, që është një tregues i punës ndërgjegjëse që ka bërë APP, për këtë proces.

Duke krahasuar të dhënat me periudhën Janar – Dhjetor 2021, ku numri i raporteve të dërguara është 1619, rezulton se ka një rritje të numrit të formularëve të raportimit për zbatimin e kontratës, të dërguara nga AK në periudhën Janar – Dhjetor 2022. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhëna krahasimore në lidhje me raportimin e AK për periudhën Janar-Dhjetor 2021 dhe Janar-Dhjetor 2022.



Nga totali i 2622 kontratave/MK të raportuara në periudhën Janar – Dhjetor 2022, rezulton se:

- 1751 kontrata, ose afërsisht 66.8% e kontratave të raportuara, janë kontrata/MK të tipit Mall;
- 502 kontrata, ose afërsisht 19.1% e kontratave të raportuara, janë kontrata/MK të tipit Shërbim;
- 369 kontrata, ose afërsisht 14.1% e kontratave të raportuara, janë kontrata/MK të tipit Punë.

Në Tabelën dhe Grafikun e mëposhtëm, paraqiten të dhënat në lidhje me numrin e kontratave/MK të raportuara për periudhën Janar- Dhjetor 2022, të ndara sipas tipit të kontratës (shërbim/mall/punë).




Tabela 70

KONTRATAT/MK TË RAPORTUARA NGA AUTORITETET KONTRAKTORE SIPAS TIPIT TË KONTRATAVE/MK, PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2022		
TIPI I KONTRATËS/MK	NUMRI I KONTRATAVE/MK TË RAPORTUARA	NUMRI NË (%) I KONTRATAVE/MK TË RAPORTUARA
MALLRA	1751	66.8 %
SHËRBIME	502	19.1%
PUNË PUBLIKE	369	14.1 %
TOTALI	2622	100%

Grafiku 46

KONTRATA TË RAPORTUARA NGA AK PËR VITIN 2022, SIPAS TIPIT TË KONTRATËS



Nga totali i 2622 kontratave të raportuara, rezultojnë sipas të dhënave të paraqitura në formularët përkatës:

- 928 prej tyre janë raporte për minikontrata (kontrata bazuar në një marrëveshje kuadër).
- 1694 prej tyre janë për kontrata, nga të cilat 187 janë për kontrata me blerje të vogël.

Të dhënat e raportuara në 2622 formularët e raportimit për zbatimin e kontratës të dërguara pranë APP, janë regjistruar nga ana e Sektorit të Monitorimit të Kontratave.



Gjithashtu, Sektori i Monitorimit të Kontratave ka komunikuar në vazhdimësi me autoritetet kontraktore për mangësitë e konstatuara në raportet e zbatimit të kontratave, rreth 475 komunikime me e-mail dhe 37 me shkresa zyrtare, ku është kërkuar informacion shtesë mbi ecurinë e zbatimit të kontratave, plotësimin e mangësive respektive të formularëve, ridërgimin e tyre pas likujdimit të plotë të detyrimit financiar, si dhe duke sjellë në vëmendje të autoriteteteve kontraktore respektimin e detyrimeve ligjore në lidhje me zbatimin e kontratave, sipas kushteve me të cilat janë prokuruar.

Në vijimësi, duke qenë se janë përsëritur të njëjtat mangësi dhe problematika, në hartimin e formularëve të raportimit për zbatimin e kontratës, Sektori i Monitorimit të Kontratave hartoi Rekomandimin Nr.6818 Prot., date 06.10.2022, "Mbi mënyrën e hartimit të raportimit të zbatimit të kontratave", drejtuar autoriteteteve/enteve kontraktore, me qëllim shmangien e mangësive dhe problematikave të evidentuara gjatë raportimeve të dërguara.

Gjithashtu, Sektori i Monitorimit të Kontratave ka verifikuar numrin e raporteve për zbatimin e kontratës, të dërguara nga autoritetet kontraktore, për kontratat e lidhura prej tyre, gjatë 6 mujorit II të vitit 2021, të cilat kanë të përcaktuar në SPE datën e lidhjes dhe afatin e zbatimit dhe afati i të cilave ka përfunduar deri më 28.02.2022, ku rezultoi një numër i konsiderueshëm i kontratave për të cilat autoritetet/entet kontraktore nuk kanë raportuar pranë APP mbi zbatimin e tyre. Për sa më sipër, Sektori i Monitorimit të Kontratave hartoi një metodologji sipas të cilës përgatiti një Plan Monitorimi, për 27 autoritete kontraktore.

7.2.5. Problematika të evidentuara nga AK gjatë zbatimit të kontratave nga analizimi i formularëve standardë të raportimit të ecurisë së zbatimit të kontratave.

Nga analizimi i të dhënave të formularëve standardë të raportimit të zbatimit të kontratave, të administruar në APP, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, rezulton se janë raportuar problematika për 113 kontrata, gjatë zbatimit të tyre. Nisur nga numri total prej 2622 raportimeve për zbatimin e kontratës, të dërguara pranë APP, rezulton se rreth 4.3 % e kontratave të raportuara kanë patur problematika gjatë zbatimit të kontratës.

Konkretisht:

- Në **40 kontrata**, ose për 1.53 % të kontratave të raportuara, AK kanë aplikuar penalitete ndaj kontraktorëve përkatës, nga të cilat:
 - në 33 raste, penalitetet janë aplikuar për shkak të mosrespektimit të afatit të zbatimit të kontratës,
 - në 4 raste, janë aplikuar pasi mallrat nuk përmbushnin specifikimet teknike, si dhe punimet nuk janë realizuar sipas kushteve të prokuruar,
 - në 3 raste, janë aplikuar për mosrealizim të plotë të kontratës apo shkelje të kushteve të tjera të kontratës.
- Për **30 kontrata**, ose për 1.14 % të kontratave të raportuara, AK kanë raportuar pezullim punimësh, për shkak rishikimi apo saktësimi të projektit, problematika që lidhen me lirimin e sheshit të ndërtimit, apo marrjen e lejeve të nevojshme për ecurinë e punimeve objekt kontrate, apo problematikave që ndikonin në realizimin e kontratës.
- Për **11 kontrata**, ose për 0.42 % të kontratave të raportuara, është raportuar mos përmbushje e detyrimeve kontraktuale, ku në 7 raste raportohet **njëkohësisht** edhe ndërprerja e kontratës. Në rastet që AK nuk kanë raportuar për paraqitjen e kërkesës për përjashtimin e OE, Sektori i Monitorimit të Kontratave ka sjellë në vëmendje të AK parashikimet ligjore.
- Për **16 kontrata**, ose për 0.61 % të kontratave të raportuara, është raportuar ndërprerje e kontratës, apo përfundimi i kontratës përpara afatit të parashikuar, për arsye të ndryshimit të nevojave të AK / për shkak se zbatimi i kontratës është bërë i pamundur / për shkak të paaftësisë paguese të AK, apo shkurtimit të fondeve / për shkak të rritjes së çmimit të karburantit, sasitë e parashikuara janë ezauruar përpara afatit të kontratës.



- Për **11 kontrata**, ose për 0.42 % të kontratave të raportuara, janë raportuar për problematika në zbatimin e projektit, apo pasaktësi në projekt, të cilat janë zgjidhur nëpërmjet rishikimit të projektit, apo mospërputhje me specifikimet teknike ku në vijim është bërë korigjimi i tyre
- Për **5 kontrata**, ose për 0.19 % të kontratave të raportuara, janë raportuar mungesa fondesh, apo vonesa në likuidimin e detyrimit financiar, për shkak të bllokimit të fondeve.

Ndërkohë, nga shqyrtimi i të dhënave të raportuara nga AK mbi datën e shlyerjes së plotë të detyrimit financiar dhe parashikimin në kontratë për afatin e shlyerjes (për rastet kur këto të dhëna janë plotësuar nga AK), referuar raportimeve që janë bërë sipas formularit të ri standard të raportimit, të miratuar me Udhëzimin e APP Nr. 2, datë 18.03.2022 “Mbi raportimin e zbatimit të kontratës”, në të cilin është përfshirë seksioni i parashikimit të kontratës për shlyerjen e detyrimit financiar, rezulton se në rreth **4.4 %** të kontratave të raportuara ka patur vonesa në shlyerjen e detyrimeve financiare nga AK. Kjo problematikë, është trajtuar edhe në Rekomandimin Nr.6818 Prot., datë 06.10.2022, “Mbi mënyrën e hartimit të raportimit të zbatimit të kontratave”, drejtuar autoriteteve/enteve kontraktore.

7.2.6. Modifikimet e kontratave

Referuar të dhënave në SPE, të dërguara nga Sektori Menaxhimit të Bazës së të Dhënave, pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Bazës së të Dhënave dhe Publikimit, rezulton se gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, **16** autoritete kontraktore kanë pasqyruar si zë në regjistrin e parashikimeve modifikimin e **22 kontratave**, përsa i përket vlerës së tyre, që përbëjnë 0.55% të kontratave të lidhura gjatë vitit 2022.

Sipas tipit të kontratës së modifikuar, rezulton se:

- 9 modifikime janë për kontrata të tipit “Shërbim”;
- 8 modifikime janë për kontrata të tipit “Punë”.
- 5 modifikime janë për kontrata të tipit “Mall”;

Gjithashtu, APP është njoftuar edhe për **5 modifikime** të tjera të kontratës, përsa i përket vlerës së tyre, të kryera nga 3 autoritete kontraktore, të cilat nuk rezultojnë të pasqyruara si zë regjistri në SPE. Në lidhje me këto njoftime, Sektori i Monitorimit të Kontratave, në bashkëpunim me Sektorin e Publikimit, pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Bazës së të Dhënave dhe Publikimit, ka përgatitur shkresat përkatëse, ku sjell në vëmendje të AK parashikimet ligjore në rastin e modifikimit të kontratës.

Ndërkohë, nga formularët e raportimit për zbatimin e kontratës, që janë dërguar nga autoritetet kontraktore, të shqyrtuara gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, rezulton se **për 144 kontrata**, ose përafërsisht **5.5 %** e kontratave të raportuara, AK kanë bërë shtyrje të afatit të zbatimit të kontratës. Autoritetet kontraktore kanë sqaruar se shtyrja e afatit të zbatimit të kontratës, kryesisht ka ardhur si pasojë e pandemisë Covid-19, kushteve të këqija atmosferike, vonesa në transportin ndërkombëtar për shkak të forcës madhore, ndryshimeve në projekt, mos lirimit të sheshit të ndërtimit, punimeve të paparashikuara, apo kushteve të tjera që kanë penguar realizimin në kohë të kontratës.

Gjithashtu, referuar formularëve të raportuar, rezulton se për **9 kontrata**, AK kanë bërë modifikim të çmimit të kontratës, ku në një rast modifikimi ka ardhur si pasojë e rritjes së indeksit të inflacionit, dhe 8 modifikimet e tjera kanë ardhur si pasojë e hyrjes në fuqi të një akti nënligjor që ndikonte kushtet e kontratës (ndryshimi i pagës minimale, si dhe çmimit të karburantit).



Ndërsa, për 8 kontrata, AK kanë raportuar modifikim të kontratës përse i përket ndryshimit të zërave apo volumeve të punimeve, apo përmirësime në projekt, por që nuk kanë sjellë ndryshim të vlerës së kontratës, si dhe për 1 kontratë, raportohet modifikim i sasive të artikujve, pa ndryshim të vlerës së përgjithshme të kontratës.

Së fundmi, për 8 kontrata, AK kanë raportuar modifikime të tjera, që lidhen me ndryshimin e drejtuesit teknik të projektit, ndryshim të personave përgjegjës për ndjekjen e kontratës, ndryshimi i emrit të AK pas rithemelimit së shoqërisë aksionare, si dhe për **1 kontratë** ka patur ndryshim të specifikimeve teknike të mallit që është dorëzuar në kushte më të favorshme se ato të prokuruar.

Në total, referuar raportimeve të dërguara nga AK dhe të dhënave në SPE, rezulton që numri i kontratave të modifikuara është 198, që përbëjnë rreth 4.96% të kontratave të lidhura për vitin 2022.

Raportimi i ecurisë së zbatimit të kontratave nga ana e autoriteteve kontraktore është një proces i rëndësishëm dhe luan rol në ndërgjegjësimin e autoriteteve kontraktore për ndjekjen me rigorozitet të zbatimit të kontratave të lidhura prej tyre, sipas kushteve të prokuruar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7.2.7. Trajtimi i raporteve përfundimtare për ecurinë e zbatimit të kontratës, të dërguara nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara për periudhën Janar – Dhjetor 2022, ka dërguar pranë institucionit tonë 14 raporte përfundimtare për korrektësinë e zbatimit të kontratës, për kontratat e lidhura bazuar në marrëveshjet kuadër, nga 14 autoritete kontraktore.

Në raportimet e dërguara, kjo agjenci ka përcjellë problematikat dhe rekomandimet e lëna, gjatë zbatimit të kontratave të lidhura nga këto AK.

Përse i përket, rekomandimeve të lëna nga grupi i monitorimit të Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, Sektori i Monitorimit të Kontratave **ka sjellë në vëmendje të 5 AK-ve** nëpërmjet shkresave zyrtare, të mbajnë në konsideratë rekomandimet e grupit të monitorimit gjatë zbatimit të kontratës.

Ndërkohë, në lidhje me problematikat dhe shkeljet e konstatuara nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, të paraqitura në 9 raporte monitorimi, APP ka filluar hetimin administrativ, duke kërkuar nga autoritetet kontraktore dërgimin e kundërshtimeve në lidhje me shkeljet e konstatuara.

Në përfundim të hetimit administrativ, për 5 autoritete kontraktore, APP ka vendosur të propozojë **marrjen e masave disiplinore** ndaj personave përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave objekt hetimi. Ndërkohë, **për 4 autoritete kontraktore**, APP ka vendosur **mbylljen e hetimit administrativ**.

7.2.8. Hartimi i Planit të Monitorimit të Kontratave

Në zbatim të objektivave të APP, të lidhura ngushtë me ndërgjegjësimin e AK në përmbushjen e detyrimeve ligjore, APP ndjek nëpërmjet formularëve të raportimit për zbatimin e kontratës, ecurinë e zbatimit të kontratave të lidhura nga AK.

APP ka monitoruar këtë proces nëpërmjet Planit të Monitorimit Nr. 2772 prot., datë 21.04.2022, qëllimi i të cilit është verifikimi i hartimit të raporteve të zbatimit të kontratave që janë lidhur nga autoritete të ndryshme kontraktore, gjatë 6 mujorit të dytë të vitit 2021, afati i të cilave ka përfunduar deri më 28.02.2022.

Për zbatim të këtij plani monitorimi, është miratuar Urdhri i Brendshëm Nr. 63, datë 21.04.2022, për kryerjen e monitorimit të hartimit dhe dërgimit të raportit për zbatimin e kontratave, nga 27 autoritete kontraktore.



Hetimi administrativ, në bazë të këtij plani monitorimi, ka përfunduar për 27 autoritete kontraktore, ku janë marrë vendimet përkatëse. Konkretisht, **për 11 AK** është vendosur të **propozohet marrja e masave disiplinore** ndaj personave përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave, pasi janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore që lidhen me dërgimin e formularëve të raportimit të zbatimit të kontratës. Ndërsa, **për 16 AK**, është mbyllur hetimi administrativ, duke u tërhequr vëmendjen e autoriteteve kontraktore për dërgimin e formularëve të raportimit për zbatimin e kontratës, brenda afateve ligjore. Vendimet sipas procedurës janë publikuar në faqen zyrtare të APP-së.

Gjithashtu, në përfundim të planit të monitorimit, në lidhje me mangësitë dhe problematikat e evidencuara në hartimin dhe dërgimin e raporteve për zbatimin e kontratës, si dhe mangësitë të evidencuara gjatë shqyrtimit të vazhdueshëm të raporteve të dërguara nga AK, APP hartoi Rekomandimin Nr.6818 Prot., date 06.10.2022, “Mbi mënyrën e hartimit të raportimit të zbatimit të kontratave”, i cili është publikuar në faqen zyrtare elektronike të APP.

Ndërkohë, APP ka hartuar Planin e Monitorimit Nr. 7628 Prot., datë 09.12.2022, me objekt “Monitorimi i zbatimit të kontratave të lidhura nga autoritete të ndryshme kontraktore (bazuar në marrëveshjet kuadër që janë nënshkruar gjatë periudhës 2020-2021 nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara (ish Agjencia e Blerjeve të Përqendruara)”. Në bazë të këtij plani monitorimi, është miratuar Urdhri Nr. 108, datë 09.12.2022, dhe ka nisur hetimi administrativ në lidhje me zbatimin e kontratave të lidhura nga 6 autoritete kontraktore. Hetimet administrative janë ende në proces.

7.2.9. Zhvillimi i takimeve informuese për çështje që lidhen me procesin e monitorimit të zbatimit të kontratave.

Në zbatim të objektivave të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020-2023, si dhe nisur nga analiza e bërë lidhur me dokumentacionin e dërguar nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, që lidhen me procesin e zbatimit të kontratave, ku janë konstatuar mangësi apo pasaktësi në plotësimin e të dhënave, APP organizoi takime informuese me njësitë e qeverisjes vendore, në datat 14 dhe 15 Qershor.

- Në takimet e zhvilluara u diskutuan çështje që lidhen ngushtësisht me përgjegjësitë dhe masat që duhet të marrin individët/grupet e punës, që caktohen nga titullari, për monitorimin e kontratave, duke u ndalur kryesisht në çështjet lidhur me:
- rëndësinë e hartimit të planit të zbatimit të kontratës dhe elementët e nevojshëm për hartimin e tij,
- ndjekjen e procesit të zbatimit të kontratës, bazuar në planin e zbatimit,
- modifikimet e kontratës gjatë zbatimit të tyre,
- administrimin e dokumentacionit të zbatimit të kontratës,
- raportimin në APP të ecurisë së zbatimit të kontratës.



8

PËRJASHTIMI I OPERATORËVE EKONOMIKË

Një ndër detyrat kryesore të APP, është edhe vlerësimi i rasteve për përjashtim të operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike, raste këto të evidentuara gjatë procesit të verifikimit apo shqyrtimit të raporteve të organeve të auditimit që kryen APP, ose si rezultat i propozimeve të autoriteteve kontraktore, operatorëve ekonomikë, organeve të tjera audituese në ushtrim të funksioneve të tyre, të cilët kërkojnë përjashtimin e operatorëve ekonomikë.

Gjatë vitit janë marrë në shqyrtim 112 raste për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, nga e drejta për të fituar kontrata publike.

Në formë tabelore, po i paraqesim si më poshtë:

Tabela 71

Rastet e shqyrtuara për përjashtimin e operatorëve ekonomikë	
Raste të evidentuara gjatë monitorimit të zbatimit të kontratës/verifikimit të zbatimit të procedurave, nga APP	5
Propozime të iniciuara nga Operatorët Ekonomikë	15
Propozime të iniciuara nga Autoritetet Kontraktore	77
Propozime të iniciuara nga Komisioni i Prokurimit Publik	3
Propozime të iniciuara nga KLSH/Inspektimi Financiar	9
Zbatim i vendimit të dhënë nga gjykata	3
TOTALI	112

Nga 112 rastet e propozuara për përjashtimin:

- **57 raste** referohen për keqinformim dhe paraqitje të dokumenteve me të dhëna të rreme sipas parashikimeve të nenit të **78/1/a të LPP**;
- **1 rast** referohet për keqinformim dhe paraqitje të dokumenteve me të dhëna të rreme, sipas parashikimeve të **nenit 7 të Ligjit për Ankandin Publik**;
- **54 raste** referohen për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale, sipas parashikimeve të **nenit 78/1/b të LPP**.

Në formë tabelore, po i paraqesim si më poshtë:

Tabela 72

Rastet e shqyrtuara për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, me bazë ligjore	
Propozime për keqinformim dhe paraqitje të dokumenteve me të dhëna të rreme	58
Propozime për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale	54
TOTALI	112



Nga rastet e shqyrtuara:

- ka nisur procedimi administrativ për **67** operatorë ekonomikë.
- kanë rezultuar të paplota ose pas verifikimeve të kryera ka rezultuar se, nuk kanë qenë kushtet e parashikuara nga dispozitat ligjore për nisjen e procedimit administrativ nga APP, **45** kërkesa.
-

Tabela 73

Vlerësimi i kërkesave për përjashtim	
Fillim procedimi administrativ	67 kërkesa
Mos nisje të procedimit administrativ	45 kërkesa

Vendimet e marra në përfundim të procedimeve administrative ndaj operatorëve ekonomikë

Në kuadër të procedimit administrativ ndaj operatorëve ekonomikë:

- është **marrë vendimi për përjashtimin** nga e drejta për të fituar kontrata publike, për **38** operatorë ekonomikë, sipas parashikimeve të nenit 78/1 të LPP.
- është vendosur **mos përjashtimi** për **13 operatorë ekonomikë** për shkak se, nuk plotësoheshin kushtet e parashikuara në nenin 78 të LPP.
- është vendosur **pezullimi i procedimit** për **11 operatorë ekonomikë**, për shkak të procesit gjyqësor.

Në formë tabelore, paraqesim të dhëna mbi vendimet e marra në përfundim të procedimeve administrative:

Tabela 74

Të dhënat mbi vendimet	
Vendime për përjashtim, për keqinformim për qëllime kualifikimi (neni 78/1/a i LPP)	12 operatorë ekonomikë
Vendime për përjashtim, për paraqitje të dokumenteve me të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi (neni 78/1/a i LPP)	6 operatorë ekonomikë
Vendime për përjashtim për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale (neni 78/1/b i LPP)	20 operatorë ekonomikë
Vendime për mos përjashtim, të mbështetura në parashikimet e nenit 78/1/a të Ligjit 162/2020	8 operatorë ekonomikë
Vendime për mos përjashtim, të mbështetura në parashikimet e nenit 78/1/b të Ligjit 162/2020	5 operatorë ekonomikë

- Vlen të përmendet se, në rastet e përjashtimit të operatorëve ekonomikë **në kushtet e keqinformimit për qëllime kualifikimi** është konstatuar:
- keqinformim, nëpërmjet paraqitjes në tender të deklaratës së gjendjes gjyqësore, ku shoqëria ka deklaruar se, nuk është dënuar për shkelje penale, ndërkohë që nga verifikimet e kryera ka rezultuar se ortaku/administratori kanë qenë të dënuar penalisht;
- keqinformim nëpërmjet paraqitjes së deklaratës se, nuk ka masë ligjore në fuqi, ndërkohë që



- nga raportimet e dërguara nga ISHPPSH ka rezultuar se ka patur gjobe ne fuqi;
- keqinformim në deklaratën e dhënë se, i ka të paangazhuara në kontrata të tjera, makineritë, më të cilat ka ofertuar, ndërkohë që nga verifikimet ka rezultuar se mjetet i ka patur të angazhuara.
 - keqinformim nëpërmjet paraqitjes së faturës tatimore për të provuar disponimin e një mjeti, ndërkohë që, ka rezultuar se fatura tatimore është i padeklaruar në organet tatimore.
 - keqinformim në deklaratën e dhënë për disponimin e sistemit të kartave të karburantit,
 - keqinformim në deklaratën e dhënë për stafin teknik.
- Si raste të **konstatimit të dokumenteve me të dhëna të rreme**, përmendim:
 - *certifikatat e formimit profesional të paraqitura për përmbushjen e kriterëve të veçanta për kualifikim, pas verifikimeve të kryera pranë organit lëshues, kanë rezultuar se nuk janë lëshuar prej saj.*
 - *certifikatat ISO të paraqitura në tender, pas verifikimeve të kryera pranë organit të vlerësimit të konformitetit kanë rezultuar se, nuk janë lëshuar prej tyre.*
 - *të dhënat në Vërtetimin e Performancës të paraqitur në tender, pas verifikimeve të kryera pranë organit kompetent kanë rezultuar se nuk janë të njëjta me të dhënat në Vërtetimin e lëshuar nga ky organ.*
 - *Vlen të përmendet edhe zbatimi i vendimit të dhënë nga Gjykata e Lartë, e cila me vendimin Nr. 00-2022- 347 i Vendimit (88), datë 28.2.2022, ka çmuar se, shoqëria paditëse ka përdorur një dokument të pavërtetë (i pranuar në të dy gjykimet që ka përmbajtje të pasaktë), dhe kjo përbën shkak të arsyeshëm dhe të mbështetur në ligj për t'a përjashtuar atë nga prokurimi publik.*
- Gjithashtu, APP ka vendosur ekzekutimin e Vendimit Penal Nr. 34, datë 26.05.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për dy operatore ekonomikë, të cilëve bazuar në nenet 8, 10 dhe 15 të Ligjit Nr. 9754, datë 14.06.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë", i është dhënë ndalimi pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit të fondeve publike, me institucione shtetërore, qendrore apo vendore, për një periudhë 2 (dy) vjet.*

Sa i takon rasteve të mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore rezulton se, ka patur 20 vendime për përjashtime të operatorëve ekonomikë.

Vendimet e përjashtimit të dhëna në këto raste, kanë qenë për mos përmbushje të detyrimeve kontraktore gjatë kontratave të nënshkruara kryesisht në përfundim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, por edhe për mos përmbushje të kontratave të nënshkruara pas zhvillimit të një procedure konkurruese prokurimi.

Gjithashtu, procedimet administrative të nisura nga APP janë në proces për 5 operatorë ekonomikë.

- Në mënyrë të përmbledhur, më poshtë paraqesim në formë tabelore, trajtimin e të gjitha kërkesave për përjashtim të operatorëve ekonomikë, nga e drejta për të fituar fonde publike, gjatë vitit 2022:



Tabela 75

Trajtimi i kërkesave për përjashtim, të shqyrtuara nga APP gjatë vitit 2022	
Vendimi	Numri
Vendime përjashtimi	38
Vendime mos përjashtimi	13
Procedime administrative të pezulluara	11
Procedime administrative në proces, për marrje vendimi	5
Kërkesa të paplota	45
TOTALI	112

Vlen të theksohet se, nga bashkëpunimi institucional dhe raportimi i ndërsjellët me AKU dhe ISHPSHSH, gjatë këtij viti, nga 10 (dhjetë) procedime administrative të nisura bazuar në raportimet dy palëshe, është konkluduar me :

- 7 (shtatë) vendime përjashtimi te operatorëve ekonomikë;
- 2 (dy) vendime mos përjashtimi;
- 1 procedim administrativ është pezulluar, për shkak se çështja është në Gjykatë.

Në vijim, gjatë vitit 2022, APP ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në funksion të zbatimit të parashikimeve të Kodit Zgjedhor, si dhe të LPP, në kuadër të mirë përdorimit të fondeve publike në procedurat e prokurimit publik.

Gjithashtu, ka pasur komunikim të vazhdueshëm dhe është hartuar një draft memorandum, i cili është në proces diskutimi me Ministrinë e Drejtësisë, Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit, në funksion të bashkëpunimit institucional për parandalimin dhe ndëshkimin e veprimeve abuzive dhe korrupsionit në procedurat e prokurimit publik dhe rritjen e integritetit të punonjësve që kryejnë këto procedura.



9

PËRFAQËSIMI I APP NË PROCESET GJYQËSORE

Gjatë këtij viti, APP është përfaqësuar në proceset gjyqësore si palë e paditur, nga zyrtarët e autoriteteve kontraktore të penalizuar në përfundim të procesit të verifikimit të ushtruar nga APP, si dhe nga operatorët ekonomikë, ndaj të cilëve është dhënë vendimi i përjashtimit nga e drejta për të fituar kontrata publike.

Tabela 76

Çështjet Gjyqësore të ndjekura nga APP sipas shkallës së gjyqimit	
Shkalla e gjyqimit	Numri
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	48
Çështje gjyqësore në rrethe	2
TOTALI	50

Tabela 77

Çështjet Gjyqësore të ndjekura nga APP në shkallë të parë, Tiranë, sipas llojit të kërkesë padisë	
Lloji i padisë	Numri
Kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë	18 ¹
Kundër aktit administrativ për nisjen e procedimit administrativ për përjashtim	2
Kundër vendimeve të APP për penalizim të zyrtarëve	27
Marrëdhënie pune	1
TOTALI	48

- Çështjet Gjyqësore kundër **vendimeve të dhëna nga APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë**

Po të marrim në analizë vendimet e dhëna nga APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë gjatë vitit (**38** vendime) rezulton se, **18 vendime** janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, përkatësisht nëpërmjet 23 kërkesë padive.

Pra, vetëm 47 % e vendimeve të dhëna nga APP janë ankimuar në Gjykatë.

Konkretisht sipas grafikut dhe tabelës:

¹ Vlen të theksohet se, në këtë numër nuk janë përfshirë edhe dy çështje gjyqësore që kanë vijuar nga viti 2021 si dhe nuk janë përfshirë rastet kur për të njëjtin vendim është ankimuar me shumë se një herë nga operatori ekonomik.



Grafiku 47




Tabela 78

Vendime përjashtimi	Kërkesë padi te ngritura në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë
38	23 ²

Nga këto 23 kërkesë padi, Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur, sipas të dhënave në tabelën më poshtë:


Tabela 79

Çështjet Gjyqësore kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë sipas vendimit të Gjykatës	
Vendimi i gjykatës	Numri
Rrëzuar kërkesë padia	8
Pranuar kërkesë padia	1
Pranim i pjesshëm i kërkesë padisë	5
Kthim padie	1
Pushim gjykimi	4
Në proces	4

Pra sikurse rezulton edhe nga grafiku më poshtë në 35% të rasteve është vendosur rrëzimi i kërkesë padisë, në 22% është vendosur pranim pjesërisht i padisë, dhe vetëm në 1.4 % është pranuar kërkesë padia. Po kështu në 1.4% është vendosur kthim padie dhe 18% të rasteve është vendosur pushimi i gjykimit nga Gjykata.

Grafiku 48

Vendimet e dhena nga Gjykata



² Për një vendim te APP për përjashtim kërkesë padia mund te jete ngritur 2 here, pasi Gjykata ka kthyer padinë apo ka pushuar çështjen



Nga 23 ankimime në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në 18 raste është kërkuar sigurim padie apo dhënie vendimi me ekzekutim të përkohshëm. Duhet theksuar se, **nga 18 ankimime** në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, këto të fundit kanë marrë në konsideratë kërkesë paditë për dhënien e masës së sigurimit të padisë ose dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm vetëm në **6 raste**.


Tabela 80

Pranim Kërkesë Padie për dhënie të masës së sigurimit të padisë/vendim me ekzekutim të përkohshëm	Rrëzim Kërkesë Padie për dhënie të masës së sigurimit të padisë/vendim me ekzekutim të përkohshëm
6	12

Pra, sikurse rezulton dhe nga tabela, në 67% të kërkesë padive të ngritura për dhënien e masës së sigurimit të padisë apo dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm Gjykata ka vendosur rrëzimin e këtyre kërkesave dhe vetëm në 33% ka vendosur pranimin e tyre.

Grafiku 49

Vendimet e dhena per sigurim padie dhe ekzekutim te perkohshem



- Rrëzim Kërkesë Padie për dhënie të masës së sigurimit të padisë/vendim me ekzekutim të përkohshëm
- Pranim kerkese padie perdhënie të masës së sigurimit të padisë/vendim me ekzekutim të përkohshëm

- Çështjet gjyqësore kundër vendimeve të dhëna nga APP, **për penalizim të zyrtarëve në Autoritete Kontraktore**

Nga çështjet gjyqësore kundër vendimeve të APP për penalizim të zyrtarëve, në përfundim të procesit të monitorimit apo të shqyrtimit të raporteve të auditimit, Gjykata ka vendosur:

Tabela 81


Çështjet Gjyqësore kundër vendimit të dënimit me gjobë, sipas vendimit të gjykatës	
Vendimi i gjykatës	Numri
Rrëzuar kërkesë padia	6
Kthim padie	1
Mospranim padie	2
Pushim çështje	1
Në proces	17
	27



Sikurse rezulton nga tabela, në kërkesë paditë e ngritura kundër vendimit të dhënë për penalizimin me gjobë të punonjësve të autoriteteve/enteve kontraktore, Gjykata ka vendosur në 63% të rasteve të rrëzojë kërkesë padinë, në 4% të kthejë padinë, 2.7% të rasteve të mos e pranojë padinë dhe në 1.4% të pushojë çështjen. Ndërkohë që, janë në proces 22% e çështjeve të nisura.

Grafiku 50

Vendimet e dhena nga Gjykata



■ Rrëzuar kërkesë padia ■ Kthim padie ■ Mospranim padie ■ Pushim çështje ■ Në proces

- Çështje Gjyqësore të mbyllura me vendim, në shkallë të parë

Gjatë këtij viti nga 48 çështje gjyqësore të ndjekura në shkallë të parë pranë Gjykatës Administrative Tiranë, kanë përfunduar me dhënien e vendimit nga Gjykata vetëm **27 çështje gjyqësore**, pasi 21 çështje janë ende në proces.

Tabela 82

Çështjet Gjyqësore të ndjekura në shkallë të parë pranë Gjykatës Administrative Tiranë	
Çështje gjyqësore	Numri
Të përfunduara me dhënie vendimi	27
Ne proces	21

Nga 27 procese gjyqësore të përfunduara me vendim nga Gjykata janë të ankimueshme 21 prej tyre, pasi 6 janë vendime janë të formës së prerë.

Në formë tabelore janë si më poshtë:

Tabela 83

Vendime të formës së prerë	Vendime të ankimueshme
6	21

Ndërkohë, nga 21 çështje, për të cilat vendimi ka qenë i ankimueshëm, nga vetë APP është ushtruar e drejta e ankimit për 10 prej tyre (si vendime që kanë pranuar kërkesë padinë duke shfuqizuar vendimin e APP apo duke ndryshuar masën e dënimit të dhënë për përjashtimin e operatorëve ekonomikë) pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.



Në gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, vazhdojnë të jenë të regjistruara dhe pritet gjykimi për rreth **85 çështje**, ku APP është cilësinë e palës së paditur /palës së tretë, apo edhe në cilësinë e palës paditëse (2 çështje).

Tabela 84

Çështje në Gjykatë Administrative të Apelit	
Gjithsej	85

Nga kjo Gjykatë gjatë këtij viti është depozituar **1 (një)** vendim i marrë, ku është vendosur lënia në fuqi e vendimit të dhënë nga Gjykata e Shkallës së parë për rrëzimin e kërkesë padisë.

Përveç çështjeve gjyqësore pranë gjykatave administrative, sikurse analizuar më sipër, APP është palë edhe në çështje të ngritura pranë Gjykatës së Lartë, duke përfshirë këtu edhe çështje, të mbartura nga vitet e kaluara.

Kështu, nga 26 çështje të mbartura nga vitet e kaluara, gjatë këtij viti nga kjo Gjykatë janë mbyllur 11 çështje, në të cilën APP ka qenë në cilësinë e palës së paditur, dhe aktualisht janë 15 çështje në proces.

Tabela 85

Çështje në Gjykatën e Lartë	
Gjithsej	15


Gjykata e Lartë në **këto 11 vendimmarrje** gjatë këtij viti ka vendosur:

Tabela 86

Vendimmarrja e Gjykatës së Lartë në çështjet e mbyllura gjatë vitit 2022	
Çështje gjyqësore	Numri
Mospranim rekursi të paraqitur nga APP/Avokatura Shtetit	4
Mospranim rekursi të paraqitur nga pala paditëse	4
Ndryshim i vendimit të dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit dhe rrëzimin e kërkesë-padisë	3



Grafiku 51



- Mospranim rekursi të paraqitur nga APP/Avokatura Shtetit
- Mospranim rekursi të paraqitur nga pala paditëse
- Ndryshim i vendimit të dhënë nga Gjykata Administrative e APelit dhe rrëzimin e kërkesë-padisë

- Vlen të theksohet se, në vijim të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 26.05.2022 “Për përcaktimin e rregullave për heqjen dorë nga rekursi të depozituara nga administrata shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, të pashqyrtuara nga Gjykata e Lartë, për disa çështje me natyrë civile dhe administrative”, APP ka komunikuar me Avokaturën e Shtetit për proceset gjyqësore, të përfaqësuara edhe nga ky institucion, për disa prej të cilave është ushtruar e drejta e rekursit në Gjykatën e Lartë.

Konkretisht, në mbështetje të këtij udhëzimi, APP në cilësinë e palës së paditur, ka dërguar për vlerësim pranë këtij institucioni, çështjet administrative për të cilat është ushtruar rekurs pranë Gjykatës së Lartë, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale dhe për të cilat gjykatat e apelit ose Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për rrëzimin e padisë.

APP mbetet në vlerësimin e këtij institucioni, nëse duhet të hiqet dorë nga çështjet sipas tabelës që i është dërguar, për të cilat është bërë rekurs pranë Gjykatës së Lartë, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.



TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR PUBLIKIMIN

APP kontrollon të gjithë zërat e regjistrave të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe miratojnë ose refuzojnë elementët në sistemin elektronik të prokurimit, verifikojnë të gjithë njoftimeve që dërgohen në sistem nga autoritetet kontraktore për publikim me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit dhe më pas kryen publikim e tyre, verifikojnë dhe publikojnë njoftimet për procedurat e prokurimit publik/procedurat konkurruese të koncesioneve/ppp/ ankandet të zhvilluara nga AK, si dhe verifikojnë dhe publikojnë në Buletinin e APP çdo informacion të nevojshëm, etj.

Një nga detyrat kryesore është përgatitja e Buletinit të Njoftimeve Publike në përputhje me LPP, VKM Nr. 176, date 29.03.2006 “Për Botimin e buletinit të njoftimeve Publike” dhe rregullat e prokurimit publik, i cili publikohet në faqen kryesore të internetit të APP.

Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur për publikim në total 179 Buletin të Njoftimeve Publike (nga të cilët 127 kanë qenë Buletin të Posaçëm në lidhje me procedurat e prokurimit publik për Rindërtimin), me një numër faqe në total prej 33.268 faqe ose mesatarisht 186 faqe për javë.

APP gjate ushtrimit te ketij funksioni kryen kryesisht keto detyra:

Kontrollon të dhënat e hedhura nga personat përgjegjës në regjistrin e parashikimeve dhe të realizimeve të prokurimit publik, miraton ose refuzon publikimin e tyre në sistemin elektronik të prokurimit.

Kontrollon te dhenat e hedhura në sistemin e prokurimit elektronik konform rregullave të prokurimit, dhe rregullave të koncesioneve, njoftimet e kontratave, njoftimet e fituesve, njoftimet e lidhjeve të kontratave të nënshkruara, njoftimet e anulimeve, njoftimet për korrigjim gabimesh për procedurat e prokurimit publik/procedurat konkurruese të koncesioneve/ppp të zhvilluara nga AK, miraton ose refuzon publikimin e tyre ne SPE.

- Publikon në Buletinin e Njoftimeve Publike konform rregullave të ankandit publik, njoftimet e kontratave, njoftimet e fituesit paraprak dhe nese ligji e parashikon, fituesin perfundimtar , njoftimet e lidhjeve të kontratave të nënshkruara, njoftimet e anulimeve, njoftimet për ndreqje gabimesh të procedurave të ankandeve publike të zhvilluara nga AK.
- Publikon në Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimet e procedurave të lejeve minerare të realizuara nga AK.
- Publikon në Buletinin e Njoftimeve Publike, sipas parashikimeve të VKM. 176/2006, çdo njoftim për vend pune apo njoftim tjetër të kërkuar nga AK.
- Publikon në Buletinin e Njoftimeve Publike listën e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në prokurimin publik, nga koncesionet/partneriteti publik privat apo nga pjesëmarrja në ankandet publike, si dhe arsyet e këtij përjashtimi, në bazë LPP-së, nenit 7/d të ligjit për ankandin publik dhe nenit 11/b të ligjit 125/2013 “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar.
- Publikon ne Sistemin e Prokurimit Elektronik çdo informacion apo njoftim në përputhje me LPP, rregullat e prokurimit publik, si dhe me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.176, datë 29.03.2006 “Për botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike”, si dhe ligje të tjera.
- Përgatit dhe dërgon Buletinin e Njoftimeve Publike për t’u publikuar në portalin e APP.
- Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga drejtori i drejtorisë apo Drejtori i Përgjithshëm, me qëllim përmbushjen e objektivave.




- U jep suport telefonik ose verbal, përdoruesve të sistemit të prokurimit elektronik në lidhje me krijimin e procedurave dhe njoftimet e kontratave, njoftim fituesve, njoftime lidhjeve të kontratave të nënshkruara, njoftim anulimeve etj.
- Raporton në lidhje me njoftimet e procedurat të prokurimit të krijuara në sistem nga autoritetet kontraktore nëse konstatohen parregullsi.
- Përfaqëson institucionin sipas nevojave.

10.1. Publikimi i njoftimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik

Gjatë vitit 2022 janë verifikuar dhe publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe më pas në Buletinin e Njoftimeve Publike të rradhës:

- **6494** Njoftime Kontratash të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit;
- **4321** Njoftime Fituesi të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit, pa përfshirë procedurat e rindërtimit, për të cilat faza e dytë nuk zhvillohet në sistem;
- **3855** Njoftime Kontratash të Nënshkruara, për procedura të kryera në Sistemin e Prokurimit Elektronik, pa përfshirë procedurat e rindërtimit, për të cilat faza e dytë nuk zhvillohet në sistem;
- **157** Njoftim fituesi për procedurat me negociim pa shpallje paraprake,
- **1815** Njoftime Anullimi të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit.
- **145** Njoftime Kontratash në kuadër të rindërtimit, të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit;
- **16** Njoftime Anullimi për procedurat në kuadër të rindërtimit, të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave

Grafiku 52






APP ka trajtuar 1250 Vendime të Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit në faza të ndryshme, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit. Të detajuara këto (1250) Vendime të Komisionit të Prokurimit Publik për periudhën Janar– Dhjetor 2022 janë si më poshtë:

- **302** pezullime fillestare te procedurave të prokurimit,
- **306** vendime të tjera (anullimi, modifikimi, pezullimi të ndërmjetëm, rivleresimi etj)
- **642** vendime lejimi.

Grafiku 53



Theksojmë se, më sipër janë cituar vetëm njoftimet e miratuara dhe publikuara, ndërkohë që shpesh here për arsye të gabimeve që konstatohen në formularët e njoftimeve të dërguara për publikim nga autoritetet kontraktore apo nga mos repektimi i afateve të ankimimit, vendimeve të KPP etj, kryen refuzimin e tyre.


10.2. Publikimi i Njoftimeve për Ankande Publike në Buletinin e Njoftimeve Publike

Gjatë 2022 janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike për procedurat e ankandeve publike:

- 358 Njoftime për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 136 Njoftime Fituesish për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 43 Njoftime Kontratash të Nënshkuara për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 120 Njoftime Anullimi për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;



Grafiku 54




10.3. Publikimi i Njoftimeve për Qera në Buletinin e Njoftimeve Publike

Nga Sektori i Publikimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2022 janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike për procedurat e qerave:

- 120 Njoftime për dhënie me qera.
- 39 Njoftime fituesi për dhënie me qera
- 109 Njoftime kontrate te lidhura për dhënie me qera
- 18 Njoftime anulimi për dhënie me qera

Grafiku 55






10.4. Njoftime për Koncesione/Partneritet Publik Privat dhe të njoftime të tjera

Gjatë 2022 janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike:

- 3 Njoftime Kontratash për Procedura Koncesioni.
- 21 Njoftime për Procedura konkurruese për dhënie leje minerare
- 1401 Njoftime të tjera.

Grafiku 56



10.5. Publikimi i elementëve të regjistrimit në sistem


Gjithashtu, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 janë përpunuar **39687** elementë të regjistrave (zëra të rinj dhe ndryshimet e kryera gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2022) në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, nga të cilat **31921** janë elementë të publikuar ndërsa **7766** janë elemente të refuzuar për shkak të mos plotësimit të të dhënave saktë nga autoritetet.

Tabela 87

Numri i elementëve të trajtuar nga Sektori i Publikimit	
Numri i elementëve të publikuar	31921
Numri i elementëve të refuzuar	7766
Totali	39687



Grafiku 57



APP ka qenë në gadishmëri për të publikuar shumicën e elementëve të regjistrit brenda 24 orëve nga dërgimi për publikim i tyre pranë APP.

10.6. Praktikrat e shqyrtuara

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2022 APP ka trajtuar 3928 praktikrat (shkresat) të detajuara si më poshtë:

Tabela 88


Lloji i kërkesës	Numri:
Shkresa të trajtuara dhe të arkivuara	3524
Shkresa të trajtuara dhe kthyer pergjigje	404

10.7. Statistika mbi transaksionet e miratuara nga AFMIS

Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave janë integruar Sistemi i Thesarit (AFMIS) me Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) për një pjesë të institucioneve të cilat aktualisht veprojnë me SIFQ.

Gjatë vitit 2022 pas përmirësimit të integritit të Sistemit të Prokurimit Elektronik me Thesarin (AFMIS) pas kontrollit të fondeve me AFMIS janë publikuar 1222 procedura prokurimi konkurruese, pra për 26% të procedurave të prokurimit të publikuara është bërë kontrolli i fondeve.

Grafiku 58





TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR MENAXHIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE DHE PUBLIKIMEVE

APP ka si detyrë të saj funksionale menaxhimin e bazës së të dhënave të SPE, asistencën e të gjithë përdoruesve të sistemit si dhe raportimin e problematikave me qëllim zgjidhjen e tyre pranë AKSHI dhe kompanisë së mirëmbajtjes duke qenë pjesë e ndjekjes së kontratës së mirëmbajtjes.

Qëllimi është përmirësimi i vazhdueshëm i procesit të prokurimit në SPE. Për këtë qëllim, APP asiston në rrugë shkresore, telefonike apo me anë të email të gjithë përdoruesit e SPE.

Gjatë vitit 2022 APP ka qenë subjekt auditimi nga KLSH për sistemin e prokurimit elektronik. Gjatë periudhës së auditimit dhe në vijim APP ka bashkëpunuar me KLSH për çështjet e ngritura gjatë auditimit dhe përmirësimit të proceseve të punës në bashkëpunim me AKSHI-n si institucion kyç në këtë drejtim.

Përfaqësuesit e APP kanë qenë pjesë e trajnimeve në bashkëpunim me ASPA-n për të trajnuar të gjithë përdoruesit e sistemit apo konferencave të organizuara, kanë kryer bashkëpunime me OSBE dhe mediat e shoqërisë civile në "Data monitoring and analysis-Good practices from the SEE region Good practices from Albania" gjithashtu në kuader të Cybersecurity, bashkëpunim me U.S. Department of Commerce and Infrastructure Security Agency (CISA) në Workshop Data monitoring and analysis-Good practices from the SEE region Good practices from Albania.

APP menaxhon BI Reports me qëllim gjenerimin e të dhënave nga sistemi për përpunimin e të dhënave statistikore, konkretisht raportet të cilat gjenerohen janë:

- Pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë për muaj
- Trend i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë
- Statistika Prokurime Elektronike të Publikuara
- Statistika Njoftime fituesi të shpallura
- Statistika Kontrata të nënshkruara të shpallura
- Pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë në prokurime
- Regjistri i realizimeve
- Statistika regjistri i parashikimeve
- Statistika mbi minikontratat
- Statistika për arsyet e anulimit
- Statistika procedurat me një ofertë
- Transaksionet e miratuara nga AFMIS dhe Integrimi me AFMIS

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, APP ka suportuar të gjithë përdoruesit e sistemit të prokurimit elektronik për zgjidhjen e problematikave apo asistencën teknike. Gjithashtu përveç mendimeve për përmirësim të SPE, APP ka përgatitur manuale dhe njoftime të ndryshme

APP ka punuar maksimalisht në ofrimin e shërbimeve me siguri të lartë për të gjithë Autoritetet Kontraktore, Operatorët Ekonomikë, Audituesit, si dhe çdo Autoritet tjetër që, në përmbushje të detyrave të tij, përdor Sistemin e Prokurimit Elektronik.



Po kështu APP ka qenë në dispozicion për çdo kërkesë për asistencë, pyetje apo paqartësi si dhe ka ndjekur me rigorizitet proceset e monitorimit e kontrollet javore, apo çdo problematikë të raportuar deri në zgjidhjen e tyre përfundimtare, etj.

Gjithashtu, pavarësisht situatës së vështirë të krijuar në vendin tone për shkak të sulmeve kibernetike, edhe me mbështetjen e vazhdueshme të AKSHI-t, Sistemi i Prokurimit Elektronik ka qëndruar në punë (on-line) 24 orë, çdo ditë të javës.


- **Një nga objektivat kryesore të APP është përmirësimi i vazhdueshëm dhe optimizimi i ndërfaqes, me qëllim përmirësimin dhe lehtësimin e punës së përdoruesve.**

APP ka vijuar punën me identifikimin e kërkesave për përmirësim dhe shtim të disa funksionaliteteve të reja për Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Konkretisht, gjatë periudhës Janar - Dhjetor janë raportuar tek kompania e mirëmbajtjes 215 raste/kërkesa për përmirësim në funksionet dhe ndërfaqet e roleve në sistem, analizimi të dhënave, verifikime në sistem, etj.

Të gjitha çështjet e hapura në CRM janë ndarë si më poshtë:

Grafiku 59



Gjatë vitit 2022 në Sistemin e prokurimit Elektronik, janë realizuar përmirësimet e mëposhtme:

- **Krijimi i procedurës shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike në SPE**

-

Referuar Vendimit Nr. 768, datë 15.12.2021 "Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe të tjera" është krijuar në sistem procedura e prokurimit "Shërbime sociale" me qëllim zhvillimin e saj në sistem nga autoritetet kontraktore referuar VKM së sipërcituar. Ky zhvillim është realizuar si për elementet e regjistrimit ashtu edhe për procedurën e prokurimit.

- **Faza Njoftim fituesi paraprak dhe njoftim fituesi përfundimtar**



Referuar parashikimeve ligjore në fuqi për prokurimin publik është krijuar mundësia e ndarjes së njoftimit të fituesit paraprak dhe njoftimit të fituesit përfundimtar në SPE, pasi referuar DST të procedurave të prokurimit publik, të gjithë autoritetet kontraktore fillimisht duhet të ngarkojnë njoftimin e fituesit paraprak dhe më pas njoftimin e fituesit pas përfundimit të afateve të ankimimit (periudhës së pritjes).

- ***Përcaktimi i afateve të ankimimit***

Pas publikimit të fituesit paraprak fillojnë afatet e ankimimit të përcaktuara në legjislacion. Ky zhvillim është realizuar në SPE, pasi autoritetet kontraktore nuk mund të vijnë me njoftimin e fituesit pas ankimimit pa përfunduar këto afate.

- ***Njoftimi i operatorëve ekonomikë në fillimin e afateve të ankimimit për çdo procedurë prokurimi***

Përmirësim në rolin e operatorit ekonomik duke e njoftuar për fillimin e afateve të ankimimit për çdo procedurë prokurimi në të cilën ka marrë pjesë dhe ka dorëzuar ofertën e tij. Operatorët ekonomikë mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u ankuar pas marrjes së këtij njoftimi në SPE.

- ***Integrimi me sistemin e thesarit***

Asnjë autoritet kontraktor i cili ndërvepron me sistemin e thesarit nuk mund të vijojë me krijimin e procedurës së prokurimit pa u miratuar dhe kontrolluar fondet në sistem. Gjithashtu, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është përgatitur manuali i përdorimit dhe njoftimi për të gjithë përdoruesit e SPE, për mënyrën se si duhet të veprojnë me krijimin e procedurës së prokurimit.

- ***Implementimi i kodit output investime dhe shërbime***

Autoritetet kontraktore të cilat nuk ndërveprojnë me thesarin apo janë me fondet e tyre duhet të përcaktojnë në sistem fillimisht nëse procedura e prokurimit është investim apo shërbim si dhe kodin dhe fondin përkatës që më pas të vijnë me krijimin e fazave të tjera të procedurës së prokurimit

- ***Faza e parë e procedurave të reja Procedura Konkurruese me Negocim, Partneritet për Inovacion dhe Dialog Konkurrues.***

Referuar VKM Nr. 384, date 30.06.2021 janë krijuar në sistem procedura e prokurimit Konkurruese me Negocim, Partneritet për Inovacion dhe Dialog Konkurrues, faza e parë e këtyre procedurave referuar edhe VKM se cituar.

- ***E detyrueshme ndryshimi i fjalëkalimit për çdo llogari përdoruesi në sistem brenda 90 ditëve.***

Me qëllim sigurinë e SPE dhe të gjithë llogarive të përdoruesve nga sulmet kibernetike është bërë e detyrueshme ndryshimi i fjalëkalimit brenda 90 ditëve duke respektuar edhe përcaktimin e karaktereve apo gjatesisë së fjalëkalimit.

- ***Përmirësim i BI Reports***

Me qëllim përpunimin e të dhënave statistike janë realizuar përmirësime në raportet e gjeneruara nga SPE.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer përmirësime në shfaqjen e fushave apo informacioneve të nevojshme për zbatimin e detyrave të përditshme të përdoruesve si:

- Përmirësime në ndërfaqet e Rolit e Publikuesit, duke shtuar Njoftimin e Fituesit Paraprak dhe Njoftimin e fituesit përfundimtar
- Përmirësime në Raportet që gjenerohen nga sistemi për rolin Analist prokurimesh, etj
- Përmirësime në rolin e njesise se prokurimit apo KVO duke i derguar email 24 ore perpara hapjes dhe vleresimit te procedures.



Të gjitha ndryshimet e cituara janë shoqëruar me përgatitjen e manualeve teknike përkatëse, konkretisht:

- Manual teknik për krijimin e procedurës së prokurimit blerje me vlerë të vogël
- Manual teknik dhe njoftim për krijimin e procedurës për kontrollin e fondeve pas integritetit me thesarin
- Manual teknik dhe njoftim për krijimin e procedurës kur autoritetet nuk janë të lidhura me thesarin
- Një nga objektivat kryesorë është dhe garantimi në kohë dhe me cilësi të ecurisë së punës për të gjithë përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemit të Arkivës Elektronike (SAE) si dhe garantimi i konfidencialitetit të ofertës ekonomike duke bërë enkriptimin dhe dekriptimin çka ka bërë që Informacioni me ndjeshmëri të lartë të jetë i përdorshëm vetëm për ata persona që janë të autorizuar ta shohin ose ta përdorin atë.
- **Dhënia e asistencës teknike për përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik**
 - Një nga detyrat e APP është garantimi i asistencës teknike për çdo kërkesë (kërkesat për dekriptim dokumentash, kërkesat për sqarim, ankesat nga ana teknike), të mbërritura në APP, garantimi i asistencës teknike për punonjësit e APP-së, garantimi i asistencës teknike për telefonatat dhe e-maillet e mbërritura në APP.
 - Asistenca teknike që u jepet të gjitha autoriteteve kontraktore, si dhe të gjithë operatorëve ekonomikë të huaj dhe vendas të cilët përdorin sistemin e prokurimit elektronik, nëpërmjet e-mail-ëve, telefonit apo dhe konsultimeve në ambientet e APP, është një punë e përditshme për këtë drejtori. Këtu vlen të përmendet se numri i lartë telefonatave apo e-maileve
 - APP ka dërguar rreth 2414 e-maile në total një numër më i vogël se 2021 pasi për shkak të sulmeve kibernetike nuk ka funksionuar adresa zyrtare e email, drejt:
 - autoriteteve kontraktore, sqarime të përgatitura nga APP për autoritetet kontraktore (për sqarime dhe udhëzime të karakterit teknik);
 - operatorëve ekonomikë (për konfirmimin e regjistrimeve të bëra online, për rikthim të fjalëkalimit në gjendjen fillestare, për sqarime, udhëzime dhe ankesa);
 - sqarime të përgatitura autoriteteve kontraktore (për sqarime dhe udhëzime të karakterit teknik);
 - institucioneve të tjera (për dërgim të dhënash dhe informacionesh);
 - Garantimi i asistencës teknike për llogari audituese për çdo auditues të Autoriteteve Kontraktore si dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.

- Pasurimi i portalit të APP me informacionet e duhura,

APP ka kryer publikimin e çdo informacioni të përditësuar në lidhje me procesin e prokurimit, konkretisht në portal janë publikuar:

- 179 buletinëve javorë (ku 52 prej tyre janë Buletine të Njoftimeve Publike dhe 127 janë Buletinë të Posacëm),
- Vendime nga Monitorimi i APP - 63 vendime
- Vendime nga Raportet e Auditimit - 13 vendime
- Vendime për Përrjashtime të Operatorëve Ekonomikë - 56 vendime
- VKM 2022 - 4 vendime
- DST 2022 - 2 publikime
- Udhëzime 2022 - 5 publikime
- Rekomandime 2022 - 3 publikime
- Sjellje në vëmendje të AK - 4 publikime
- Lajmërime për operatorët ekonomikë - 2 publikime
- Njoftime- 23 njoftime për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë.



- Krijimi, azhurnimi, si dhe mbyllja e llogarive të Sistemit të Prokurimit Elektronik

Është kryer krijimi i llogarive 23 llogarive në rolin e administratorin për Autoritetet Kontraktore.

- Monitorimi i procedurave të prokurimit të lëna pezull në sistem dhe tërheqja e vëmendjes ndaj personave përgjegjës konform legjislacionit në fuqi.
- Arkivimi i të gjitha procedurave të lëna pezull nga Autoritetet Kontraktore per procedurat e prokurimit me 2 faza e dyte zhvillohet ne forme shkresore. Ky proces bën të mundur që sistemi operacional, në të cilin kryhen të gjitha procedurat e prokurimit publik, të lehtësohet ndjeshëm duke ulur gjithmonë e më shumë numrin e procedurave që ndodhen në të dhe, për pasojë, duke lehtësuar punën e përdoruesve të sistemit (Autoritete Kontraktore, Operatorë Ekonomikë, Auditues).
- Testim te zhvillimeve dhe pemirosimet te SPE perpara se te kalojne ne sistemin live
- Ndjekja e kontratës së mirëmbajtjes për Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe e të gjithë komponentëve të saj duke monitoruar të gjithë komponentet e sistemit.

11.1. Praktikrat e shqyrtuara

Gjatë vitit 2022, janë trajtuar 1372 shkresa dhe memo në total, ku përfshihen:

- Krijim/ Mbyllje llogarie në rolin CA Admin, si dhe rikthim fjalëkalimi në gjendje fillestare (281);
- Shkresa sqaruese me Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë (484);
- Shkresa për dërgim të dhënash dhe bashkëpunim me institucionet e tjera (122);
- Memo të brendshme 163);
- Shkresa për arkivim dhe persona përgjegjës (485), etj

Tabela 89

Praktikat e shqyrtuara nga gjatë vitit 2020 sipas llojit të kërkesës	
Lloji i Kërkesës	Numri
Kërkesa për mbyllje llogarie/ ndryshim fjalëkalimi per autoritetet kontraktore	281
Shkresa sqaruese me Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë	486
Kërkesa për asistencë teknike/sqarime dhe për dërgim të dhënash dhe bashkëpunim me institucionet e tjera	122
Shkresa për arkivim dhe persona përgjegjës	485
Totali	1372

Sic shihet edhe nga të dhënat e mësipërme numrin më të lartë të shkresave të dërguara dhe të trajtuara e zënë kërkesat sqaruese per autoritetet kontraktore dhe operatoret ekonomike, sic e shohim kemi rënie te numri te shkresave per ndryshim fjalëkalimi pasi operatoret ekonomike mund te pajisen me fjalekalim te ri dhe llogari perdoruesi si operatore ekonomike nepermjet eAlbania.



11.2. Krijimi i përdoruesve të rinj për vitin 2022

Për vitin 2022 në sistemin e prokurimit elektronik janë krijuar 24023 përdorues të rinj, dhe përkatësisht:

Gjatë vitit 2022 janë krijuar 23 llogari të reja në rolin “Administrator i Sistemit” për Autoritetet Kontraktore. Ndërsa nga llogaritë e Administratorëve të Autoriteteve Kontraktore janë krijuar në total rreth 5297 përdorues të rinj.

Në tabelën e mëposhtëm paraqitet numri i përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik, brenda Autoriteteve Kontraktore, të krijuar përkatësisht në vitin 2022.

Tabela 90

Roli i Llogarisë	Llogarive të Përdoruesve të krijuar gjatë vitit 2022
Administrator i Sistemit për AK	23
Njësi Prokurimi	2366
Komisioni i Vlerësimit të Ofertave	2559
Auditues i AK	372
Auditues	3
Totali	5323


Në tabelën dhe në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik, të krijuar përkatësisht në vitin 2022, sipas muajve.

Tabela 91

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Numri i përdoruesve	375	572	441	518	437	579	568	349	421	366	363	334



Grafiku 60



Nga figura shihet qartë krijimi i llogarive të përdoruesve në sistem periudhën Nëntor-Dhjetor, kemi një rënie të dukshme të krijimit të përdoruesve, e cila është dhe periudha kur nuk kemi shpallje të procedurave të prokurimit pasi nga ana e autoriteteve kontraktore janë marrë masa për shpalljen e tyre gjatë vitit.

Tabela e mëposhtme paraqet statusin e llogarive të përdoruesve nga Autoritet Kontraktore në Sistemin e Prokurimit Elektronik:

Tabela 92

Roli i Llogarisë	Llogari përdoruesi Aktive
Administrator i Sistemit për AK	1304
Njësi Prokurimi	13552
Komisioni Vlerësimit të Ofertave	15816
Auditues i AK	1506
Auditues i KPP	19

Aktualisht në sistem kemi 1304 autoritete/ente kontraktore aktive, të cilët kanë publikuar procedurë prokurimi gjatë vitit 2022.

Përsa i përket, llogarive të përdoruesve në rolin e operatorëve ekonomikë, për vitin 2022 në Sistemin e Prokurimit Elektronik janë regjistruar 18779 operatorë ekonomikë të rinj, nga të cilët 79 janë operatorë ekonomikë të huaj.


Pajisja e operatorëve ekonomikë me llogari përdoruesi kryhet nga APP, si dhe falë shërbimit të ndërveprimit me sistemin e Qendrës Kombëtare e Biznesit, ku automatikisht çdo operator ekonomik i regjistruar në QKB pajiset me llogari përdoruesi në SPE.



Tabela 93

Roli \ Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Economic Operator nga APP	16	17	28	36	5	0	0	1	0	2	5	1	111
Economic Operator automatikisht nga QKB	2153	1841	1616	1628	1408	1738	979	1204	1679	1597	1405	1241	18489
Operator ekonomike te huaj aprovuar nga portali	4	3	4	9	2	4	5	4	6	12	22	4	79
Totali	2173	1861	1648	1673	1415	1742	984	1209	1685	1611	1432	1246	18679


Grafiku 61



Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i Operatorëve Ekonomikë të rinj të Sistemit të Prokurimit Elektronik, sipas Muajve:



Grafiku 62



Më poshtë paraqitet statusi i operatorëve ekonomike në Sistemin e Prokurimit Elektronik:

Tabela 94

Statusi i Operatoreve ekonomik per vitin 2022	Numri
Operatore ekonomik aktiv	264517
Operatore ekonomik me statusin të perjash-tuar	21
Operatore ekonomik joaktiv QKB	46904

11.3. Statistika të tjera në lidhje me përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik

Në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për vitin 2022 në total kemi 386,746,271 klikime (krahasuar me vitin 2021 kemi 2,633,416 më shume klikime), 312,479,586 shikime të faqes së internetit (krahasuar me vitin 2021 kemi 138,441,511 shikime me pak të faqes së internetit) si dhe 2,089,606 (krahasuar me vitin 2021 kemi me pak 440,727 vizitorë).




Klikimet për vitin 2022

Tabela 95

Përdorimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik	2021	2022
Klikimet Total	384,112,855	386,746,271
Klikimet sipas Vizitor	383,262,478	386,746,271
Mesatarja Klikimet ne dite	1,046,629	1,059,578
Mesatarja Klikimet per Vizitor	154,52	185.08
Shikimet e faqes Total	450,921,097	312,479,586
Mesatarja e Shikimeve te faqes ne dite	1,232,024	856,108
Mesatarja e Shikimevetefaqes per Visitor	178	149,54
Total Visitors	2,530,333	2,089,606
Mesatarja Visitors per Day	6,913	5,724
Total Unique IPs	116,004	72,308


Në grafikun e mëposhtëm paraqitet shpërndarja e klikimeve, dhe vizitorëve për vitin 2022.

Grafiku 63





Grafiku 64




Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është gjatë periudhës Qershor-Korik dhe Tetor- Nentor.

11.4. Aktiviteti i faqeve per vizitore

Në grafikun e mëposhtëm jepet numri i rubrikave për visitor, i cili tregon se sa rubrika shikon mesatarisht, një visitor pasi ka hyrë në faqen zyrtare të APP.

Grafiku 65





11.5. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas 24 orëve.


Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas 24 orëve

Tabela 96

Shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas 24 orëve 2022			
Orët	Hits	Page View	Visitors
00:00 - 00:59	2,733,146	2,216,985	9,644
01:00 - 01:59	2,061,704	1,667,460	39,461
02:00 - 02:59	1,963,279	1,603,391	4,889
03:00 - 03:59	1,960,329	1,604,284	4,883
04:00 - 04:59	2,031,073	1,657,436	5,721
05:00 - 05:59	2,326,391	1,871,031	10,071
06:00 - 06:59	3,828,246	2,957,570	33,394
07:00 - 07:59	15,778,652	12,184,736	154,673
08:00 - 08:59	33,377,232	26,448,585	231,449
09:00 - 09:59	42,580,604	34,381,462	214,989
10:00 - 10:59	43,163,723	35,229,702	190,479
11:00 - 11:59	40,188,391	33,020,134	174,439
12:00 - 12:59	38,131,181	31,398,285	166,317
13:00 - 13:59	36,959,677	30,434,107	157,206
14:00 - 14:59	33,779,534	27,781,937	142,594
15:00 - 15:59	25,123,063	20,507,410	115,449
16:00 - 16:59	14,813,150	11,869,773	86,613
17:00 - 17:59	9,584,264	7,522,846	71,383
18:00 - 18:59	7,879,133	6,114,687	65,149
19:00 - 19:59	7,132,633	5,479,240	60,304
20:00 - 20:59	6,538,110	5,015,350	53,775
21:00 - 21:59	6,054,667	4,655,281	45,853
22:00 - 22:59	5,038,999	3,917,598	32,204
23:00 - 23:59	3,719,090	2,940,296	18,667
Total	386,746,271	312,479,586	2,089,606



Grafiku 66



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është gjatë orarit 08:00-15:00., por ne cdo rast verëhet se aktiviteti i përdoruesve është gjatë 24 orëve.

11.6. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas ditëve të javës.


Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas ditëve të javës:

Tabela 97

Aktiviteti sipas ditëve të javës 2022			
Ditë	Hits	Page View	Visitors
E Hënë	8,352,806	5,689,348	78,289
E Martë	68,570,503	55,201,217	365,347
E Mërkurë	72,867,967	59,186,144	380,293
E Enjte	75,905,451	61,795,614	393,773
E Premte	75,621,652	61,623,918	388,619
E Shtunë	68,602,877	55,915,254	358,008
E Diel	16,825,015	13,068,091	125,277
Total	386,746,271	312,479,586	2,089,606



Grafiku 67



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, gjatë javës është nga e Hëna në të Premte por nuk mungojnë klikimet dhe vizitorët e sistemit edhe gjatë fundjavave.

11.7. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas muajve të vitit.


Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas muajve:

Tabela 98

Aktiviteti sipas muajve			
Muaji	Hits	Page View	Visitors
Janar	24,797,996	19,381,525	143,900
Shkurt	28,892,303	23,024,505	159,376
Mars	31,383,634	25,064,548	172,606
Prill	32,513,719	26,038,819	173,149
Maj	33,846,887	27,329,152	177,777
Qershor	35,703,527	28,970,268	188,307
Korrik	30,260,456	24,287,141	166,912
Gusht	28,656,853	23,025,117	164,976
Shtator	33,908,693	27,503,978	178,486
Tetor	37,631,305	30,568,912	193,867
Nentor	35,178,839	29,079,654	186,896
Dhjetor	33,972,059	28,205,967	183,354
Total	386,746,271	312,479,586	2,089,606




Grafiku 68




Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është periudha Qershor- Korrik dhe më pas periudha Tetor – Nëntor.

11.8. Përdoruesit te cilet perdorin me se shumti sistemin e prokurimit elektronik

Grafiku 69





11.9. Aktiviteti i përdoruesve sipas ndërfaqeve më të klikuara në portalin e APP.


Tabela dhe Grafikët e mëposhtëm pasqyrojnë ndërfaqet më të kërkuara në internet për aksesimin e Sistemit e Prokurimit Elektronik:

Tabela 99


Ndërfaqet më të kërkuara në internet	Visitors
http://www.app.gov.al/	2,084,893
http://www.app.gov.al/e-prokurim/	717,436
http://www.app.gov.al/regjistri-i-parashikimeve/	70,169
http://www.app.gov.al/njoftimi-i-kontratës-së-shpallur/	128,795
http://www.app.gov.al/të-tjera/arkiva/arkiva-e-buletinit-të-prokurimit-publik/arkiva-e-buletinit-te-prokurimit-publik-2022/	50,050
http://www.app.gov.al/prokurimet-me-vlere-te-vogel/	69,949
http://www.app.gov.al/njoftimi-i-fituesit/	98,606
http://www.app.gov.al/të-tjera/arkiva/arkiva-e-buletinit-të-prokurimit-publik/	87,260
te tjera	12,631,351



Grafiku 71



Grafiku 72



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, interesi kryesor është tek ndërfaqja e logimit në sistemin e prokurimit elektronik, arkiva e buletineve të prokurimit publik, etj.

11.10. Aktiviteti i përdoruesve sipas fjalëve kyc më të përdorura për kërkimin e portalit të APP.


Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyron fjalët e kerkuara më shpesh gjatë dites në internet portalin e APP dhe Sistemin e Prokurimit Elektronik:



Tabela 100

shprehjet/fjalet kyc	Visitors
https://www.app.gov.al/	946
https://www.app.gov.al/e-prokurim/	69
app	50
prokurimi	49
elektronik	45
app.gov.al	41
e	27
http://app.gov.al/	27
login	20
publik	16
agjencia	15
prokurimeve	14
te tjera	103

Grafiku 73




Sikurse shihet nga grafiku i mëposhtem shprehjet e kërkua më shpesh në internet është faqja zyrtare e APP, më pas dritarja e loginit për seksionin e autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë.




Tabela 101

2	https://www.app.gov.al/	946
3	https://www.app.gov.al/e-prokurim/	69
4	app	49
5	prokurimi elektronik	43
6	http://app.gov.al/	27
7	app.gov.al login	20
8	app.gov.al	20
9	agjencia e prokurimit publik	10
10	agjencia e prokurimeve publike	7
11	https://eprocurement.app.gov.al/	5
12	prokurimi publik	5

Grafiku 74



Shprehjet e kerkuara me shpesh



11.11. Aksesimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas shfletuesve dhe sistemeve operative.


Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyron aksesimin e Sistemit e Prokurimit Elektronik sipas shfletuesve të kërkimit:



Tabela 102


Browser	Visitors
Google Chrome	1,667,193
Mobile Safari	235,037
Microsoft Edge	102,058
Firefox	101,142
Safari	18,426
Internet Explorer	15,294
Opera	14,673
Others	10,517
	5,012

Grafiku 75



Siç shihet nga të dhënat e mësipërme Sistemi i Prokurimit Elektronik, aksesohet dhe funksionon normalisht nga të gjitha llojet e shfletueve si GoogleChrome, MozillaFirefox, etj. Gjithashtu, vërehet se GoogleChrome mbetet shfletuesi më i përdorur për aksesimin e sistemit të prokurimit.

Grafiku 76



Më poshtë paraqitet aksesimi javor i sistemit të prokurimit elektronik nga versionet e internet explorer dhe microfoost edge.




11.12. Aksesimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas llojeve të pajisjeve më të përdorura nga përdoruesit

Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyron aksesimin Sistemit e Prokurimit Elektronik sipas sistemeve operative të përdorura nga përdoruesit:

Tabela 103

Operating System	Visitors
Windows 7	439,550
Windows 10	987,010
Android OS	270,245
iPhone	269,432
Mac OS	32,170
Other	33,480

Grafiku 77



Më poshtë paraqitet aksesimi ditor i sistemi të prokurimit elektronik sipas sistemeve operative që përdorin përdoruesit e SPE.

Grafiku 78







Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyron aksesimin Sistemit e Prokurimit Elektronik sipas llojeve të pajisjeve të përdorura nga përdoruesit:

Tabela 105

Device Type	Hits	Visitors	% of Total Visitors
Desktop	362,953,825	1,548,837	74.12%
Mobile	23,628,180	537,777	25.74%
Tablet	164,266	2,992	0.14%
Total	386,746,271	2,089,606	100.00%

Grafiku 79



Sic vërehet, sistemi i prokurimit elektronik mund të aksesohet nga çdo pajisje elektronike duke iu lehtësuar punën përdoruesve të saj si dhe mundësuar aksesimin në çdo kohë dhe në çdo moment ku ndodhen.

Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, Sistemi i Prokurimit Elektronik, më së shumti aksesohet nga pajisjet kompjuterike (desktop) si dhe nga pajisjet mobile.



MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCËS

12.1. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

APP e ka ushtruar aktivitetin e saj ligjor me 4(katër) drejtori dhe 1(një) sektor në varësi direkte të Drejtorit të Përgjithshëm.

Gjatë vitit 2022, struktura dhe organika e APP-së ka ndryshuar 1(një) herë, konkretisht: Me Urdhrin Nr. 149, datë 28.12.2022 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”, u miratua struktura dhe organika e re e APP e përbërë nga 4(katër) drejtori dhe 1(një) sektor në varësi direkte të Drejtorit të Përgjithshëm, përkatësisht Drejtoria Juridike dhe e Monitorimit të Procedurave me 3 (tre) sektorë: Sektori Ligjor dhe i Shqyrtimit të Kërkesave për Përjashtim, Sektori i Monitorimit të Procedurave të Prokurimit Publik, Sektori i Monitorimit të Koncesioneve/PPP dhe Procedurave në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë, Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit të Kontratave me 2 (dy) sektorë: Sektori i Koordinimit dhe Sektori i Monitorimit të Kontratave, Drejtoria e Menaxhimit të Bazës së të Dhënave dhe Publikimit me 2 (dy) sektorë: Sektori i Menaxhimit të Bazës së të Dhënave dhe dhe Sektori i Publikimit, Drejtoria e Zbatimit të Politikave Strategjike dhe Integritimit me 2(dy) sektorë: Sektori i Zbatimit të Politikave Strategjike dhe Statistikave, Sektori i Integritimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore. Numri total i punonjësve është 44.

12.2. Autoriteti Përgjegjës për konfliktin e interesit

Për vitin 2021, në Agjencinë e Prokurimit Publik, bazuar në Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të nëpunësve publikë” dhe Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave gjatë ushtrimit të funksioneve publike”, kanë pasur detyrimin për deklarin dhe interesave private periodike/vjetore për vitin 4 nëpunës civil në nivel drejtues të APP në pozicionet, si vijon:

- Drejtor i Përgjithshëm
- Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Bazës së të Dhënave dhe Publikimit
- Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit dhe Monitorimit të Kontratave
- Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Monitorimit të Procedurave
- Drejtor i Zbatimit të Politikave Strategjike dhe Integritimit.

Të gjithë subjektet e mësipërme përgjegjëse kanë plotësuar dhe dorëzuar brenda afatit, datë 31.10.2022, *Deklaratën e Interesave Private/Periodike* pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Sa i takon identifikimit dhe regjistrimit të rasteve të konfliktit të interesave, gjatë vitit 2022 nuk janë regjistruar raste të tilla në APP.

12.3. Koordinator për të drejtën e informimit

Në kuadër të transparencës, detyra e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe Koordinatorit për të Drejtën e të Dhënave Personale kryhet nga 1 specialist i Sektorit të Koordinimit. Në përmbushje të detyrave të përcaktuara në Ligjin Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, Koordinatorin ka administruar çdo kërkesë për informacion të paraqitur pranë APP në formë shkresore apo elektronike, dhe në bashkëpunim me sektorët që administrojnë informacionet e kërkuara, ka kthyer përgjigje brenda



afateve ligjore. Konkretisht, për vitin 2022, Koordinatorin Për të Drejtën e Informimit ka shqyrtuar dhe kthyer përgjigje për 22 kërkesa për informacion.

12.4. Aktivitetet në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve administrative të stafit të APP dhe specialistëve të prokurimit publik pranë autoriteteve kontraktore

12.4.1. Pjesëmarrja në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare

Në mbështetje të VKM Nr. 138, datë 12.03.2014 “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë, i ndryshuar, për vlerësimin e nevojave individuale për trajnim, si dhe në kuadër të procesit të Integritetit dhe prioriteve mbi përmirësimin e sistemit të prokurimit në Shqipëri në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe evropiane, APP është bërë pjesë e një sërë takimesh dhe workshopesh të organizuara nga organizma dhe institucione të ndryshme vendase dhe të huaja pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabela 106

Tema	Drejtori/Sektor	Data	Nr. Pjesëmarrësve
Roli dhe detyrat e autoriteteve përgjegjëse për deklarimin dhe konfliktin të interesit (ILDKPI)	Sektori i Financës dhe Buri-meve Njerëzore	14.02.2022-25.03.2022	1
Rregullimi i marrëdhënieve juridike të shërbimit civil (ASPA)	Sektori i Financës dhe Buri-meve Njerëzore	04.04.2022-13.04.2022	1
Mbi asistencën teknike për zbatimin e një sistemi efektiv të MFK në APP. (ASPA)	Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit të Kontratave	15.04.2022	2
Zhvillimi i procedurave të prokurimit publik në respektim të aspekteve mjedisore (Prokurimi Publik i Gjellbër-PPGJ/ Green Public Procurement-GPP) - Pjesa 1 (ASPA)	Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit të Kontratave Drejtoria Juridike dhe e Monitorimit të Procedurave	22.06.2022	12
Zhvillimi i procedurave të prokurimit publik në respektim të aspekteve mjedisore” (Prokurimi Publik i Gjellbër/ Green Public Procurement-GPP) - Pjesa 2 (ASPA)	Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit të Kontratave Drejtoria Juridike dhe e Monitorimit të Procedurave	23.06.2022	12
Mashtrimi në Prokurimet Publike Pjesa 1 (Ambasada Franceze dhe APP)	Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit të Kontratave Drejtoria Juridike dhe e Monitorimit të Procedurave	08.06.2022	10



Trajnim i Përgjithshëm me temën “Mashtrimi në Prokurimet Publike” - Pjesa 2 (Ambasada Franceze dhe APP)	Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit te Kontratave Drejtoria Juridike dhe e Monitorimit te Procedurave	09.06.2022	9
Prokurimi Publik në rastet e emergjencave civile (Banka Botërore)	Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit te Kontratave Drejtoria Juridike dhe e Monitorimit te Procedurave	30.06.2022	2
Regjistri i përdorimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB-ve) në fermë” (ASPA)	Sektori i Koordinimit	13.09.2022	1
Parimet baze për hartimin e shkresave dhe komunikimit shkresor (ASPA)	Sektori Ligjor dhe i Shqyrtimit te Kërkesave për Përrjashtim	06.04.2022	1
Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël. (ASPA)	Sektori Ligjor dhe i Shqyrtimit te Kërkesave për Përrjashtim	24.03.2022	1
Korrupsioni në prokurimin publik (ASPA)	Sektori Ligjor dhe i Shqyrtimit te Kërkesave për Përrjashtim	08.09.2022	1
Metodat e analizimit të rrishtit. (MFE)	Sektori Ligjor dhe i Shqyrtimit te Kërkesave për Përrjashtim Sektori i Monitorimit te Kontratave Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore	09. 06.2022	5
Trajnim në kuadër të zbulimit të mashtimit në prokurimin publik “Hetimet e përbashkëta – metodologjia dhe analiza e rrezikut”. (ASPA)	Sektori i Monitorimit te Procedurave te Prokurimit	09.06.2022	4
Trajnim (Webinar) i përgjithshëm mbi rëndësinë e hartimit dhe zbatimit të instrumenteve të MFK, si dhe trajtimi i rregullave të përgjithshme mbi hartimin e planit vjetor të punës. (ASPA)	Sektori i Monitorimit te Procedurave te Prokurimit	15.04.2022	2
4th NCPA Webinar on Tackling Corruption in Public Procurement	Sektori i Monitorimit të Procedurave të Prokurimit	15.12.2022	1



<i>"Best practices in IT procurement and data management"</i>	Sektori i Monitorimit të Koncesioneve/PPP dhe Procedurave në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë	20-21.10.2022	2
Për etiketimin e ushqimit dhe informimin e konsumatorit. (ASPA)	Sektori i Monitorimit të Koncesioneve/PPP dhe Procedurave në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë	31.10.2022	1
<i>"PPP Evaluation Methodology for the SDGs"</i> (ASPA)	Sektori i Monitorimit të Koncesioneve/PPP dhe Procedurave në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë	27.09.2022	2
Asistencë teknike lidhur me zhvillimin e instrumenteve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK)	Sektori i Monitorimit të Kontratave	28.09.2022	2
Mbi korrupsionin në prokurimin publik (ASPA)	Sektori i Monitorimit të Kontratave	15.12.2022	1
<i>Best Practices in IT Procurement and Data Management</i> (ASPA)	Sektori i Koordinimit	20.10.2022-21.10.2022	2
Korrupsioni në Prokurimin Publik (ASPA)	Sektori i Koordinimit	15.12.2022	1
Zhvillimi i instrumenteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. (MFE)	Sektori i Financës dhe Buri-meve Njerëzore, Drejtoria Juridike dhe e Monitorimit të Procedurave, Drejtoria e koordinimit dhe monitorimit të kontratave, Drejtoria e Zbatimit të Politikave Strategjike dhe Integritetit, Drejtoria e Menaxhimit të Bazës së të Dhënave dhe Publikimit. (MFE)	28.09.2022	12
Forum i 16 mbi Prokurimet, Integritetin, Menaxhimin dhe Transparençën (PRIMO)	Sektori i Zbatimit të Politikave Strategjike dhe Statistike	19.09.2022-21.09.2021	40



12.4.2. Trajnimet e punonjësve të prokurimeve pranë Autoriteteve Kontraktore

Në mbështetje shkronjës (j), të nenit 23, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, APP bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve për institucionet publike me qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe profesionalizmin e sistemit të prokurimit publik në përgjithësi.

Në bazë të Kreut III, të pikës 6 dhe 9 të VKM Nr. 138, datë 12.03.2014 “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë, i ndryshuar, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, me qëllim rritjen profesionale dhe kualifikimin e personave përgjegjës për prokurimet pranë Autoriteteve Kontraktore në fushën e prokurimit publik, janë organizuar trajnime të ndryshme mbi prokurimin të ndarë sipas tematikave të ndryshme.

Për periudhën janar-dhjetor 2022, janë regjistruar 1396 pjesëmarrës, nga 282 institucione qendrore+vendore+tëpavarura. Nga numri i pjesëmarrësve janë 997 femra dhe 399 meshkuj.

Tabela 107

	Moduli	Autoritete Kontraktore	Nr. Autoriteteve Kontraktore	Nr. Pjesëmarrësve	Meshkuj	Femra	NP	Kod Pune
1	Prokurimi Publik	Qendror Vendor Të Pavarura	174 57 51	582 419 395	399	997	1250	146
Totali			282		1396			

12.4.3. TAKIME DHE WORKSHOPE

Në kuadër të procesit të Integritetit dhe prioriteve mbi përmirësimin e sistemit të prokurimit në Shqipëri në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe europiane, APP është bërë pjesë e një sërë takimesh dhe workshopesh të organizuara nga organizma dhe institucione të ndryshme ndërkombëtare.

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE PRIMO

Në datat 19-21 Shtator 2022, u mbajt në Tiranë, Forumi i 16-të mbi Prokurimet, Integritetin, Menaxhimin dhe Transparencën (PRIMO). Drejtues të agjencive të prokurimit publik, dhe ekspertë të prokurimeve nga e gjithë Evropa dhe Azia Qendrore, u mbledhën në Forumin e 16-të të Prokurimit, Integritetit, Menaxhimit dhe Hapjes (PRIMO), me temë “Supporting resilient recovery and development/Mbështetja për një rimëkëmbje dhe zhvillim të qëndrueshëm”. PRIMO është iniciuar nga Banka Botërore në vitin 2005, dhe që prej atëherë ka shërbyer si një hapësirë në shkëmbimin e njohurive dhe përvojave midis shteteve, në reformën e prokurimit publik.

Këtë vit, institucioni pritës i Forumit ishte Agjencia e Prokurimit Publik. Forumi u bashkë-sponsorizua nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Islamike për Zhvillim (IsDB), Banka Evropiane e Investimeve (BEI), Banka Aziatike për Zhvillim (ADB) dhe Banka Botërore, në bashkëpunim me OECD.

Forum i 16-të PRIMO mbledhi bashkë rreth 100 zyrtarë të prokurimit nga 19 vende të botës, si Azerbajxhani, Bosnjë dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Gjeorgjia, Kazakistani, Kosova, Republika e Kirgistanit, Moldavia, Mali i Zi, Polonia, Rumania, Sllovenia, Taxhikistani, Turqia,



Ukraina dhe Uzbekistani. Në forum morën pjesë gjithashtu përfaqësues nga institucione ndërkombëtare, si ADB, IsDB, BERZH), BEI, Banka Botërore, etj. Pjesëmarrësit në Forum diskutuan mbi praktikën dhe përvojat më të mira të prokurimit publik si dhe rolin që ai mund të luajë për të mbështetur rimëkëmbjen pas krizës dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Pjesëmarrësit në konferencë, panelistët dhe folësit vlerësuan me nota maksimale organizimin e këtij eventi nga qeveria shqiptare dhe APP duke përgëzuar për arritjet dhe angazhimin e Shqipërisë në fushën e prokurimeve publike dhe përparimin që është bërë në zbatim të reformave në këtë fushë. Aktivitete dhe workshope të tjera ku punonjësit e APP kanë marrë pjesë gjatë vitit 2022 janë si më poshtë:

- Në datat 25 dhe 26 Janar 2022, në ambientet e Hotel Rogner, është zhvilluar seminari me temë “Shkrimi i politikave”, organizuar nga Ministria e Drejtësisë.
- Më datë 28 Shkurt 2022, në ambientet e Hotel Rogner, është zhvilluar nga Projekti “C1-EU-NPA”, workshkopi me temë “Public Procurement from the Perspective of European Integration”. Workshopi u organizua në formën e një paneli diskutimi, ku folës ishte Drejtori i Përgjithshëm i APP.
- Më datë 5 Prill 2022, u zhvillua në ambientet e Hotel Rogner dhe Online, workshopi i organizuar nga projekti SEI me temë “Towards bilateral screening: from LGA and IAGA to the screening Presentation”.
- Në datat 4-6 Maj, u zhvillua online dhe fizikisht, në Barcelonë, Forumi Ndërkombëtar i UNECE për partneritetet publike-private.
- Në datat 8 dhe 9 Qershor 2022, me qëllim rritjen e kapaciteteve administrative, pjesëtarë të stafit të APP morën pjesë në trajnimin 2 ditor që APP në bashkëpunim me Drejtorinë Antikorrupsion pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Ambasadës Franceze realizoi, me temë: “Lufta kundër korrupsionit-Vlerësimi i riskut dhe analiza e kontratës”, ku ekspertë francezë trajtuan çështje dhe raste praktike të praktikave të funksionarëve përgjegjës për realizimin e prokurimeve publike ku ndërthuren elementë të korrupsionit.
- Në datat 22-23 Qershor 2022, u zhvillua një trajnim online i organizuar nga ASPA me temë “Zhvillimi i procedurave të prokurimit publik në respektim të aspekteve mjedisore (Prokurimi Publik i Gjelbër-PPGJ/ Green Public Procurement-GPP)”.
- Më datë 19 Korrik 2022, u mbajt në Bruksel, Konferenca e parë Ndërqeveritare, e cila lançoi nisjen e procesit të negociatave të aderimit në Bashkimin Evropian për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Në këtë konferencë mori pjesë Drejtori i Përgjithshëm i APP dhe njëkohësisht Negociatori për Kapitullin 5 “Prokurimi Publik”.
- Më datë 1 Qershor 2022, është zhvilluar online takimi i radhës i GNPIE për Kapitullin 5. Takimi u kryesua nga Drejtori i Përgjithshëm i APP dhe në të morën pjesë përfaqësues nga ATRAKO, Ministria e Mbrojtjes, Komisioni i Prokurimit Publik, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, MEPJ, si dhe Zyra e Kryenegociatorit.
- Më datë 26 Korrik 2022, në ambientet e Kryeministrisë, është zhvilluar takimi i GNPIE për Kapitullin 5, ku ndër të tjera, është diskutuar rreth detyrimeve që ndërmerr pala shqiptare gjatë procesit screening dhe veçanërisht pas mbajtjes së Konferencës së Parë Ndërqeveritare BE-Shqipëri.
- Në datat 12-13 Shtator, në Tiranë është zhvilluar një takim midis negociatorëve të Grupimit 1 dhe Grupit të Punës për Zgjerimin dhe Vendet Negociuese për Anëtarësimin në BE (COELA), në të cilin mori pjesë pjesë Drejtori i Përgjithshëm i APP dhe njëkohësisht Negociatori për Kapitullin 5.
- Më datë 15 Shtator, në Bruksel, u zhvillua takimi shpjegues në kuadër të procesit “screening” për Kapitullin 5. Në këtë takim delegacioni shqiptar u kryesua nga Ministri i Shtetit dhe Kryenegociatori Znj. Mjalinda Dhuka dhe Drejtori i Përgjithshëm i APP dhe njëkohësisht Negociatori për Kapitullin 5.



- Më datë 20 Shtator, në Bruksel, u zhvillua takimi shpjegues në kuadër të procesit “screening” për Kapitullin “Kriteri Ekonomik”, i cili udhëhiqet nga Ministra e Financave dhe Ekonomisë.
- Më datë 7 Tetor 2022, në ambientet e Hotel Rogner, në bashkëpunim me projektin SEI, i cili është duke asistuar Kapitullin 5 për përgatitjen për procesin “screening”, u zhvillua një takim ushtrimor në kuadër të përgatitjeve për takimin bilateral i cili do të zhvillohej në Nentor 2022.
- Në datat 11-13 Tetor 2022, në Dubrovnik, nga Zyra për Drogën dhe Krimin e Organizuar të Kombëve të Bashkuara (UNODC) dhe Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit (RA), u organizua takimi rajonal në kuadër të shqyrtimit të zbatimit të objektivave të Udhërrëfyesit Rajonal Kundër Korrupsionit dhe Financimit të Paligjshëm, i cili është miratuar në Ohër vitin e kaluar.
- Në datat 20-21 Tetor 2022, në ambientet e Hotel Hilton, u organizua një workshop nga Departamenti Amerikan i Tregtisë në lidhje me sigurinë e të dhënave, praktikat më të mira të menaxhimit të të dhënave dhe dosjeve elektronike, si dhe praktikat më të mira në prokurimin e softëare-ve.
- Në datat 7-8 Nëntor 2022, në Vienë, nga Zyra për Drogën dhe Krimin e Organizuar të Kombëve të Bashkuara (UNODC) dhe Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit (RA), u organizua takimi i grupit teknik të Udhërrëfyesit Rajonal Kundër Korrupsionit dhe Financimit të Paligjshëm, në vijim të takimit të Dubrovnikut.
- Më datë 10 nëntor 2022, në ambientet e Hotel Rogner, në bashkëpunim me projektin SEI, u zhvillua takimi i dytë ushtrimor në kuadër të përgatitjeve për takimin bilateral i cili do të zhvillohej në Nentor 2022.
- Më datë 18 Nëntor, në Bruksel, u zhvillua takimi dypalësh në kuadër të procesit “screening” për Kapitullin 5. Në këtë takim delegacioni shqiptar u kryesua nga Zv. Ministri i Drejtësisë, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik dhe njëkohësisht Negociatori për Kapitullin 5.
- Në datat 29-30 Nëntor 2022, në Ljubljana, nga Zyra për Drogën dhe Krimin e Organizuar të Kombëve të Bashkuara (UNODC) dhe Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit (RA), u organizua takimi i dytë i grupit teknik të Udhërrëfyesit Rajonal Kundër Korrupsionit dhe Financimit të Paligjshëm, në vijim të takimit të Vienës.
- Më datë 14 Dhjetor 2022, janë zhvilluar në Shkup dy aktivitete. Një aktivitet përkon me Udhërrëfyesin Rajonal Kundër Korrupsionit dhe Financimit të Paligjshëm në kontekstin e procesit të Berlinit. Në këtë takim APP u përfaqësua nga Drejtori i Përgjithshëm. Ndërsa aktiviteti tjetër, përkon me një takim me Byronë e Prokurimit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, veçanërisht në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit.
- Gjatë vitit 2022, APP në kuadër të organizimit të takimeve shumëpalëshe si dhe bashkëpunimit me institucionet e treta por edhe në kuadër të realizimit të aktiviteteve të mparashikuara në SKPP ka realizuar në dhjetor 2022 një tryezë diskutimi dypalëshe me Autoritetin e Konkurrencës të cilat kanë konkluduar në firmosje e përbashkët të një Udhërrëfyesi nga dy institucionet. Ky udhërrëfyes synon mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në prokurimet publike, me fokus parandalimin e marrëveshjeve të fshehta në prokurimet publike. Në këtë takim të datës 20 dhjetor, përveç përfaqësuesve të Autoritetit të Konkurrencës dhe të Agjencisë së Prokurimit Publik morën pjesë edhe përfaqësues të komunitetit të biznesit, dhomave të tregtisë dhe industrisë, studiove ligjore, etj¹⁰.

10 (<https://www.app.gov.al/GetData/DoenloadDoc?documentId=92428888-b7b1-46c7-84a5-498af7ddac8>).



12.5. KORRESPONDENCA ME MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

12.5.1. Kontrolli i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm

Në zbatim të Ligjit Nr.10296 datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, shkresës së Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 5241 Prot., datë 23.03.2022, Agjencia e Prokurimit Publik për periudhën 11-15 prill 2022, ishte subjekt i vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm.

Nga vlerësimi i cilësisë së kontrollit të brendshëm rezultoi se:

- Veprimtaria e APP mbështetet në Strategjinë Kombëtare të Prokurimit Publik të miratuar me Vendimin Nr 850, datë 4.11. 2021 dhe Rregulloren e Brendshme, të ndryshuar me Vendimin Nr. 3 datë 30.04.2019.
- Agjencia e Prokurimit Publik vepron në mbështetje të objektivave të përcaktuara në PBA dhe planeve vjetore të punës për realizimin e objektivave.
- Janë marrë masat për zbatimin e procesit të menaxhimit të riskut por duhet të zhvillohen me tej me zhvillimin e instrumentave përkatës.
- Janë hartuar gjurmët e auditit por duhen të përmirësohen dhe zhvillohen më tej sipas konceptit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Nuk janë hartuar manualët e proceseve të punës.

Në zbatim të gjetjeve dhe rekomandimeve, në muajin qershor u hartuan hartat dhe manualët e proceseve të punës së institucionit, sipas formatit të miratuar në manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 6, datë 29.12.2022, u miratuan gjurmët e auditit të rishikuara.

U rishikua regjistri i riskut gjatë periudhës korrik-shtator 2022 dhe u hartua plani i masave për minimizimin e riskut.

12.5.2. Përdorimi i Web Portalit

Në zbatim të Ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligjit Nr 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 17, datë 06.07.2021, “Për përdorimin e Arkivës elektronike në procesin e ekzekutimit të pagesave të buxhetit të shtetit nga Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Agjencia e Prokurimit Publik në muajin dhjetor të vitit 2022 filloi dërgimin dhe arkivimin në formë elektronike të dokumentacionit mbështetës për ekzekutimin e trasaksioneve buxhetore, nëpërmjet web portalin.

✓ Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit

Agjencia e Prokurimit Publik ka qënë nga data 12.01.2022-08.04.2022 në proces auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me objekt “Auditimi i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit”, për periudhën 01.01.2020-31.12.2021.

Në vijim të gjetjeve dhe rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të KLSH-së, Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të të Dhënave dhe Publikimit rishikoi përshkrimet e punës në koherencë me rregulloren e brendshme.



12.6. PËRDORIMI DHE RUAJTJA E AKTIVEVE

Në zbatim të Ligjit Nr.10296 datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar janë marrë masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Çdo menaxher, nëpunës apo punonjës i institucionit është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre sipas kompetencave që mbulon, duke dokumentuar veprimet e ndërmarra prej tij për të siguruar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aktivitetit që ka nën përgjegjësi.

Aktivitetet në përdorim janë dhënë në ngarkim të punonjësve të cilët kanë përgjegjësi ligjore për humbjet, dëmtimet e shpërdorimet. Çdo vit kryet inventari i aktiveve në përdorim dhe në magazinë. Konkretisht me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 114, datë 22.12.2022, është ngritur komisioni i inventarizimit të aktiveve.

Në vitin 2022 nuk ka patur raste të humbjeve, keqpërdorimit apo përdorimit të paautorizuar të aktiveve.

Përgjegjësi i bazës materiale pasqyron me saktësi në dokumentacionin përkatës të dhënat, si dhe gjendjen e lëvizjese se aktiveve që ka në ngarkim.

Çdo aktiv i blerë para se të bëhet hyrje në magazine, merret në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim, i cili është ngritur me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 4 datë 10.01.2022.

12.7. PERFORMANCA E REALIZIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2022

Aktivitetin financiar për vitin 2022, Agjencia e Prokurimit Publik e ka zhvilluar duke u bazuar në Ligjin e Buxhetit 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”.

- Realizimi i fondeve buxhetore si 12/mujor për vitin 2022 paraqitet si më poshtë

Tabela 108

Nr.	Artikujt	Plani vjetor	Plani 12/mujor Lekë	Fakti 12/mujor Lekë	Diferenca si 12/mujor Lekë	Realizimi (%)	Numri i punonjësve	
							plan	fakt
1	600	46,430,000	54,247,500	44,662,405	1 767 595	96.2		
2	601	7,817,500		7,377,493	440 007	94.4		
3	602	6 562 800	7,472,800	4,555,846	2 006,954	69.4		
4	606	910 000		884,367	25 633	97.2		
5	231	1 000 000	1 000 000	976,056	23,944	97.6		
Totali		62 720 300	62,720,300	58,456,167	4,264,133	93.2	44	39

Fondet buxhetore të akorduara me ligjin e buxhetit të vitit 2022, për periudhën Janar-Dhjetor 2022, janë realizuar në fakt 58,456,167 lekë nga 62,720,300 lekë të planifikuara, ose 93.2%.

Me Ligjin e Buxhetit të vitit 2022 institucionit të APP-së ju çelën fonde në zërin shpenzime kapitale **1,000,000** lekë, për blerje pajisje elektronike dhe orendi zyre. Fondi i përdorur si 12/ mujor është 976,056 lekë ose 97.6%.



PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT E PUNËS PËR VITIN 2023

1. Vijim i procesit të Integrimit Evropian duke koordinuar punën në kuadër të procesit të anëtarësimit të plotë të Shqipërisë në BE.
2. Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit rregullator në fushën e prokurimit publik është në fokusin e veprimtarisë së APP edhe në vitin 2023. Në këtë kuadër synohet:
 - Rishikimi i ligjit të prokurimit publik dhe rregullave të prokurimit publik, me qëllim përafrimin e mëtejshëm me parashikimet e Direktivave të BE, si dhe adresimin e problematikave, që referohen si nga autoritetet kontraktore, ashtu edhe nga operatorët ekonomikë gjatë zbatimit të ligjit në periudhën dy vjeçare nga hyrja në fuqi.
 - Hartimi dhe miratimi i udhëzimit mbi përdorimin e kriterit të vlerësimit të ofertës ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto.
 - Finalizimi dhe publikimi i një udhërrëfyese për prokurimin e gjelbër.
 - Pjesëmarrja aktive e APP në procesin e hartimit të ligjit të ri për Koncesionet dhe PPP me qëllim garantimin e përputhshmërisë së tij me direktivën përkatëse të BE.
3. Realizimi i aktiviteteve të parashikuara në Plan Veprimin e Strategjisë Kombëtare mbi Prokurimin Publik 2020-2023;
4. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020-2023;
5. Ndjekja e aktiviteteve në kuadër të dokumenteve Strategjike Kombëtare ku prokurimi është pjesë;
6. Hartimi i një programi për profesionalizimin e funksionit të prokurimit publik dhe të një plani trajnimesh shumëvjeçar;
7. Ndjekja e procesit të aderimit të Shqipërisë në Marrëveshjen Qeveritare për Prokurimin Publik të Organizatës Botërore të Tregtisë.
8. Përmirësime të vazhdueshme në SPE.

Me qëllim rritjen e transparencës përmirësime të vazhdueshme të SPE janë të nevojshme, të tilla si:

- i. Përmirësimin e sistemit dinamik në SPE;
- ii. Krijimi i minikontratave në SPE;
- iii. Vendosja e filtrave në SPE për të identifikuar përdoriminin e kriterit të vlerësimit të ofertës më të mirë ekonomike bazuar në kosto dhe kriteret e prokurimit të gjelbër;
- iv. Implementimi i red flags në SPE me qëllim identifikimin automatik të rasteve kur kemi procedurave me një oferte të dorëzuar, apo rastet kur kemi vetëm një operator ekonomik të shpallur fitues në procedurat e prokurimit të një autoriteti kontraktore, etj.



9. Asistenca e vazhdueshme e autoriteteve kontraktore për procedurat e prokurimit, me qëllim minimizimin e rasteve kur AK-të vendosin kriterë që sjellin kufizim në pjesëmarrje dhe nuk sigurojnë konkurrencën e ndershme të operatorëve ekonomikë, si dhe rritjen e performancës së autoriteteve kontraktore gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit publik, për garantimin e efikasitetit në prokurimin publik.
10. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me organizatat ndërkombëtare në kuadër të përmirësimit të sistemit të prokurimit publik në Shqipëri.
11. Bashkëpunimi me institucione të ndryshme, për çështje që lidhen me prokurimin publik dhe adresimin e problematikave, që mund të konstatohen gjatë ushtrimit të detyrave.
12. Përpunimi i informacionit statistikor mbi baza të rregullta dhe sa herë kërkohet nga palë të treta.

